



# Hëna e Re

Viti XXXV | Nr.364 | Janar 2022 | Xhumadel Evvel - Xhumadel Ahir 1443 | Çmimi 50 den

## PARA TRE MUAJVE TË BEKUAR

### GAJRET EDHE PAK:

Xhamia e Myftinisë së BFI-Tetovë në Kodër të Diellit, e fotografuar më 19 janar, 2022. Bëjnë merhamet, posi, besimtarët, që kjo Shtëpi e Zotit të kryhet përfundimisht...

# CILIT SAHABI I FOLI ALLAHU DIREKT DHE PA PENGESA

Nga Irfan Agushi

Nga ndodhitë e shumta të sahabëve, me këtë rast, po veçojmë atë të Abdullah ibn Hiramit (radiallahu anhu).

Abdullahu, si çdo medinas tjetër, ishte nga të parët që kishte pranuar Islamin, bashkë me familjen. Ishte i varfër, e megjithatë kujdesej mirë për gruan, për 9 vajzat dhe djalin e vetëm, Xhabirin (radiallahu anhu).

Historia e bukur e Abdullahut fillon në momentin kur Muhamedi (alejhi-selam) u detyrua të thirrte myslimanët për të dalë për të luftuar në Uhud.

Në një rën anë dëshironte të shkonte babai, ndërsa në anën tjetër djali. Sido që të shkonte puna, njëri prej tyre duhej të qëndronte, për t'u kujdesur për familjen. Arritën deri aty sa duhej të hidhnin short. Shorti i ra babait, Abdullah ibn Hiramit. I biri, Xhabiri, nuk pajtohej, derisa babai i tha: "O biri im, sikur të ishte diçka tjetër, pos Xheneetit, do të ta kisha lënë ty. Por, Xheneitin s'ta lë dot."

Iku bashkë me shumë luftëtarë të tjerë. Pasi përfundoi lufta, shumë të vrarë kishin nga të dyja palët dhe në mesin e të vrarëve ishte edhe Abdullah ibn Hiramit, babai i Xhabirit.

Tregon i biri, Xhabiri: "Shkova ta shoh, por myslimanët tjerë nuk më lejuan, pasi jobesimtarët ia kishin gjymtur trupin." Kur e pa këtë skenë Muhamedi (alejhi-selam), u tha: „Lëreni ta shohë babain.“



Tregon Xhabiri: "Kur e pashë në atë gjendje, fillova të qaj me të madhe, sa që i fshija lotët me mëngë. Pejgamberi (s.a.v.s.) u afrua dhe më tha: 'E qan ose s'e qan, me laqet vazhdojnë t'i bëjnë hije me krahët e tyre. Gëzohu, o Xhabir!'

"Po përse, o dërguar i Allahut?"- e pyeta, tregon Xhabiri.

Ai më tha, vazhdon të tregojë Xhabiri: "Nuk i ka folur kujt Zoti pa ndonjë pengesë, kurse babait tënd i ka folur direkt, pa pengesë dhe i tha: 'O robi Im, kërko prej Meje ç'të duash'. 'O Zot - i tha babai yt - kërkoj prej Teje që të më kthesh përsëri në jetë, të luftoj dhe të vritem përsëri në rru-

gën Tënde.' Ndërsa Zoti i tha: 'O biri i Ademit, e kam bërë zakon që të vdekurit të mos kthehen përsëri, prandaj kërko diçka tjetër.' Atëherë babai yt kërkoi që kënaqësinë dhe përjetimin e tij ta ndajë edhe me myslimanët tjerë, me ç'rast Allahu m'i shpalli dy ajete në suren Ali Imran (170 - 171): "Janë të gëzuar me atë që u dha Allahu nga të mirat e Tij dhe atyre që kanë mbetur ende pa iu bashkuar radhëve të tyre u marrin myzhde, se për ta nuk ka as frikë dhe as që kanë pse të brengosen. Ata janë të gëzuar me begati e dhurata që ua dha Allahu, e s'ka dyshim se Allahu nuk ua humb shpërblimin besimtarëve."

## DEGRADIMI I NJË SHOQËRIE

Shenjat e degradimit të një shoqërie sipas Ibn Haldunit:

- Zbehja e solidaritetit mes njerëzve.
- Rënia e prodhimit.
- Rritja e çmimeve dhe e taksave.
- Zhdukja e meritokracisë.
- Shtimi i padrejtësive dhe i nepotizmit.
- Humbja e shpresës dhe sundimi i pesimizmit.
- Rritja e emigracionit.

(Nga Myftinia Dibër, Shqipëri, 4.01.2022)



"Princesha e Pellagonisë", Xhamia në fshatin Jakrenovë, është në fazën përfundimtare - ka njoftuar Myftiu i Myftinisë së Prilepit, Shefket ef. Imeri, në faqen e vet në Facebook. (20.01.2022)

EDITORIAL

## NA QOFSHIN PËR HAIR TRE MUAJT E BEKUAR!

Sipas takvimit (kalendarit) për vitin 1443 hixhri, dita e parë e muajit Rexheb përkon me 2 shkurtin e këtij viti. Ky muaj i paraprin muajit Shaban, pas të cilit vjen muaji i të mirave të përgjithshme - Ramazani, muaj këta të cilët njihen si Tre Muajt dhe janë me vlerë të veçantë. I pari, Rexhebi, konsiderohet muaj i faljes nga Allahu (xh. sh.) ose si muaj i mbjelljes; i dyti, Shabani, është muaji i ndërmjetësimit për falje ose muaj i ujitjes apo i kultivimit, ndërkaq i treti, Ramazani, është muaj i shtimit të begatave dhe mirësive, ose muaj i korrjes, muaj i mbledhjes së bereqetit.

Për fat të keq, ky vit është viti i tretë që Tre Muajt e Bekuar i fillojmë dhe po i përjetojmë me shoqërimin e pandemisë covid -19. Kjo na bën që të jemi të kujdesshëm gjatë veprimeve tona. Por, kurrsesi kjo sëmundje të mos na ndalojë që muajt e lartpërmendur të mos i përjetojmë ashtu siç i ka hije një besimtar. Andaj, gjatë këtyre tre muajve të bekuar, pos ibadeteve të përditshme, duhet shtuar vëllimi i punëve të dobishme dhe të mira, siç është nxënia e dijes, dhënia e sadakasë, e zeqatit, falja e namazit nafile, agjërimi etj.

Vlerën e këtyre muajve gjithsesi e madhështojnë netët e mëdha, apo netët e mira që gjenden në këta muaj, siç janë:

- **Nata e Regaibit**, e cila gjithnjë bie në natën e xhumasë së parë të muajit Rexheb. Kjo natë, ndërkaq, njihet për nga ajo që thuhet se Emineja, nëna e Muhamedit (a. s.), e ka hetuar veten se është shtatzënë, përkatësisht nata e zanafillës fizike të të dërguarit të Allahut (xh. sh.).

- **Nata e Miraxhit**, e cila bie në natën e 27-të të muajit Rexheb, natë kjo të cilën e përmend edhe Kurani fisnik: "Pa të meta është Lartmadhëria e Atij që robin e Vet e kaloi në një pjesë të natës prej Mesxhidi Haramit (Qabesë) deri në Mesxhidi Aksa (Bejti Mukad- des), rrethinën e së cilës Ne e kemi bekuar; (ia bëmë këtë udhëtim) për t'ia treguar atij disa nga argumentet Tona. Vërtet, Ai është dëgjuesi (i fjalëve të Muhamedit), shikuesi (i punëve të Muhamedit)."

- **Nata e Beratit**, e cila bie në natën e 15-të të muajit Shaban, është nata e cila na paralajmëron ardhjen e shpejtë të muajit Ramazan, të muajit tonë më të dashur, kështu që sa më mirë duhet të përgatitemi shpirtërisht dhe fizikisht për agjërim dhe për ibadetet tjera. Se çfarë nate është dhe çfarë rëndësie ka kjo natë, këtë më së miri na e përshkruajnë hadithet e Muhamedit (a. s.): "Në natën e pesëmbëdhjetë të muajit Shaban të gjitha veprat nxirren përpara Zotit të Gjithësisë; për këtë arsye, unë dëshiroj që veprat e mia të nxirren para Tij deri sa unë jam duke agjëruar."

- **Nata e Kadrit** bie në dhjetë netët e muajit Ramazan. Ajo është nata më e vlefshme dhe më e bekuar. Në të filloi të shpallet Kurani fisnik. Një kaptinë e Kuranit mban emrin e kësaj nate. Vlerën e kësaj nate më së miri na e tregon Kurani: "Ne e shpallëm atë (Kurani) në Natën e Kadrit; e ç'të bëri ty të dish se çka është Nata e Kadrit? Nata e Kadrit është më e vlefshme se një mijë muaj..."

Natyrisht se për vlerën dhe rëndësinë e Tre Muajve, dhe për netët e bekuara që gjenden në ta, mund të shkruhet shumë më shumë, por qëllimi ynë është që me këto pak fjalë t'u paraprijmë shkrimeve në vijim kushtuar këtyre muajve.

Ecuria dhe organizimi i aktiviteteve të jetës fetare në këta tre muaj, si gjithmonë, është nën përkujdesjen institucionale të Bashkësisë Fetare Islame, respektivisht të organeve dhe të institucioneve edukativo-arsimore të saj, si dhe të asociacioneve të themeluara nga BFI, e cila, duke pasur parasysh zhvillimet e përgjithshme shoqërore, përpiket që të krijojë kushte sa më të mira për shtrirjen e aktiviteteve fetare në të gjithë territorin e vendit.

Ardhja e Tre Muajve është një rast i mirë për t'i përkujtuar lexuesit që të përgatitur t'i presim këta muaj të bekuara. Redaksia e "Hënës së Re" shfrytëzon rastin që të gjithë lexuesve t'ua urojë ardhjen e Tre Muajve. Na qofshin me bereqet!

Q. Osmani



## AKTUALITET

# 3 MUAJT: PO HAPEN PORTAT E MIRËSIVE...

**Ne kemi shumë nevojë për mëshirën e Zotit, për udhëzimin e Tij, për faljen prej Tij dhe për shumë e shumë mirësi të tjera. E tëra e kësaj, Allahu sikur na thotë: 'Po t'i hap portat, o rob i Im! Këta tre muaj i kam mbushur me mirësi të pafund, që ti të gëzohesh, të shpëtosh dhe të gjesh paqen e përhershme!'**



**Shkruan: Musa Biba (Enkas për HeR)**

Vëllezër dhe motra! Jemi në momente gëzimi. Tash janë të gëzuar qielli dhe toka dhe gjithë krijesat që gjenden mes tyre, sepse jemi të prag të hyrjes së Tre Muajve të Bekuar. Muaji i parë është Rexheb, pastaj vjen muaji Sha'ban dhe, pas tyre, i madhi dhe kurora e muajve - Ramazani.

I dashuri ynë, Muhamedi (a. s.), kur vinin këta muaj i drejtohej Allahut me lutjen: "O Allahu ynë! Na beko me mirësitë Tua në muajin Rexheb dhe Sha'ban, dhe na mundëso të arrijmë muajin Ramazan."

Gjithashtu, Ebu Bekr Belhi (r. a.) për këta muaj ka thënë: "Rexhebi është muaj i mbjelljes, Sha'bani - muaj i ujitjes dhe Ramazani - muaj i korrjes."

Andaj, vëllezër, le ta mbjellim të mirën brenda vetes sonë, brenda familjeve tona dhe brenda shoqërisë sonë; le ta ujisim atë që të përhapet e mira gjithkund dhe le të korrim mirësi ne dhe gjeneratat e ardhshme. Gjeneratat e ardhshme do të jenë ajo që ne do të mbjellim sot, prandaj le të jemi të vëmendshëm:

- Le të mundohemi këta muaj t'i kalojmë në përkushtim ndaj Zotit tonë, duke bërë më shumë dhikër, duke lexuar Kuran, duke dërguar salavate; por, kush e ka fuqinë, le të agjërojë më shumë sipas mundësisë (nuk është obligim).

- Ta rikthejmë një vlerë madhështore në shtëpitë tona, që të përgatitim ushqim dhe atë ta shpërndajmë me dashamirë, me farefis dhe me komshinj; e brenda, në shpërblimin e kësaj veprë, me nijet le ta përfshijmë veten, prindërit dhe mbarë

besimtarët dhe le të vizitojmë farefisin.

- Duke pasur parasysh obligimet çka kemi, obligoje veten që të gjesh mundësi që të paktën në njërin nga namazet ditore të jesh në xhami, për ta falur namazin me xhemat. Le të afrohem më shumë me xhamitë dhe mos t'i braktisim shtëpitë e Zotit të madhërisëm.

Vëllezër të dashur! Konsiderojeni veten sikur jeni të uritur, sikur disa ditë jeni pa ngrënë. E, papritmas dikush ju merr dhe ju çon në një shtëpi me tri dhoma, të mbushura plot e përplot me ushqime, me pije, me pasuri dhe me mirësi të shumta dhe ju thotë: Këto tri dhoma janë dhuratë prej meje për ty! A do të ishe gëzuar për këtë nderim, apo do të ikje pa ngrënë diçka kur je i uritur? Pa dyshim, do të gëzoheshim dhe do të falënderonim në formë të veçantë!

E njëjta është edhe me këta tre muaj. Ne kemi shumë nevojë për mëshirën e Zotit, për udhëzimin e Tij, për faljen prej Tij dhe për shumë e shumë mirësi të tjera. E tëra e kësaj, Allahu sikur na thotë: 'Po t'i hap portat, o rob i Im! Këta tre muaj i kam mbushur me mirësi të pafund, që ti të gëzohesh, të shpëtosh dhe të gjesh paqen e përhershme!'

Andaj, vëllezër e motra, të përkushtohemi, të afrohem me Allahun tonë! Është mundësi e madhe për ne që të fitojmë atë për të cilën edhe kemi nevojën më të madhe: pëlqimin dhe kënaqësinë e Allahut, Zotit të botëve!

Na qoftë për hair dhe dashtë Allahu që të jemi ashtu sikur i ka hije një besimtari të vërtetë.

Amin. El-Fatiha!

(Autori është Referent fetar-arsimor në Myftininë e Strugës)

# RËNDËSIA E TRE MUAJVE

**Në qoftë se një njeri nuk i kushton rëndësi vetëllogaritjes, atëherë ai do ta ketë vështirë ta kuptojë se paturpësia, amoraliteti, padrejtësia, injoranca, urrejtja dhe shumë dukuri negative do të dominojnë në shoqërinë ku ai jeton.**

**Shkruan: Musanif Rufati**

Allahu (xh.sh.) për shkak të dashurisë dhe të mëshirës ndaj robve të Vet, disa ditë, disa net dhe disa muaj i ka veçuar nga ditët, netët dhe muajt tjerë. Këto ditë, këto net dhe këta muaj në botën islame dhurojnë një atmosferë të bukur te besimtarët, me ç'rast njerëzit e shtojnë vëllimin e adhurimeve të tyre ndaj Zotit, kërkojnë falje për mëkatet e tyre dhe mundohen t'i shtojnë veprat e mira.

Ndër këto ditë dhe muaj janë Tre Muajt e Bekuar Rexheb, Shaban dhe Ramazan, të njohur në kulturën islame si muaj më të dalluar. Këta muaj konsiderohen të dalluar nga muajt tjerë për faktin se brenda këtyre muajve gjenden "netët e bekuara", ndryshe të njohura si **netët e mëdha** në mesin e njerëzve. Sipas mësimëve fetare islame, këto net janë: Nata e Regaibit, Nata e Miraxhit, Nata e Beratit dhe Nata e Kadrit.

## LUTJE DHE DUA TË SHTUARA NGA MUHAMEDI (A. S.)

Po qe se shikojmë literaturën e Hadithit, do të vërejmë se i dërguari i Allahut në lidhje me këta muaj ka thënë disa hadithe, madje ai i ka shtuar lutjet dhe duatë. Njëra ndër lutjet apo duatë të cilat i bënte gjatë kësaj kohe është edhe kjo dua:

**"O Zoti im, na i beko muajt Rexheb dhe Shaban dhe na e mundëso ta arrijmë Ramazanin."** (Taberani, el-Mu'xhemul-evsat, IV, 189)

Sipas renditjes në kalendar, muaji Rexheb është muaji i shtatë, por ky muaj cilësohet si muaji i mbjelljes, kurse muaji Shaban është muaji i tetë, por cilësohet si muaj i ujitjes dhe muaji i Ramazanit është muaji i nëntë, i cili vlerësohet si muaji i korrjes, apo i mbledhjes së prodhimeve. Pra, secili do të korrë atë çka ka mbjellë, kurse ka për të fituar aq sa ka punuar.

Në fakt, muajt Rexheb dhe Shaban janë parapërgatitje për muajin e bekuar të



Ramazanit, për të cilin Allahu (xh. sh.) thotë se **është më i mirë se një mijë muaj** (Kuran, 97/3). Gjatë këtyre muajve besimtarët fillojnë të përgatitin veten e tyre me agjërim dhe me ibadete të tjera.

Nga ibadetet që më së shumti praktikoheshin dhe preferoheshin nga i dërguari i Allahut, nga shokët e tij dhe nga dijetarët e mëhershëm janë:

Agjërimi vullnetar (nafile). Gjatë këtyre muajve zakonisht besimtarët agjërojnë. Nga agjërimet e preferuara llogariten agjërimi i ditës së hënë dhe i ditës së enjte. Gjithashtu, nga tradita dhe mësimet e Muhamedit (a. s.) mësojmë se nga agjërimet e preferuara është edhe **agjërimi i ditëve të bardha**, e që janë dita e 13-të, e 14-të dhe e 15-të e çdo muaji hënor. Njëkohësisht, në mesin e agjërimëve të preferuara, apo nafile, është edhe agjërimi i njohur si **agjërimi i Davudit (a. s.)**, që nënkupton agjërimin "një ditë po, një ditë jo", si Davudi (a. s.).

Dhënia apo shpeshtimi i dhënies së lëmoshës. Gjatë këtyre muajve të bekuar preferohet edhe dhënia e lëmoshës-sadakasë, e cila është shkak për shtimin e rikut dhe faljen e mëkateve.

Namazet vullnetare (nafile). Përveç namazeve obligative, gjatë këtyre muajve preferohet të falen edhe namaze vullnetare, siç janë: namazi i Duhasë, namazi i natës (tehexhud), namazi i teravisë etj.

Leximi i Kuranit. Është mirë që besimtari gjatë këtyre ditëve dhe netëve të shtojë leximin e Kuranit, me qëllim: thithjen më të madhe të të vërtetave kurane dhe stolisjen e vetvetes me vlerat që

i ofron Kurani fisnik.

Vetëllogaritja (*nefsi muhasebe*). Puna e parë dhe më e rëndësishme gjatë këtyre muajve është që njeriu ta marrë veten e tij në llogari, ta analizojë të kaluarën e vet. Kjo duhet bërë në këtë kohë, kur ana materiale e njeriut anon karshi asaj shpirtërore. Të bësh një vetëllogaritje, (kjo) të mundëson të kuptosh se sot mospajtimet dhe kundërshtimet mes shoqërive ndikojnë negativisht në botë, ku në vend që të flitet me mendje të shëndoshë, sot flitet nëpërmjet dhunës dhe armëve të ndryshme. Vetëllogaritja është mjeti më i mirë që na mbron nga humbja e vlerave morale. Në qoftë se lihet pas dore kjo rrugë, të cilën feja jonë gjithnjë mundohet të na e ngulit në zemër, atëherë anashkalohej pesha e kuptimit të jetës së njeriut në këtë botë. Në qoftë se një njeri nuk i kushton rëndësi vetëllogaritjes, atëherë ai do ta ketë vështirë ta kuptojë se paturpësia, amoraliteti, padrejtësia, injoranca, urrejtja dhe shumë dukuri negative do të dominojnë në shoqërinë ku ai jeton.

## JO NDJENJAVE DHE IDEVE NEGATIVE

Këta muaj, këto ditë e net, janë një mundësi e bukur që po na jepen për t'i shfrytëzuar ashtu si është më mirë, duke i braktisur mëkatet që rëndojnë mbi karakterin dhe ahlakun e besimtarit. Janë një mundësi e mirë për t'i zbrazur zemrat tona nga ndjenjat dhe idetë negative dhe të krijojmë hapësirë për mbushur zemrat tona me ndjenjën e dashurisë, të drejtësisë, të sinqeritetit etj.

Të bashkohemi dhe të afrohemi karshi armiqësive që na e mbështjellin botën ku jetojmë. Le të jenë këto ditë dhe net një mundësi që ta mbushim jetën tonë me vepra të mira dhe të arrijmë faljen dhe mëshirën e Allahut fuqiptotë.

Allahu na i faltë gabimet tona të fshehta dhe të dukshme dhe na udhëzoftë në rrugën e drejtë.

(Autori është Drejtor i Sektorit për Kulturë të BFI të RMV)

# NJË DELEGACION I BFI-së VIZITON ARABINË SAUDITE

Më 30 dhjetor, 2021, një delegacion i lartë i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, i udhëhequr nga Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, nga Aeroporti Rinas në Tiranë u nis në një vizitë zyrtare 10-ditore në Mbretërinë e Arabisë Saudite, me ç'rast 4 ditë do të qëndrojnë në kryeqytetin Rijad dhe nga 3 ditë përkatësisht në qytetet e shenjta Mekë e Medinë, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Delegacioni përbëhet prej 16 anëtarësh: Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, Myftiu i Shkupit dr. Qenan ef. Ismaili, Myftiu i Kumanovës h. Abedin ef. Imeri, Myftiu i Gostivarit h. Sabahudin ef. Zendeli, Myftiu i Kërçovës mr. Qamil ef. Rushiti, Myftiu i Strugës mr. Salim ef. Sulejmani, Myftiu i Ohrit h. Samet ef. Ajdari, Myftiu i Manastirit h. Amit ef. Rasimi, Myftiu i Prilepit h. Shefket ef. Imeri, Myftiu i Prespës h. Xhunejd ef. Jashar, Shefi i Kabinetit të Reis'ul-Ulemasë dr. Abdylqerim Iseni, Prodekani i FSHI dr. Muaz ef. Agushi, Drejtori i Sektorit për Diasporë i Rijasetit dr. Selver ef. Xhemaili dhe Drejtori i Sektorit për Marrëdhënie me Botën Arabe i Rijasetit h. Ismet ef. Ademi.

Vizita është përgjigje në ftesën vëlla-



zërora të miqve të BFI-së nga Arabia Saudite. Ajo konsiderohet nder dhe fat për Bashkësinë Fetare Islame të RMV, për personalitetet me përgjegjësi të jetës fetare-islame dhe një afrim me institucionet e sferave të ndryshme të Arabisë Saudite. Njëherësh, me këtë vizitë thellohet jo vetëm miqësia dhe bashkëpunimi vëllazëror, por në të njëjtën kohë merren përvoja të llojeve dhe standardeve të niveleve të ndryshme, si dhe bëhet njoftimi me përvojat e pjesëtarëve të Islamit këtu në Ballkan, e në veçanti në Bashkësinë Fetare Islame të RMV.

Anëtarët e delegacionit kanë fatin që gjatë qëndrimit në Mekë të bëjnë edhe Umran dhe të vizitojnë Qabenë e bekuar dhe shumë vende të tjera të njohura fetare. Vizita Medinë do t'u mundësojë që të jenë vizitorë të Xhamisë së Pejgamberit (a. s.) dhe drejtpërdrejt të përcjellin selamet e përzemërta.

Lusim Allahun fuqiptotë që delegacionit të BFI t'i dhurojë shëndet dhe kënaqësi, si dhe mundësinë që kjo të jetë një vizitë përmbajtësore dhe me njohuri të shumta. Allahu e bekoftë këtë vizitë, thuhet në njoftimin e BFI-së.

## KËSHILLTARI FETAR I MBRETTIT SHTRON DARKË SOLEMNE



Delegacioni i lartë i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut u nderua me ftesë dhe iu përgjigj ftesës së Shejh Sa'd Esh Shethri, Këshilltar Fetar i Mbretit, Shkëlqesisë së Tij Selman bin Abdulaziz es Saudi dhe trashëgimtarit të Fronit Muhamed B. Selman, në prezencë të personaliteteve të tjera të mirënjohura, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Gjatë këtij takimi mjaft të rëndësishëm pjesëtarët e delegacionit të BFI kaluan çaste mbresëlënëse dhe mjaft të frytshme. Këshilltari Esh Shethri bisedoi

për forcimin e marrëdhënieve me Bashkësinë Fetare Islame të RMV, si dhe për një bashkëpunim të mirëfillte në të ardhmen, me qëllim të shpjegimit të Islamit në mënyrë të pastër, si e vetmja veprimtari në kultivimin e vlerave të ngritjes së dinjitetit të njeriut në paqe e solidaritet dhe për të demantuar mendimet e gabuara ndaj Islamit dhe vendit ku jetojmë.

Pritja e ngrohtë, si dhe bisedat që u zhvilluan, treguan qartë se Shejh Sa'd Esh Shethri është një personalitet i lartë, i urtë dhe me njohuri të gjera mbi rrjedhat fe-

tare në përgjithësi.

Kryetari i BFI, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në emrin e delegacionit të BFI e falënderoi atë dhe i shprehu mirënjohje për ftesën dhe pritjen e ngrohtë dhe e informoi për organizimin e institucionit BFI në përgjithësi dhe organizimin e jetës fetare në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në shenjë respekti, për delegacionin e BFI dhe për mysafirët tjerë që kishin ardhur ta shoqëronin dhe ta respektonin këtë delegacion u shtrua një darkë solemne. (4.01.2022)

# TAKIM ME STUDENTËT NË RIJAD DHE NË MEDINË

Më 31 dhjetor, 2021, delegacioni i lartë i Bashkësisë Fetare Islame të RMV pati një pritje të ngrohtë nga Unioni i Studentëve të Kosovës dhe të Maqedonisë së Veriut, të cilët janë me studime në universitetet e Rijadit, në krye me Kryetarin e këtij unioni z. Selim Behrami dhe në prezencë të studentëve, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Delegacioni falënderoi studentët tanë për këtë gjest të madh respekti dhe për pritjen madhështore e mjaft domethënëse. Me këtë rast u bisedua për rrjedhën e studimeve në universitetet e Rijadit dhe për nevojën e përgatitjes së tyre profesionale fetare, për të qenë në të ardhmen në shërbim të vendlindjes, të kombit dhe të atdheut.

Përkrahja e Bashkësisë Fetare Islame do të jetë gjithmonë në nivelin e duhur, sepse ato veprojnë për të ardhmen e Islamit, bartës të së cilës do të jenë vetë studentët.

Z. Selim Behrami në emër të Unionit shprehu falënderimin e tij për pranimin e ftesës për një takim dhe tubim të këtyllë dhe i njoftoi mysafirët e BFI të RMV për rrjedhat e studimeve në Rijad dhe më gjerë.

U këmbyen mendime dhe përvoja rreth çështjeve aktuale dhe sfidave të kohës.

Gjatë qëndrimit në Medinë, përveç ta-



kimeve zyrtare me autoritetet fetare të kësaj mbretërie, delegacioni u takua edhe me studentët e Medinës nga Maqedonia e Veriut, të cilët treguan nivel të lartë mikpritës ndaj delegacionit të BFI të RMV dhe me kënaqësi u vunë në shërbim të komoditetit të këtij delegacioni, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Njëherësh, ata organizuan ndejë në selinë e unionit të tyre në krye me dr. Kujtim Ahmetin dhe studentët tjerë si: z. Fatonin, Alaudinin, Orhanin e kështu me radhë...

Gjatë këtij takimi delegacioni i BFI dhe Unioni i Studentëve nga Maqedonia e Veriut që studiojnë në Medinë biseduan

mbi rrjedhën e studimeve të tyre, për kushtet dhe sfidat eventuale të tyre. Gjatë bisedës u vërejt se studentët janë të lumtur, të suksesshëm dhe të gatshëm për t'u vënë në shërbim të vlerave fetare e kombëtare të vendit konform kushteve dhe rrethanave.

Nga ana tjetër, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, në emër të delegacionit, i informoi studentët për rrjedhat e jetës fetare në vend, si dhe për strategjinë e BFI për të ardhmen e Islamit dhe ua bëri me dije se ato janë ardhmëria e Islamit dhe e vlerave të qëndrueshme në shoqërinë tonë, thuhet në njoftimin e BFI-së.

## TAKIM MBRESËLËNËS ME DR. MUHAMMED EL-METRUDI

Delegacioni i lartë i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut pati një takim mbresëlënëse në Arabinë Saudite me dr. Muhammed el-Metrudi, profesor në universitetin "King Saud" në Rijad. El-Metrudi është edhe afarist dhe donator i mirënjohur. Ai delegacionit të BFI-së i bëri një pritje madhështore e vëllazërore, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Me dr. Muhammed el-Metrudi Kryesia e BFI pati mundësinë dhe kënaqësinë që të bisedojë rreth veprimtarisë së tij shkencore dhe afariste, si dhe rreth ndihmës që po e jep anembanë botës, gjithanë ku ka nevojë.

Me të u bisedua edhe për zhvillimet e jetës fetare në Ballkan, e në veçanti për zhvillimin e jetës fetare në Republikën e Maqedonisë së Veriut, të udhëhequr nga Bashkësia Fetare Islame.



Dr. Muhammed el-Metrudi mbeti i kënaqur nga të dhënat që mori nga delegacioni i BFI. Takimi me të zgjati disa orë dhe ishte mjaft mbresëlënëse, gjatë të cilit u bisedua gjerë e gjatë për shumë përvoja të ndërsjella dhe prej ku u morën

mjaft ide dhe frymëzime për një veprimtari më efikase në interes të institucionit fetar islam – BFI dhe besimtarëve në përgjithësi. Zoti e bekoftë nikoqirin e nderuar, thuhet në njoftimin e BFI-së. (5.01.2022)

# NË QABE, ME TREN NGA MEDINA

Delegacioni i lartë i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, pas vizitave në Rijad dhe në Medinë, momentalisht ndodhet në Mekë. Aty ka ardhur me tren nga Medina për të bërë Umran, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Të gjithë anëtarët e delegacionit janë shëndoshë e mirë dhe me emocion të madh po e përfundojnë vizitën në Qabenë e bekuar, të veshur me ihrame.

Në një postim në rrjetin social Facebook Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, ka shkruar: "Më në fund ajo që e kemi pritur me shpirt: nisja për në Mekë, për në Qabe. Të veshur me ihram. Gati për kryerjen e Umras së bekuar. Të gjithë të lumtur e të gëzuar. Falënderimet të takojnë Ty, o i Madhi Zot. Pranoje nijetin tonë. Ti je i



Vetmi Bamirës dhe Pranues i lutjeve tona. o i dashuri ynë Muhamed (a. s.)", thuhet Salavatet tona t'i dërgojmë nga zemra ty, në njoftimin e BFI-së. (5.01.2022)

## ME XHUMA NË UMRA



Një përjetim i veçantë në pritje të faljes së namazit të Xhumasë në Mesxhidi Haram-Qabe, para momentit të kryerjes së Umras. Kam përshtypjen se është përplot me besimtarë. Allahu na i pranoftë lutjet tona – ka shkruar udhëheqësi i delegacionit të BFI-së në Arabinë Saudite, Kryetari i Bashkësisë Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, më 7 janar, 2021, në Facebook.

Myftiu i Myftinisë së Kërçovës, Qamil ef. Rushiti, pjesë e grupit të umretarëve nga BFI, ndërkaq, ka shkruar: Qabeja e bekuar, shtëpia e parë për adhurim ndaj Zotit të madhërueshëm, me modestinë e saj ia shkon çdo ngrehinë tjetër mbi sipërfaqen e tokës. Ky

është vendi të cilit të gjithë jetën i jemi drejtuar nga larg, por deshi Allahu i madhërishëm që për disa momente t'i qëndrojmë afër, momente këto të cilat ngjallin emocion dhe ndjesi të veçantë, momente të cilat të sjellin në kujtesë tërë një histori të begatë, e cila fillon me njeriun e parë Ademin (a. s.) dhe vazhdon me Ibrahimin e Ismailin (a. s.) dhe përfundon me Muhamedin (a. s.). Allahu qoftë i kënaqur me ta. I bëjmë lutje Allahut të madhërueshëm që ta ketë pranuar prej nesh Umran dhe të jetë i kënaqur me ne, ka shkruar Myftiu i Myftinisë së Kërçovës më 8 janar, 2022, në rrjetin social.

Të njëjtën ditë, anëtari tjetër i delegacionit, dr. Selver Xhemaili, Drejtor

për Diasporë i BFI-së, në Facebook ka shkruar: Pas takimeve zyrtare në Riad dhe obligimeve fetare në vendet e shenjta Medinë dhe Mekë, një përjetim emocional në PIKËNISJEN e shpalljes së Kuranit fisnik, bashkë me myftiun e Strugës Salim ef. Sulejmani dhe myftiun e Kërçovës Qamil ef. Rushiti. Quhet Kodra e Dritës, në majë të së cilës filloi Zbulesa Hyjnore me këto ajete: "Lexo në emër të Zotit tënd, i cili i ka krijuar (të gjitha); i cili e krijoi njeriun nga gjaku i droçkur (embrioni); lexo, se Zoti yt është më bujari; që ia mësoi njeriut penën (të shkruajë); që njeriut ia mësoi atë që nuk e diti" (Kuran: 95/1-5), ka shkruar dr. Selver Xhemaili.

# QABEJA - NJË NDJENJË E THELLË SHPIRTËRORE

Më 9 janar, 2022, në afërsi dhe me shikim drejt Qabesë, në Mekë, kryem Tavafin e fundit dhe lamtumirës. Kaluam caste të thella shpirtërore. U dhamë një freskim shpirtit dhe zemrave tona, të lidhura fuqishëm me Allahun fuqiplotë, ka shkruar Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në faqen e vet në Facebook.

Bashkërisht, gjatë plot 10 ditëve, formuam një ambient vëllazëror dhe harmoni të veçantë, duke filluar nga Rijadi, Xheda, Medina dhe, në fund, Qabeja e bekuar, në Mekë, ku kryem Umran - atë për të cilën edhe u nisëm në këtë rrugë të shenjtë.

Falënderimet i takojnë vetëm Allahut fuqiplotë, që na e mundësoi këtë rrugëtim. Mirënjohje myftinjve, drejtorëve, Shefit të Kabinetit dhe Prodekanit të FSHI për vetëdijen e lartë dhe mundin që dhanë për të formuar ambient shoqëror, duke qenë në shërbim të njëri-tjetrit, në veçanti h. Ismet ef. Ademit, Drejtor për Marrëdhënie me Botën Islame në BFI - për mundin që dha në realizimin e vizitës, si dhe disa takimeve me peshë që u realizuan në Rijad dhe në Xheda.

BFI e RMV do t'i kultivojë vizitat e këtilla, ku do të përfshihen edhe të tjerët, si dhe për t'u afruar edhe me vende të tjera.

I bëjmë lutje Allahut fuqiplotë që t'i pranojë lutjet dhe ibadetet tona dhe të na shpërblejë me shpërblimet e Tij të pakufishme, ka shkruar Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu.

Ndoshta është takimi i fundit me ty, Qabe e bekuar! Në këto momente emocionale, i lutemi Allahut që lutjet tona të jenë të pranuar – ka shkruar Myftiu i Myftinisë së Shkupit, dr. Qenan ef. Ismaili, në rrjetin e njëjtë social.

Njëherësh, e ndjej për obligim që të falënderoj iniciatorin e kësaj freskie shpirtërore, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, bartësin e këtij projekti - të palodhshmin Ismet ef. Ademi dhe - mirënjohje e veçantë për donatorin, që i mbuloi të gjitha harxhimet tona.

I bëjmë lutje Allahut të madhërishëm



që t'ua mundësojë atyre që nuk kanë qenë, por edhe atyre që kanë qenë, që përsëri ta vizitojnë këtë vend të bekuar! Amin! Paqja, Mëshira dhe Begatitë e Allahut fuqiplotë qofshin mbi ju! - ka shkruar Myftiu i Myftinisë së Shkupit.

Çdo fillim e ka edhe mbarimin e vet. Sonte, pas namazit të jacisë, u përshëndetëm me Qabenë e bekuar. Ndarja me këtë vend të bekuar nuk është e lehtë, sepse është vendi ku njeriu mbushet me kënaqësi shpirtërore - është shprehur Myftiu i Myftinisë së Strugës, Salim ef. Sulejmani, më 9 janar, 2022.

Ky ishte një udhëtim shumë i këndshëm, sepse pas takimeve që bëri delegacioni i BFI-së në krye me Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në Rijad, patëm mundësi të vizitojmë Medinën dhe Xhaminë e Pejgamberit (a. s.) dhe në fund bëmë Umran, ku përjetuam kënaqësinë e të qenit pranë Qabesë së bekuar.

Një falënderim i veçantë për Reisin dhe BFI-në për këtë udhëtim me shumë kujtime të bukura.

Gjithashtu dhe për bartësin e këtij projekti, të palodhshmin, hoqhën e nderuar Ismet ef. Ademi.


Paqja, Mëshira dhe Begatitë e Allahut fuqiplotë qofshin mbi ju! - është shprehur Myftiu i Myftinisë së Strugës.

Myftiu i Myftinisë së Gostivarit, Sabahudin ef. Zendeli, të njëjtën ditë është deklaruar: Sonte falëm namazin e jacisë dhe u përshëndetëm me Qabenë e bekuar

- ishalla me Umra dhe lutje të pranuar. Ishte një udhëtim që gjatë kohë do të ruhet në kujtesën tonë, si: vizitat në kryeqendrën Rijad, qëndrimi në Medinë pranë Resulullahut (a. s.), si dhe ajo që të jep ndjesi të lartë shpirtërore - takimi me Qabenë e bekuar.

Falënderoj përzemësisht Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu për iniciativën, Drejtorin h. Ismet ef. Ademi për realizimin, ndërsa një falënderim dhe mirënjohje të veçantë i drejtoj edhe atij që i mbuloi të gjitha harxhimet (donatorit). Allahu na mundësoftë përsëri të takohemi me Qabenë e dashur! – ka deklaruar Myftiu i Myftinisë së Gostivarit.

Në delegacion ka qenë edhe h. Abedin ef. Imeri, Myftiu i Myftinisë së BFI-Kumanovës. Më 9 janar, 2022, në faqen e vet në Facebook ai ka shkruar: Disa foto nga vizita jonë në Arabinë Saudite, duke filluar nga kryeqyteti i saj Rijad dhe, më pas, duke vazhduar në dy vendet e shenjta: Medinetul Munevvere dhe, në fund, iu drejtuar Mekës, respektivisht Qabesë së bekuar, vendit dhe qytetit ku Pejgamberit (a. s.) filloi t'i shpallet Kurani famë-lartë. Si delegacioni i BFI-së kryem Umran, për të cilën edhe ishim drejtuar drejt Arabisë Saudite. I bëjmë lutje Allahut të madhërishëm që të na i ketë pranuar të gjitha ibadetet, të gjitha lutjet dhe në veçanti Umran, të cilën e kishim bërë nijet të gjithë ne, është deklaruar Myftiu i Myftinisë së Kumanovës.



# EDHE TRI TAKIME TË RËNDËSISHME

Gjatë vizitës në Arabinë Saudite dhe qëndrimin në të realizuam edhe tri takime të rëndësishme, ka deklaruar udhëheqësi i delegacionit, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, në faqen e vet në Facebook.

Takime kemi pasur, ka thënë ai, me dr. Muhamed Salim, Përgjegjës në Drejtorinë për Zhvillim në Bankën Islame në Xheda (Jeddah); dr. Abdurrazak M. Abdurrazik, Përgjegjës në Fondin për Solidaritet Islamik me seli në Xheda; dr. Musa Kulakli-kaja, Përgjegjës në Departamentin e Përgjithshëm për Bashkëpunimin Islamik Botëror me seli në Xheda.

Në tri këto takime u bisedua për rrjedhën e veprimet të këtyre institucioneve dhe mundësinë e bashkëpunimit dhe investimeve të tyre në Maqedoninë e Veriut, konkretisht në projekte të Bashkësisë Fetare Islame.

Ishin takime të rëndësishme, ku ne i



njoftuam me synimet e BFI të RMV, si dhe me nevojën e shpjegimit të Islamit në kohën në të cilën jetojmë. Andaj, në të ardhmen duhet biseduar rreth marrëdhënieve të këtyre institucioneve me BFI të RMV dhe duhet vazhduar bashkëpunimi në nivele të ndryshme.

Në takimet e zhvilluara në delegacion morën pjesë: dr. Qenan Ismaili, Myfti i Shkupit; prof. dr. Qani ef. Nesimi, Myfti

i Tetovës; h. Ismet ef. Ademi, Drejtor i Sektorit për Marrëdhënie me Botën Islame; dhe Shefi i Kabinetit, dr. Abdylqerim Iseni. Falënderuam për takimet konstruktive dhe uruam suksese në të ardhmen. Allahu i bekoftë me të mira, është shprehur udhëheqësi i delegacionit të BFI-së që ka vizituar Arabinë Saudite, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu. (9.01.2022)



**NGA ARABIA SAUDITE NË SARAJEVË (BeH):** Më 10 janar, 2022, na respektoi familja Ahmeti, e cila na bëri një pritje vëllazërore në Aeroportin ndërkombëtar të Sarajevës, me rastin e kthimit nga Arabia Saudite. Kaluam çaste të bukura në restorantin e menaxherit të mirënjohur z. Selman Ahmeti nga fshati Forinë (Gostivar), me punë shumëvjeçare në Sarajevë, i cili është një personalitet shumë i suksesshëm në sferën afariste. Me këtë shkrim, në emër të myftinjve dhe anëtarëve të tjerë, përzemërsisht falënderojmë për pritjen shumë vëllazërore z. Selman Ahmetin dhe lusim Allahun fuqiptotë që t'i japë shëndet, jetë të gjatë dhe suksese të reja, atij dhe familjes së gjerë, ka shkruar Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në Facebook. (11.01.2022)

## KEQARDHJE PËR SULMIN NË ABU DHABI

Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, pas sulmit në Abu Dhabi (Emiratet e Bashkuara Arabe) më 18 janar, 2022, ka dalë me një deklaratë në të cilën thuhet:

Me keqardhje të madhe pranuar lajmin e aktit të pamëshirshëm terrorist në Abu Dhabi të Emirateve të Bashkuara

Arabe, ku humbën jetë tre persona dhe ku pati shumë të lënduar.

Bashkësia Fetare Islame e RMV, si gjithmonë, edhe sot, ashpër dënon aktet e këtilla makabre dhe, edhe një herë konstaton se jeta e njeriut është dhuratë e shenjtë dhe terrorizmi është dukuria më e shëmtuar e gjinisë njerëzore, e dëmshme për të gjithë njerëzit në përgjithësi.

I bëjmë lutje të Madhit Zot që të mos ketë akte të këtilla në asnjë vend të botës - thuhet në deklaratën e Kryetarit të Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, pas sulmit në Abu Dhabi. Deklarata është bërë edhe në gjuhën angleze dhe është publikuar në platformat elektronike të BFI-së.

# A ËSHTË KURANI VEPËR E NJERIUT?

*Muhamedi (s.a.v.s.) është një njeri si të tjerët, me dallimin e vetëm se atij i shpallet, i vjen relevata (shpallja) nga Zoti (xh. sh.), gjë të cilën e pohon vetë Kurani.*



**Shkruan: Senad Maku (Enkas për HeR)**

**K**urani dhe prejardhja e tij janë çështjet kryesore, për të cilat kundërshtarët e tij kanë shprehur më së shumti dyshime. Disa persona të caktuar, me një mendjengushtësi dhe gjykim jo të kthjellët, mundohen që të mbjellin farën e dyshimit mbi autenticitetin (vërtetësinë) e tij si Libër Hyjnor.

Shumë libra dhe revista e paraqesin Kurandin si një vepër të mendjes njerëzore, krijuar prej një "mashtuesi" të pejgamberisë.

Për ta kuptuar pozicionin e tyre, është e rëndësishme të kemi parasysh se çfarë thotë Kurani për burimin (origjinën) e tij.

Allahu në Kurandin famëllartë thotë:

**"Se me të vërtetë ai është Kuran i famshëm."**

**"Është i zbritur prej Zotit të botëve."** (El Vakia, 77, 80)

**"Nuk ka dyshim se ky (Kuran) është shpallje (zbritje) e Zotit të botëve. Atë e zbriti Shpirti besnik (i besueshëm) (Xhebraili)." (Esh Shuara, 192-193)**

Mënyra se si thuhet kjo, të jep përshtypjen se këto janë fjalë të Krijuesit drejtuar krijesave të tij. Të gjithë kapitujt, përveç kapitullit të 9-të, fillojnë me formulën:

**"Me emrin e Allahut, Bamirësit të përgjithshëm, Mëshiruesit të posaçëm."**

Pretendimi se Muhamedi (s.a.v.s.) e ka shkruar Kurandin nuk është i sotëm; ai

daton që nga koha e Pejgamberit. Një pretendim të tillë e kishte shprehur, madje, edhe vetë populli i tij.

Për të hedhur poshtë këto pretendime, Allahu fuqiptotë i kërkoi pejgamberit, Muhamedit (s.a.v.s.), t'i drejtohet popullit me fjalët:

**"E, kur u lexohen shpalljet Tona të qarta, atëherë ata që nuk shpresojnë se do të dalin, para Nesh thonë: 'Na sill ndonjë Kuran tjetër ose ndërroje atë!' Thuaj (o Muhamed): 'Është e pamundur ta ndërroj unë atë nga ana ime. Unë shkoj vetëm pas asaj që më është shpallur. Unë druaj, nëse e kundërshtoj Zotin tim, dënimin e Ditës së Madhe'."**

**Thuaj: 'Sikur të kishte dashur Allahu, unë nuk do t'jua kisha lexuar dhe**

as që do të bënte Ai që ta mësoni ju atë. Unë kam jetuar një kohë (të gjatë) në mesin tuaj para profetësisë (as nuk kam ditur shkrim as nuk kam lexuar), a nuk po mendoni?” (Junus, 15-16)

Dihet se Muhamedi (s.a.v.s.) ishte një njeri që nuk dinte shkrim e lexim. Ai jetoi mes popullit të tij dyzet vjet pa treguar as edhe një herë ndonjë shenjë të madhe të dijes. Prandaj, si mund të shpjegohet që ai arriti të shkruante Kuranin, madhështia e të cilit është e pakrahueshme? Besojmë se ky është një argument i fuqishëm që hedh poshtë pretendimet e atyre që thonë se Kurani është libër i Muhamedit (s.a.v.s.).

Thomas Carlyle në lidhje me arsimimin e Muhamedit (s.a.v.s.) ka thënë: “Nuk duhet të harrojmë edhe një rrethanë: se ai nuk ka vijuar shkollën; atë që ne e quajmë shkollim, ai kurrë nuk e ka bërë.” Po ashtu, inxhinieri dhe studiuesi me origjinë çifute, dr. A. N. Sousa, në lidhje me këtë thotë: “Zoti i madhërishtëm mrekullinë e Kuranit dhe analfabetizmin e Muhamedit i ka bërë argument për vërtetësinë e peygamberisë së tij dhe për vërtetësinë hyjnore të Kuranit.”

Se peygamberi, Muhamedi (s.a.v.s.), nuk dinte shkrim e lexim, këtë e dëshmon edhe Allahu në Kuranin famëlartë:

“Ti (Muhammed) nuk ishe që lexoje ndonjë libër para këtij (Kuranit), e as që e shkruaje atë me dorën tënde të djathtë, përndryshe do të dyshonin ata të prishurit.” (El-Ankebutë, 48.)

Atëherë, si mund të jetë e arsyeshme dhe a mund të pranohet logjika që një njeri që nuk dinte shkrim-lexim të jetë autor i një libri kaq madhështor, plot dituri e përkushtim dhe sfidues i gjithësisë si Kurani?


Një njeri i paarsimuar, pa parë derën e shkollës, të sjellë e të predikojë një sistem individual, familjar, shoqëror-ekonomik dhe juridik, pa të meta, kjo bie në kundërshtim me aparençën mendore e logjike, sidomos po të jetë ky sistem aq i shkëlqyer, sa të zbatohet për shekuj të tërë nga një sërë kombesh miq e armiq midis tyre e të ruajë gjer më sot freskinë e vet!

Si dje, ashtu edhe sot është po ai Person i pashkrim e i palexim që vazhdon t'i sfidojë të gjitha ç'janë shkruar e thënë nga dijetarët dhe letrarët më të mëdhenj të të gjitha kohëve. Sot, kur në përgjithësi

pranohet se shkencat kanë arritur një zhvillim të madh, ai sikur u thotë fizikanëve, kimistëve, astronomëve, mjekëve, sociologëve, poetëve e shkrimtarëve, të gjithëve: “Bëhuni bashkë e sillni jo shumë, por vetëm një pjesë, sa një sure të Kuranit!” Në Kuranin famëlartë Allahu (xh. sh.) i kërkon Muhamedit (s.a.v.s.) që tu drejtohet atyre që pretendojnë se Kurani është vepër e njeriut me fjalët:

Thuaj: “Sikur të tuboheshin të gjithë njerëzit dhe xhindet për të hartuar një Kuran të tillë, ata nuk do të mund të hartonin një të ngjashme me të, madje, edhe sikur ta ndihmonin njëri - tjetrin”. (El Isra, 88)

“Nëse ata thonë: ‘Ai (Muhamedi) e ka trilluar atë (Kuranin)!’ Thuaju (o Muhamedi!): ‘Sillni dhjetë sure të ngja-



shme (në bukuri dhe elokuencë) të trilluara (siç thoni ju) dhe thirrni në ndihmë kë të mundni, përveç Allahut, nëse thoni të vërtetën!” (Hudë, 13)

“Nëse ju dyshoni në atë që ia kemi zbritur robët tonë (Muhamedit a. s.), atëherë hartoni një sure të ngjashme me atë që ia kemi shpallur atij! Thirrni në ndihmë edhe dëshmitarët tuaj (që i adhuron) në vend të Allahut, nëse jeni të sinqertë (në thëniet tuaja se Kurani nuk është prej Zotit).” (El Bekare, 23)

“Nëse ata thonë: ‘Ai (Muhamedi) e ka trilluar atë (Kuranin), thuaju: ‘Atëherë, sillni një sure të ngjashme me të dhe thirrni (në ndihmë) kë të mundni,

përveç Allahut, nëse thoni të vërtetën!’” (Junus, 38) Që do të thotë, thirrni në ndihmë xhindet, melaqet dhe të gjithë gjenitë e mendimit njerëzor dhe përpiloni së paku një kaptinë të ngjashme. Kjo thirrje akoma është aktuale. Mirëpo, ende askush asnjëherë nuk arriti të bëjë asgjë.

Ndryshimi ndërmjet mënyrës së shprehjes së Kuranit dhe mënyrës së shprehjes së peygamberit Muhamed (s.a.v.s.) dallohen mjaft lehtë. Ndërmjet stilit gjuhësor e letrar të Kuranit dhe stilit gjuhësor e letrar të haditheve (porosive) të Peygamberit (s.a.v.s.), ka një ndryshim shumë të madh. Gjuha e haditheve të Peygamberit ishte shumë më e kuptueshme, karshi shprehjeve kuranore, nga të cilat habiteshin dhe mahniteshin edhe vetë arabët. Duke lexuar porosinë e Peygamberit (s.a.v.s.), kuptohet qartë se aty përvijohet imazhi i një njeriu që mendon e bisedon i përulur nga frika e Allahut (xh. sh.), kurse në zërin e Kuranit ndihet një guxim i lartë, një vizion tronditës e një tingëllimë madhështore. Logjikisht, nuk është as e mundur dhe as e pranueshme që në shprehjen e një njeriu të sendërtohen aty për aty dy stile aq të ndryshme nga njëri-tjetri. Këtu shihet se Muhamedi (s.a.v.s.) është një njeri si të tjerët, me dallimin e vetëm se atij i shpallet, i vjen relevata (shpallja) nga Zoti (xh. sh.), gjë të cilën e pohon vetë Kurani:

“Thuaj: Unë jam vetëm njeri, sikurse ju; mua më shpallet se vetëm një Zot është Zoti juaj, e kush është që e shpreson takimin e Zotit të vet, le të bëjë vepër të mirë, e në adhurimin ndaj Zotit të tij të mos përziejë askë.” (El Kehf, 110)

Dhe, në fund, përse askush dhe asnjëherë nuk e dëgjoi Muhamedin (s.a.v.s.) të pranonte, apo të theksonte se ai vetë ishte autor i Kuranit?

(Autori është Imam në Xhaminë e Killeznës, Ulqin)

<sup>i</sup> Ahmed Deedat, “Kur’ani- mrekullia e mrekullive”, Podujevë, fq. 13.

<sup>ii</sup> Ajni Sinani, “Të tjerët për Islamin”, Priştinë, 2005, fq.108.

<sup>iii</sup> Sure (arab.) – Kapitull i Kuranit. Kapitulli përbëhet prej një numri të caktuar ajetesh (citatesh). Gjithsej në Kuran ka 114 kapituj.

<sup>iv</sup> Mustafa Mahmud, “Rruga për njohjen e Zotit”, Shkup, 2011, fq. 99.



# HAFIZ ALI KORÇA...

-Vështrime rreth figurës së tij-



Shkruan: Xhahid Bushati  
(Enkas për HeR)

Në vend të parathënies

1.

MREKULLIMI VETË

“Jules Renard i këshillon të gjithë ata që merren me shkrime: “Një shkrimtar duhet të shkruajë ashtu siç merr frymë.” Pa dyshim që kjo është këshillë e vështirë për t’iu përmbajtur. Këtu, nuk ka të bëjë vetëm me tekstin ontologjik të shkrimit të përmendur, por, gjithashtu, në të njëjtën kohë, nuk duhet harruar të theksohet edhe natyra dhe harmonia që bart shkrimi në vete.”[1]

Citimi që bëra në hyrje, mendoj se në disa pika i përshtatet madhësisë dhe poliedricitetit të figurës së Hafiz Ali Korçës.

Jam mrekulluar me vështrimet largpamëse teologjike.

Jam mrekulluar me filozofinë e tij, me vizionet.

Jam mrekulluar me shqiptarinë e tij.

Jam mrekulluar me dheun e MËMËS që mbajti në shpirt.

Jam mrekulluar me kontributet e tij të vyera në shumë gjini letrare.

Jam mrekulluar me Madhësitinë e TIJ.

Jam mrekulluar..!

Vështrimi i parë

2.

PËRBALLË MEJE... HAFIZ ALI KORÇA

Kam përballë meje kolanën prej 12 vëllimesh, me emrin e nderuar, largpamës, shndritës gjithë nur: Hafiz Ali Korça. E shqiptoj këtë emër me nderimin dhe respektin më të madh dhe kuptoj se Hafizi i ditur: u përball me kohën, triumfoi dhe bëri kohën e tij; u përball me epokën dhe bëri epokën triumfuese; u përball



me errësirën dhe bëri DRITËN e tij, që rrezaton ndër ne.

Kuvendimi me këtë opus vlerash që mbajnë shenjtëri brenda çdo germe, çdo fjale, çdo fraze, kuvendimi me Hafizin shpresëdhënës e plot urtësi, është i gjatë, dhe do të jetë i gjatë...

Shkrimet dhe krijimet, filozofia dhe


përkthimet, interpretimet e shumë dukuri që sillnin kohërat në rrjedhën e tyre, në të shumtën e rasteve kanë sfiduar vitet dhe realitetet. Hafiz Aliu udhëtonte drejt dritës dhe përparimit. Kështu janë Kolo-sët..., “përkthehen” në modele të rralla, ku çdo Epoke i duhen domosdoshmërisht.

Ato vepra të çmueshme të asaj ‘kolane’, edhe pse vështrojnë, ashtu, në mënyrë të madhërishtme, flasin edhe në heshtje... Brenda faqeve të saj janë fiksuar realitete shpesh të turbullta e të hirta, shpesh dramatike edhe për të... Brenda faqeve të saj janë shpalosur dije shprese e jetëdhënese për njeriun, për njeriun e vërtetë... Janë shpalosur dijet e një Dijetari të Madh, për të cilin zemra e tij ishte toka mëmë, ishte Shqipëria, ishte Shqipëria. Hafizi, në personalitetin e tij, e kam quajtur - aty ku drita kthehet në fisnikëri dhe fisnikëria kthehet në dritë.

Emocioni që më fal ‘kolana’ është gjithashtu i madh dhe i papërsëritshëm. Mendoj që jam përballë një Enciklopedie. Më duket sikur edhe ky krahasim është disi i mangët. Vetiu më vjen në mendje ta krahasoj me një Universitet. Po e lëmë kështu. I tillë është! Pra, ngado që të marrësh udhën, pra të trokasësh në çdo portë të këtij libri, e kupton menjëherë se shkon drejt dijes së vërtetë, drejt viteve, drejt vlerave të pazëvendësueshme, drejt njohjes e kërkimit të panjohjes, drejt një magjie diturake e urtake, të cilat me shumë përkushtim e sakrificë, sakrificë deri në dhembje, na i fali mirësia e talenti i Dijetarit të Madh. I urtë, i pafjalë, i thjeshtë, me plagë e dhimbje në shpirt e në zemër, i vetmuar por i papërkuluar, modest por gjer në madhësi, deri në pavdekësi. Me një spikatje rrezatuese. Ky autor, në procesin krijues me shkrimet e tyre (të gjinive të ndryshme) ka emrin, shenjat dhe gjurmët e tij për t’i njohur brezat e për t’i përvetësuar, për të kuptuar se cila ishte e djeshmja, cila është e sotmja dhe cila është e nesërmja. Ndaj, Hafizi u kthye në Kujtesë. E, kjo nuk është pak. I ngjan një përmendoreje, ku Hafizi dhe Historia flasin me zërin e së vërtetës. Flet autentikja, pra kombëtarja, flasin mesazhet, flet mbarësia si në dritën e diellit: larg mashtrimit, heshtjes, fshehjes, injorancës, deformimit dhe përgënjeshtrimit.

Shfletoj me kujdes çdo faqe... Në atë fëshfëritje flete më flet një kronikë, një ndodhi, një ngjarje, një poezi, një përkthim, një shkrim publicistik, një abetare, një hadith, pjesë kuranore, një personazh, një akt bese, një fjalë e fundit, një amanet, një histori... Më flasin vizionet, se Hafiz Ali Korça ishte vizionar i madh.

Komunikoj me çdo fjalë, me hapësirën e saj. Komunikoj me autorin (edhe pse pas kaq vitesh), me kumtin e tij që të fal dhe të përcjell, me nëntekstin, me sekretet e krijimit, me fjalët kyç që mbartin, me mesazhet që përcjellin... Dhe, në shpirtin tim hyjnë si pa kuptuar motive të pafund... U qasem me vëmendje.



Në këtë shumësi vlerash njohëse, kulturore, të virtutshme e edukative; po bëj përpjekje për të zbuluar e studiuar sado pak vertikalishtin e kësaj veprë madhore në historinë e islamologjisë, filozofisë dhe kulturës shqiptare, siç është vepra madhore e Hafiz Ali Korçës.

Hafiz Ali Korça, Madhështia vetë!

Vështrimi i dytë  
3.

### DRITA DHE PERSONALITETI I HAFIZ ALI KORÇËS

Njëri nga bashkëpunëtorët e ngushtë të revistës “Zani i Naltë”, që në fillimet e saj dhe në disa numra më pas, qe dhe Hafiz Ali Korça. Nderimi për veprën e tij është pak të thuash nderim. Mbase duhet kërkuar ndonjë fjalë tjetër magjike në fjalorë, epistolarë a enciklopedi. Burrë i ditur, burrë i mençur. Me një diapazon të gjerë kulture dhe rrezatim diturie. Nga ata burra, ndonëse të pakët të kësaj natyre tipologjike, që nderojnë Kombin. Poliedriciteti i figurës së tij më sjell ndër mend Nolin e Madh.

Hafiz Ali Korça - Atdhetar dhe luftëtar në Lëvizjen kombëtare, kontribues i pashoq në fushën e arsimit, të gjuhës, të letërsisë për fëmijë. Gjithashtu, kontribues i pashoq në lëmin e historisë, islamistikës, kulturës (poet e përkthyes), publicistikës, filozofisë etj. Me një rrugë të gjatë, të mundimshme, me plot dhembje e sakrificë. Si askush. Në këtë rrugë të gjatë, teksa Hafizi i nderuar shpërndante rrezatimin e diturisë së tij, erudicionin dhe poliglotësinë, kurrë nuk e kishte menduar se do të kishte ditë dhe vite që Ai do të njihet edhe me fjalët e tmerishme: harresë, shpërfillje, periferi, joprotagonist, izolim, burg, drobitje, mjerim, tragjizim, dëshpërim, etj. Po citoj këto dy fragmente, për të përligjur argumentet e mësipërme. Fragmenti i parë: “Një plak krenar, me shtat të bëshëm, me mjekër të zeze e çallmë mbi kokë, me

xhybe të zeze, përplot fuqi e i pathyeshëm, dukej Ai pas Luftës së Dytë Botërore.” Fragmenti i dytë: Kur u internua në Kavajë. “... dukej i molisur, i lodhur shpirtërisht e fizikisht, i izoluar në këtë qytet të vogël. ... Vitet e fundit ndjehej i braktisur.”

Hafiz Aliu ruajti në substancën e emrit dhe mbiemrit të tij, si gur të çmuar fjalën e bukur shqipe: Korça. E përjetësoi. Më sjell ndër mend Lasgushin, poetin modern të letrave shqipe. Poradecin e tij të dashur e të shtrenjtë edhe ai e gdhendi si mbiemër. Hafiz Aliu, i nderuar!.. Foli dhe u shpreh shqipërisht në mënyrë të madhërishtme. Fund e krye. Me shqipen e zemrës, me shqipen e shpirtit, me shqipen-amanet; ndonëse në jetën e tij, në atë të lindjes kishte një prill, muaj që të kujtojnë lulet; ashtu si në pragvdekjen e tij kishte një dhjetor që të kujtojnë: acarin, dëborën e dhimbshme, të ftohtin, erën e tërbueme. Hafiz Aliu, i nderuar!..

Në pragvdekjen e tij më kujton Migjenin. Se Hafizi qe një figurë tragjike, po ashtu dhe Migjeni – figurë tragjike. Se Hafizi pati një vatër drite që ndikoi në formimin e tij dhe quhej: Stamboll. Po ashtu edhe Migjeni – vatra e tij e formimit quhej Manastir. Trashëgimia që na la Hafizi, është botuar si kolanë prej 12 veprash nga Shtëpia Botuese Logos A, në vitin 2006. Nderim për këtë Shtëpi Botuese! Akt fisnik i saj! Nuk ka panteon më të bukur se sa opusit jetëdhënës e diturues të Hafiz Ali Korçës që i ka bërë kjo Shtëpi Botuese!

Vështrimi i tretë  
4.


### ‘SHENJAT’ E HAFIZIT...

Hafiz Ali Korça ishte një figurë poliedrike. Çdo faqe e këtij poliedri ka shkëlqimin e mendimtarit dhe të bibliotekës së tij. Çdo faqe e këtij poliedri ka bekimin e tokës që e lindi, ku çdo copëz të saj e “vaditi” dhe e ushqeu me zemrën

dhe shpirtin e tij që ia përvëluan, që ia dogjën sa më s’ka. Atdhedashuria e Hafizit është një ‘XHYBE’ që s’mund ta vesh kushdo...

Kontributet e Hafizit në gjinitë e ndryshme që lëvroi ishin gjurmëlënëse. Këtu, duke përfshirë edhe konceptet e tij filozofike, sociale, juridike (fetva-të) etj., e në mënyrë të veçantë mbi religjionin (*religion, religiosity*), e në mënyrë më të veçantë mbi myslimanizmin dhe myslimanët, që gjithë jetën e tij këto dy nocione të dritshme i zëbrtheu, i interpretoi duke u dhënë dritë prej HAFIZI. Mendja e tij prej Dijetari-hulumtues qe e ndritshme, gjithëpërfshirëse, sa çdo tekst i Hafizit i ngjan diellit të mungjesit që ta ka ënda, që sjell ngrohtësinë dhe gjelbërimin e një dite të vlefshme, të dobishme e të mbarë; aromën e saj sa hyjnore, aq edhe njerëzore.

Por, vëmendja ime kësaj radhe ka “stacionuar” në vëllimin e parë të kolanës së revistës “Zani i Naltë”, e që përfshin vitet 1923, 1924 e 1925; ku ndihmesa, kontributet dhe ‘shenjat’ magjike, poetike, atdhetare e filozofike të Korçës janë të dukshme, “të prekshme”, interesante dhe të papërsëritshme. Veçori kulture e tharm realiteti. Të gjitha këto prurje (gjurmëmbara, që vit pas viti do të shtohen e do të rriten), të cilat zanafillën e shfaqjes së parë, të jetës prej dijetari të papërsëritshëm të Hafizit, e kanë në misionin e kësaj Reviste të çmueshme dhe... ku herët (që në tekstet e para) shfaqet dhe përcaktohet si individualitet (me cilësi intelektuale, fetare, krijuese dhe kulturore). Po kështu i tillë është, po kështu i tillë mbeti edhe në peizazhin letrar të atyre viteve që përkrijnë (duke për-



shirë materialet dhe tekstet e tij në revistën “Zani i Naltë” (1.) Paçka se studiuesit dhe kritikët nuk e njohën edhe aq mirë, saqë mbetën anemikë, shpesh dhe lili-putë, para madhërshtisë dhe dijeve të Hafiz Ali Korçës.

Vështrimi i katërt  
5.

### HAFIZ ALI KORÇA DHE POEZIA “VAJTIMET E ATDHEUT”

Hafiz Aliu (nënkupto Hafiz Ali Korça) në revistën “Zani i Naltë”, nr. 11, gusht 1924, botoi poezinë “Vajtimet e Atdheut”. Kjo poezi me natyrë, frymëmarrje dhe theks elegjiak është përfshirë në vëllimin e parë të kolanës “Zani i Naltë”, e cila përfshin vitet 1923 – 1924

### KAVAJË, 31 DHJETOR 1956

*Më 31 dhjetor 1956, në qytetin e Kavajës, ka ndërruar jetë Hafiz Ali Korça, njëri nga dijetarët dhe personalitetet më të larta shqiptare gjatë shekullit 20 e më gjerë. Vdekja e një njeriu të mirë është e dhimbshme për familjen dhe shoqërinë, por vdekja e një dijetari të madh është humbje për të gjithë kombin. Dijetar i tillë ishte dhe Hafiz Ali Korça, i cili gjithë jetën e tij në dynja ia kushtoi diturisë dhe atdhedashurisë. Librat e tij ishin dhe janë ende sot flakadanë diturie për ata që kërkojnë diturinë, kanë vlerësuar njohësit e veprës së tij.*

– 1925. Poezia autoriale është paraqitur dhe shënjohet në faqen 349 të kësaj kolane. Më pas kjo poezi vajtimtare është përmbledhur në kolanën e veprave të Korçës e, pikërisht në Veprën 2, botuar nga Logos A, Shkup, 2006. Kjo poezi me titullin trishtues, plot dhembje, lot e vajtime “Vajtimet e Atdheut”, që ia kushton Kosovës, është dhe jeton brenda hapësirës së vëllimit “Shtat ëndrat e Shqipërisë”. [2]

Po të bëjmë krahasimet e botimeve, mendojmë që te kolana “Zani i Naltë” 1, nga pikëpamja e kompozicionit dhe strukturës së poezisë, theksohen më qartas veçoritë e konceptimit të saj. Po në këtë vëllim është treguar edhe një kujdes në ndërhyrjen ortografike, me qëllimin për ta bërë sa më të lexueshme poezinë e Korçës. Ndërsa në kolanën e veprave të Hafiz Aliut është ruajtur autentikja e botimit origjinal të autorit.

Përse u ndala te kjo poezi elegjiake? Gjatë leximit tekstor, nocioni i kohës ishte i pranishëm. Vetë koha “shëtiste” në tri plane: në të djeshmen, në të sotmen dhe në të ardhmen. Një marrëdhënie e shumëfishtë, sepse vetë kjo kohësi përkonte në ekzistencën e saj. Rrekej drejt lirisë. Rrekej të jetonte. Kjo, njëra anë. Ana tjetër: për të pohuar dy dukuri të Hafizit të nderuar, të shtrira në kohë dhe në hapësirë. E para, e gjithë krijimtaria letrare përkohet e shënjohet nga motivi patriotik e atdhedashës i tij. E dyta, shpërfaqet shpirti shqiptar, thellësisht shqiptar, i shqiptarizmes së Ali Korçës, siç thotë vetë, “i një atdhetari idealist”.

Poezia - si në substancën e saj, si në titullin që mbart - flet e komunikon përmes një simbolike tronditëse, e cila gjën plazmim në çdo figurë poetike e në çdo varg të saj. Kjo është dhe arsyeja që nga pikëpamja e teknikës së vargëzimit është shkruar në monokolonë. Gjegjësisht e përligjur.

Në poezinë e Hafizit, Kosova, edhe pse përmes lotëve, jeton e bukur dhe e dritshme. Ajo është një mrekulli, e cila ‘folenë’ e ka në shpirtin e madhërishtëm të Hafizit. Kuvendimi i tyre në këtë poezi shfaq sublimen dhe dashurinë e Dheut.

[1] SU HUSEYIN: Shkrimi dhe Fati, Fleta, Prizren, 2019, shkrimi: “Rreth shkrimit dhe fatit”, fq. 5.

[2] Korça, Hafiz Ali: Shtat ëndrat e Shqipërisë, Vepra 2, Vajtimet e Atdheut, fq. 121 – 125; Logos A, Shkup 2006.

# 100 VJET NGA HIMNI TURK I SHQIPTARIT NGA PEJA



**M**e rastin e 100-vjetorit të Himnit Kombëtar të Republikës së Turqisë, Fakulteti i Studimeve Islame i Prishtinës më 28 dhjetor, 2021, ka organizuar sesionin shkencor “Kontributi dhe vepra e Mehmet Akif Ersoj-Pejanit”, autor i këtij himni. Fjalën e hapjes e ka pasur prof. asoc. dr. Fahrush Rexhepi, Dekan i FSI-së. Me fjalë rasti është paraqitur Myfti Naim ef. Tërnavë, Kryetar i Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK), njoftojnë nga BIK.

Sesioni shkencor është organizuar nga Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, në bashkëpunim me Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë. Në të u veçuan kontributet e Mehmet Akif Ersoj - Pejanit si besimtar, dijetar, akademik, poet, pedagog, shkrimtar, deputet etj., të cilat epitete Mehmet Akif Ersoj (Ersoy) i posedonte. Ai u konsiderua edhe urë lidhëse mes popullit të Kosovës dhe të Turqisë.

Ka pasur disa kumtesa. Kumtesa e studiuesit Nuredin Ahmeti ka qenë me titull “Kontributi i Kosovës në luftën kombëtare të Turqisë dhe Mehmet Akif Ersoji”. Musa Vila, ndërkaq, është paraqitur me kumtesën me titull “Mehmet Akif Ersoji-njeriu që i shërbeu të vërtetës (fetare dhe kombëtare)”. Ishte një organizim i nivelit të lartë akademik-shkencor nga FSI, nën patronazhin e Dekanit të FSI, ka shkruar prof. Musa Vila në rrjetet sociale.

Hajrullah Sherifi për Mehmet Akif Ersojin:

Shqiptari që e shkroi himnin e Tur-

qisë: Lexoni 6 fakte për Mehmet Akif-in. Mehmet Akif Ersoy, babai i të cilit ishte nga fshati Shushicë, dikur pjesë e Pejës, sot komuna e Istogut, ishte autori i Himnit Kombëtar të Republikës së Turqisë.

Mehmet Akif Ersoj lindi në Stamboll më 20 dhjetor 1873, në një familje besimtare, intelektuale. Babai i tij ishte Tahir efendi, një myderriz i njohur në medresenë e famshme “Fatih” të Stambollit. Tahiri kishte lindur në Shushicë të Pejës.

Më poshtë ju sjell 6 fakte që s’i keni ditur rreth tij:

1. Mehmet Akif Ersoj është marrë edhe me krijimtari letrare dhe artistike, duke lënë si trashëgim një thesar të tërë, një pasuri që mund të ndahet në dy kategori: Veprat e shkruara në vargje, ose veprat poetike dhe veprat e shkruara në prozë.

2. Vitet e fundit të jetës së tij kaloi në Egjipt. Kur ishte në Egjipt, ai merrej me mësimin e turqishtes tek të huajt, sikurse edhe sot Institutet Junus Emre.

3. Veprat e shkruara në vargje janë të përmbledhura me një emërtim të përgjithshëm “Safahat”, ose “Fletët”.

4. Ndonëse i lindur në Stamboll, Turqi, ai ka pohuar me krenari se është shqiptar. Mehmet Akif Ersoj në shumë shkrime përmend Shqipërinë, Kosovën, Prizrenin, Pejën, Gjakovën.

5. Kur shëndeti i tij u përkeqësua, ai shkoi në Stamboll, ku më 27 dhjetor 1936 ndërroi jetë.

6. Historia e Himnit Kombëtar Turk: Në vitin 1921, me kërkesën e ushtara-

këve, Ministria e Kulturës u dha gazetave të datës 7 nëntor një njoftim, ku bëhej e ditur: “Shpallet konkurs për Marshin e Pavarësisë dhe se për fituesin e tekstit dhe të melodisë do të jepej nga një shpërblim prej 500 lirash”. Në qendrën e konkursit u paraqitën mbi shtatëqind tekste, por, me gjithë këtë, komisioni vlerësues nuk pranoi asnjë poezi, sepse asnjë prej tyre nuk i plotësonte kriteret e kërkua që të zgjonte ndikimet e dëshiruara. Atëherë Hamidullah Suphiu, që ishte ministër i Kulturës, me gjithë komisionin vlerësues, iu drejtuan Mehmed Akifit që të shkruajë poezinë. Mehmed Akif Ersoj iu përgjigj ministrit se poezinë do ta bënte, por se ai nuk shkruante për para, edhe pse në varfëri dhe nuk ka pasur edhe një pallto për të veshur. Kur ministri me bashkëpunorët i premtuan se “nuk do t’i jepnin shpërblimin edhe nëse do të fitonte”, ai me këtë kusht e shkroi tekstin. Marshi i Pavarësisë (Istiklal Marshi), i shkruar nga Mehmed Akifi, u lexua në Kuvendin e Madh të Kombit (Parlamentin Turk) më 1 mars 1921, dhe po më 21 mars 1921 u pranua dhe u votua zyrtarisht.

Revista “Hëna e Re” tekstin e Hajrullah Sherifit e ka pranuar nga veprimtari i shquar shqiptar në Turqi Qamil Bytyqi (Kamil Bitiş), Drejtor i Qendrës Kulturore të Kosovës në Stamboll, mësues i gjuhës shqipe dhe autor i më shumë veprave, në mesin e të cilave “Shqiptarët e harruar në Turqi” (2021) etj.

# PRISHTINË: SHËNOHET 70-VJETORI I MEDRESESË “ALAUDDIN”



Me intonimin e himnit kombëtar dhe atij shtetëror, në mënyrë solemne është shënuar 70-vjetori i themelimit të Medresesë së Mesme Alauddin në Prishtinë.

Në këtë manifestim, që u organizua nga Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës dhe Medresea Alauddin në Prishtinë, morën pjesë Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, Kryeministri i Kosovës z. Albin Kurti, Presidenti i mëparshëm i Republikës së Kosovës z. Behgjet Pacolli, Përfaqësuesi i Presidentes së Kosovës z. Bekim Kupina, Ambasadori i Republikës së Turqisë Çağrı Sakar, Përfaqësuesi i Ambasadës Amerikane z. Dominik Kryetari i Prishtinës z. Përparim Rama, përfaqësues të Ministrisë së Arsimit, deputetë të Parlamentit të Republikës së Kosovës, Drejtori i Institutit Albanologjik z. Hysen Matoshi, Drejtori i Institutit të Historisë z. Sabit Syla, Drejtori i Arkivave të Kosovës z. Bedri Zyberaj, Drejtori i Shoqatës së ish-të Burgosurve Politik z. Selatin Novosella, Drejtori i Medresesë Isa Beu prof. Ibrahim Idrizi, përfaqësues të institucioneve qendrore dhe lokale të vendit, drejtues të institucioneve të Bashkësisë Islame, ish-drejtorë të Medresesë, profesorë, pedagogë dhe personeli i Medresesë.

Mysafirëve iu dëshiroi mirëseardhje Drejtori i Medresesë z. Fadil Hasani, i cili i falënderoi të gjithë pjesëmarrësit e këtij

manifestimi dhe çmoi kontributin e shkollës, të dëshmuar gjatë viteve, qoftë në rrafshin fetar, qoftë në atë kombëtar. Ai më pas theksoi se Medresea ishte gjithmonë në shërbim të fesë dhe të atdheut, duke kultivuar hoxhallarë, ushtarë, policë dhe shumë profesione të ndryshme.

Këtë manifestim e përshëndeti edhe Myftiu Naim Tërnavë, i cili Medresesë i uroi nga zemra jetë të gjatë, suksese dhe veprimtari të begatë, si dhe përmbushje të plotë të misionit të saj hyjnor, historik e kombëtar. Ai më pas tha se Medresea Alauddin ishte e para në të gjitha trojet shqiptare, e cila funksiononte vetëm në gjuhën shqipe. Tërnavë tha se fati i Medresesë është i lidhur ngushtë edhe me fatin e popullit shqiptar, sidomos në luftën e fundit në Kosovë. “Nuk është e tepërt të potencohet fakti se fati i Medresesë Alauddin vazhdimisht ishte i lidhur ngushtë me fatin e popullit të Kosovës. Ajo gjithmonë mori frymë me popullin e kjo mori vlerë sidomos në periudhën 1998/99 të shekullit të shkruar, me veprimtarinë e saj të suksesshme atdhetare. Bashkësia Islame e Kosovës duke qenë e vetëdijshme për problemet, synimet, rrezikun që i kanosej vendit, në të shumtën e rasteve ishte më shumë vizionare se shumë ata të cilët kishin për objektiv vizionin”, tha Tërnavë. Bashkësia Islame tërë infrastrukturën e saj në tërë vendin e ofroi në shërbim të çështjes

kombëtare, e në veçanti do të jetë medresea “Alauddin” ajo e cila qysh me rastin e largimit të studentëve nga konviktet e tyre më 1989, do të strehojë një numër të konsiderueshëm të tyre dhe do të përkujdeset për ta. Që këtu e tutje, Medresea do të jetë pothuajse adresa e të gjitha aktiviteteve politike, shkencore, sindikaliste, artistike, kulturore e sportive në nivel të Republikës së Kosovës. Në këtë përvjetor të rëndësishëm, në këtë manifestim çmojmë, nderojmë, njohim e vlerësojmë me një mirënjohje të veçantë të gjithë drejtuesit, pedagogët, nxënësit dhe të gjithë ata që me angazhimin, punën, përkushtimin, sakrificën, dijen dhe kontributin e tyre punuan për ngritjen dhe zhvillimin e Medresesë, duke e bërë atë një qendër të rëndësishme të veçantë të edukimit dhe të arsimit, e cila medrese jetoi e bashkëlidhur dhe e pandarë me fatin e popullit dhe të vendit tonë.

Kryeministri i Kosovës, z. Albin Kurti, tha se besimi shërben si direktivë për çdo hap të jetës.

Ne duhet ta mirëmbajmë veten tonë si shembull për harmoni ndërfaqetare, shembull për demokraci dhe shembull që besimi dhe tradita fetare, çfarëdo qofshin ato, mund të përjetohen në mënyrë origjinale edhe në kohërat moderne. Kryeministri Kurti, cili përmendi fjalët e profetit Muhamed rreth kërkimit të diturisë deri në fund të botës, tha se në besim, në prak-



tikë dhe në lutje ka përpjekje për edukim të njerëzimit. “Unë e di që sot, më shumë se një shekull pas, mes medresantëve këtu, ka nxënës po kaq të shkëlqyer dhe edhe më shumë të përkushtuar për dije. Leximi, në formë urdhërore si fjala që hap tekstin e Kuranit dhe këshilla e Muhamedit (a. s.) për të kërkuar dijen deri në fund të botës, besoj se janë motiv nismëtar për medresantët këtu, bashkë me synimin për emancipim dhe kontributdhënie në shoqëri.” Ai tha se tradita e besimit dhe ajo shqiptare janë në harmoni të ngushtë dhe duhet të mirëmbahen si të tilla. “Si një popull me shumicë myslimane, shqiptarët ditën ta ruajnë Islamit mes tyre edhe gjatë këtyre dy dekadave të fundit, kur për shkak të luftës globale kundër terrorizmit, të ishe mysliman ishte e vështirë, sikur ta mbaje një gacë në dorë, saktë siç kishte parashikuar profeti i Islamit, Muhamed. Ne duhet ta mirëmbajmë veten tonë dhe harmoninë ndërfaqetare, shembull për demokracinë dhe shembull që besimi dhe tradita fetare çfarëdo qofshin ato, mund të përjetohen në mënyrë origjinale edhe në kohërat moderne”, tha Kurti.

Këshilltari i Presidentes Osmani, z. Bekim Kupina, në emrin e Presidentes Osmani përcolli medaljen presidenciale “Për liri dhe pavarësi” për medresenë “Alauddin”, për kontributin e dhënë ndër vite. “Muret e këtij objekti janë dëshmitarë të kohës së një pjesë të lavdishme të historisë sonë, ku në këtë vatër diturie, mësimi dhe aktiviteti kombëtar ishin bërë një. Në këtë përvjetor Medreseja Alauddin meriton respekt për kontributin që ka dhënë në procesin e lirisë dhe të pavarësisë së vendit. Historia dhe kontributi i Medresesë është njëjtë me historinë e shtetit tonë; ajo nuk mund të shihet ndaras. Roli i kësaj shkolle është për t’u admiruar në krijimin e klimës së tolerancës ndërfaqetare, e cila është e shquar tek populli ynë dhe ajo thjesht nuk është vetëm

një shkollë, por është një pikë ndalese e secilit prej nesh, monument trashëgimie i një periudhe historike. Kjo medrese është histori në vete” – tha Kupina.

Kryetari i AKR-së dhe Presidenti i mëparshëm i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli, në një fjalë rasti i ka uruar suksese të mëtutjeshme shkollës së mesme. “Ju, mësimdhënësit, akademikët e këtij tempulli, na keni mësuar si të je-tojmë, si të sillemi me njëri-tjetrin, si ta duam njëri-tjetrin”, tha Presidenti i mëparshëm Pacolli.

Medreseja “Alauddin” i nderoi me mirënjohje ish-drejtorët dhe disa pedagogë me rastin e kontributeve të tyre gjatë historisë së Medresesë, në ngritjen dhe avancimin e saj. Me mirënjohje u nderua ish-drejtori, tani Myftiu i Kosovës Naim ef. Tërnavë, ish drejtorët dhe pedagogët: prof. Ekrem Simnica, Bahri ef. Simnica, Jakup ef. Çunaku, Sulejman Osmani, ish-sekretar i Medresesë Alauddin në Prishtinë.

Po ashtu, mirënjohje ndau edhe Kryetari i të Burgosurve Politik z. Selatin Novella, i cili ka zhvilluar aktivitet një kohë të gjatë në ambientet e Medresesë Alauddin në Prishtinë. Ai tha se gjithnjë e kam theksuar se kur të shkruhet historiku i Prishtinës, do të jetë i mangët dhe jo i plotë pa përfshirjen e rolit dhe të kontributit të

### URIME NGA MEDRESEJA ISA BEU

**Më 22 dhjetor, 2021, Medreseja Alauddin në Prishtinë shënoi 70-vjetorin e themelimit. Nga SHMI “Medreseja Isa Beu” në Shkup në manifestimin e organizuar me këtë rast ishte Drejtori, prof. Ibrahim Idrizi, i shoqëruar nga Sekretari, prof. Lutfi Nexhipi, thuhet në njoftimin e Medresesë Isa Beu, Shkup. Medreseja Isa Beu i përcolli urimet e Drejtorisë së Medresesë, të stafit edukativo-arsimor, të BFI-së, me lutje tek i Madhi Zot që këtë vatër edukativo-arsimore ta përcjellë drita e arsimit dhe e dijës, drita e edukatës, drita e punës dhe e suksesit, si dhe drita e fesë dhe e atdhedashurisë, thuhet në njoftimin e Medresesë Isa Beu. (23.12.2021)**

Medresesë Alauddin dhe kur të shkruhet historia e UÇK-së, posaçërisht ku shkruhet për logjistikën e UÇK-së, nuk mund të merret me mend se mund të shkruhet pa praninë, aktivitetin, sakrificën e Medresesë Alauddin. Kjo shkollë ishte magjia e UÇK-së, andaj me kënaqësi, me gëzimin më të madh, po e ndaj mirënjohjen në emër të Kryesisë së Shoqatës së të Burgosurve Politik për kontributin që Medreseja ka dhënë në Këshillin Republikan për Ndhmë Emergjente.

Për këtë, ndiejmë mirënjohje të veçantë për krahun e djathtë që e kishte dërguar Zoti për neve si Këshill, edhe për luftën, që e kishim Drejtorin e atëherëshëm të kësaj shkolle Naim ef. Tërnavën, pa mbështetjen dhe pa kontributin financiar të të cilit nuk kemi mundur të funksionojmë.

Medreseja gjatë kohës së luftës ka qenë spital, ka pranuar studentët me ditë e net të tëra dhe i ka strehuar ata të cilëve u ishin djegur shtëpitë dhe UÇK-ja e ka pasur një adresë - nëse mbyllen të gjitha rrugët, dhe shpeshherë janë mbyllur, dera e Medresesë ka qenë 24 orë e hapur për neve- tha Novosella.

Me ilahinë “Drita e Prishtinës” u paraqit lexuesi i Kuranit dhe ish-nxënësi i kësaj shkolle Egzon Ibrahimimi.

Po ashtu, në këtë manifestim Kori i medresesë Alauddin dha një program të pasur kulturo-artistik, me ilahi e kaside, si dhe u shfaq versioni i shkurtuar i filmi dokumentar, i përgatitur para 20 vitesh, që trajton historikun dhe kontributin e Medresesë Alauddin ndër vite, që nga themelimi.

Krejt në fund, pjesëmarrësit patën rastin të shohin ekspozitën me rastin e shënimit të 70-vjetorit të Medresesë Alauddin në Prishtinë. (22.12.2021)

*Burimi (në bashkëpunim): <https://bislame.net/shenohet-70-vjetori-i-medresese-alauddin/>*

# BFI DHE BIK BASHKËRISHT NË SHËRBIM TË ZOTIT, TË KOMBIT DHE TË VATANIT



Më 19 janar, 2022, në Shkup, përkatësisht në Selinë e Bashkësisë Fetare Islame të RMV, u realizua takimi i shumëpritur i dy delegacioneve të nivelit të lartë mes Bashkësisë Fetare Islame të RMV dhe Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës, udhëhequr nga Reis’ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu dhe Myfti mr. Naim ef. Tërnavë, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Në zyrën e tij, Kryetari i BFI të RMV, Reis’ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në emër të BFI dhe të delegacionit i dëshiroi mirëseardhje homologut të tij dhe tërë delegacionit të Bashkësisë Islame të Kosovës, duke e falënderuar Myftiun dhe stafin e tij për vizitën, si dhe për takimin e realizuar, ndërsa Myftiu i Kosovës, mr. Naim ef. Tërnavë, shprehu mirënjohjet e tij për pritjen e bërë, si dhe uroi homologun e tij h. Shaqir ef. Fetahu dhe gjithë myftinjët për kryerjen e Umras dhe u dëshiroi që lutjet dhe ibadetet e bëra në vendin e shenjtë t’u pranohen tek Allahu fuqiptotë.

Dy delegacionet në përbërje të zgjeruar biseduan gjerë e gjatë për një bashkëpunim të mirëfilltë për një të ardhme më të mirë. Pas bisedave konstruktive nga të gjithë pjesëmarrësit u vendos me sa vijon:

- Forcimi i bashkëpunimit të dy bashkësive simotra në sfera të ndryshme të jetës fetare islame;

- Vazhdimi i realizimit të projekteve në sferën e botimit të veprave të ndryshme, si dhe revista e përbashkët nga tri Bashkësitë Fetare: e Maqedonisë së Veriut, e Shqipërisë dhe e Kosovës;

- Organizimi i paneleve, simpoziumeve, konferencave të ndryshme, si dhe i garave të Kuranit famëlartë dhe organizime të ndryshme;

- Projekte të bashkëpunimit mes shkollave të mesme islame - Medreseve dhe Fakulteteve të Shkencave (Studimeve) Islame;

- Vizita të ndërsjella të imamëve në territoret e Bashkësive Islame me ligjërues të njohur;

- Përgatitja e emisioneve dhe e projekteve për mjetet e informimit;

- Këmbimi i përvojave të ndërsjella rreth organizimit të Haxhit dhe nisja e projekteve për organizimin e prerjes së kurbaneve;

- Kultivimi edhe më i shëndoshë i doktrinës burimore islame, me qëllim të evitimit të synimeve eventuale të radikalizmave të llojeve të ndryshme;

- Përpjekje maksimale të shpjegimit islam konform rrjedhave të kohës, me qëllim të një prezantimi të shëndoshë dhe të pastër të Islamit në trevat tona;

- Vizita të ndërsjella të objekteve fetare të Bashkësive, të njohura dhe atraktive, në të dy vendet;

- Si dhe shumë ide të tjera që i nxjerrin koha, situata dhe rrjedhat e zhvillimeve fetare dhe kombëtare;

- Të formohen ekipe profesionale për realizimin gradual të synimeve të parapara nga të dy Bashkësitë Islame.

- Në të ardhmen të organizohen takime trepalëshe të Bashkësive Islame të Shqipërisë, të Kosovës dhe të Maqedonisë së Veriut.

Në fund, Reis’ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu bashkë me Myftiun e Kosovës, mr. Naim ef. Tërnavë, përshëndetën takimin dhe vizitën, duke konstatuar se bashkëpunimi është vlera më e lartë e besimtarëve të trojeve tona dhe në këtë më-

nyrë, u tha, do të jemi në krye të detyrës për të bartur amanetin e shpjegimit të Islamit, për të qenë në shërbim të Zotit, të Kombit, të Vatani dhe të qenies njerëzore në përgjithësi.

Delegacioni i Bashkësisë Islame të Kosovës ishte në përbërje të Myfti mr. Naim ef. Tërnavë; z. Ahmed Sadriu, Sekretar i Përgjithshëm; z. Vedat Sahiti, Kryeimam; z. Sabri Bajgora, Drejtor i Institutit për Hulumtime Islame; z. Ramadan Shkodra, Drejtor për Kulturë dhe Botime; z. Ekrem Simnica, Drejtor për Diasporë; z. Rexhep Luma, Ndihamsekretar dhe z. Besim Mehmeti, Shef i Kabinetit. Delegacioni i Bashkësisë Fetare Islame të RMV përbëhej nga Reis’ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, Myftiu i Shkupit dr. Qenan ef. Ismaili, Myftiu i Tetovës prof. dr. Qani ef. Nesimi dhe Myftiu i Kumanovës h. Abedin ef. Imeri, Drejtori i Sektorit për Arsim dhe Shkencë prof. Jusuf ef. Zimeri, Drejtori i Agjencisë për Hallall Standard h. Muhamer ef. Veseli, Kryetari i Shoqatës së Ulemave Rexhep ef. Ziberi, Shefi i Kabinetit dr. Abdylqerim ef. Iseni, Drejtori i Sektorit për Diasporë dr. Selver ef. Xhemaili, Drejtori i Sektorit për Marrëdhënie me Botën Arabe h. Ismet ef. Ademi, Drejtori i Sektorit për Kulturë Musanif ef. Rufati, Udhëheqësi i Sektorit për Marrëdhënie me Turqinë prof. Nizam Reshit dhe Udhëheqësi i Sektorit për Informim publik z. Agron Vojnika, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Më parë, gjatë ditës, deklarata e përbashkët e Kryetarit të BFI të RMV, Reis’ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, dhe e Kryetarit të BIK, Myfti h. Naim ef. Tërnavë, ishte transmetuar drejtpërdrejt në platformat elektronike të BFI-së.

# DIPLOMOJNË 8 HAFËZA NË KOSOVË

Tetë hafëza të Kuranit janë certifikuar me diploma nga Bashkësia Islame e Kosovës pasi kanë kaluar me sukses provimin para Komisionit vlerësues. Komisioni profesional, i përbërë nga Kryeimami i Bashkësia Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, dhe anëtarët: hafëz Safet ef. Hoxha dhe hafëz Etem ef. Alanka, dëshmuar se hafëzët e rinj ishin të shkëlqyer në testim, thuhet në njoftimin e Bashkësia Islame të Kosovës (BIK).

Në këtë ceremoni të ndarjes së diplomave mori pjesë edhe kryetari i Bashkësia Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavi, i cili përgëzoi hafëzat e rinj, duke thënë se Bashkësia Islame është paturuar me këta hafëza.

Në fund, edhe zyrtarisht u bë ndarja e certifikatave për hafëzat e rinj, të cilët di-

plomuan.

Në kuadër të Bashkësia Islame të Kosovës për memorizimin e Kuranit funksionojnë: Instituti i Hifz-it në Gjakovë dhe në Prizren, ndërsa së shpejti priten të hapen edhe qendra të tjera për memorizimin e Kuranit në Pejë dhe në Rahovec, për të vazhduar me qendra të tjera në Gjiilan, Mitrovicë e Vushtrri, thuhet në njoftimin e BIK. (29.12.2021)

## DREJTORI I "MAARIFIT" QËNDRON NË BFI



Më 20 janar, 2022, në Bashkësinë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut ka qëndruar drejtori i fondacionit turk "Maarif International Schools" në RMV, z. Mehmet Baran, i shoqëruar nga z. Numan Idriz. Në këtë takim të rëndësishëm ata janë pritur nga Kryetari i BFI, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, me bashkëpunëtorë, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Me këtë rast, Kryetari i BFI falënderoi mysafirët për vizitën dhe i njoftoi thelbësisht me rrjedhat fetare islame, si dhe me synimet e BFI të RMV. Po ashtu, pati njoftime për së

afërmi me veprimtarinë e Fondacionit, për synimet dhe qëllimet e tij, sidomos në sferën e edukimit dhe të arsimimit. Të dyja palët ranë dakord për të hapur rrugët e bashkëpunimit në të ardhmen në sfera të ndryshme.

Gjatë takimit Reis'ul-Ulemaja shoqërohej nga dr. Qenan Ismaili, Myftiu i Shkupit; dr. Abdylqerim Iseni, Shef i Kabinetit; dr. Selver Xhemaili, Drejtor për Diasporë; dhe prof. Nizam Reshit, Përgjegjës për Marrëdhënie me Republikën e Turqisë, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Myftiu i BFI-Shkup, dr. Qenan ef. Ismaili, ka njoftuar se të njëjtën ditë ka pasur një takim të veçantë me mysafirët nga Turqia. Sot pata nderin dhe kënaqësinë që të jem nikoqir i z. Mehmet Baran, drejtor i fondacioni turk "Maarif" në Maqedoni, i shoqëruar nga asistenti z. Numan Idriz, ka shkruar ai.

Në këtë takim, nga z. Mehmet Baran u informova hollësisht për angazhimin e fondacionit "Maarif" në vendin tonë, për strukturën, funksionimin, sfidat dhe rezultatet e arritura gjatë veprimtarisë së tyre edukativo-arsimore.

Bashkërisht u dakorduam për një bashkëpunim më konkret në të ardhmen, në këmbimin e përvojave në drejtim të projekteve të përbashkëta, ku të dy institucionet mund të kontribuojnë në ofrimin e arsimimit cilësor.

Në fund të takimit, z. Mehmet Baran i dhurova pllaketë që mban logon e Myftinisë së Shkupit dhe librin tim "Xhamia, simbol i Shkupit", ka njoftuar Myftiu i Myftinisë së Shkupit, dr. Qenan ef. Ismaili, më 20 janar, 2022.



# MEDRESEJA ISA BEU SHËNOI DITËN E GJUHËS ARABE

SHMI "Medreseja Isa Beu" në Shkup shënoi Ditën Ndërkombëtare të Gjuhës Arabe. Shënimi i kësaj date u realizua nëpërmjet kuizit të organizuar nga Shoqata e nxënësve, në bashkëpunim me Drejtorin e Medresesë. Në fillim u këndua ashere nga hafëzi Vait Isufi, ndërsa moderator i programit ishte Kryetari i Shoqatës, Ismail Ismaili, thuhet në njoftimin e Medresesë Isa Beu.

Pas paraqitjes së programit, me fjalë përshëndetëse u paraqit Drejtori i Medresesë, prof. Ibrahim Idrizi, i cili foli rreth rëndësisë së gjuhës arabe, duke potencuar se gjuha arabe është një nga gjashtë gjuhët zyrtare të Kombeve të Bashkuara. 18 Dhjetori, si Dita Ndërkombëtare e Arabishtes, festohet që nga viti 2012 dhe përkon me datën e vitit 1973, kur Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara e pranoi arabishten si gjuhë të gjashtë zyrtare të Organizatës. Sot arabishtja flitet nga më shumë se 422 milionë njerëz dhe është gjuha zyrtare në 24 vende të botës.

Në kuiz morën pjesë nxënës nga të gjitha vitet - gjithsej gjashtëmbëdhjetë nxënës, të ndarë në katër grupe. Grupi A: Ahmet Koxhaxhiku, Naim Fazliu, Bekim Havziu dhe Ramazan Aliti.



Grupi B: Muash Dauti, Adem Kalliqi, Ubejd Ajdari dhe Gentrin Saliu. Grupi C: Admir Jusufi, Hasip Emrullai, Xhelil Havziu dhe Valon Rushiti. Grupi D: Amar Murati, Shuajb Nexhipi, Sefer Abdul dhe Ensar Kurtishi.

Materiali nga i cili u përgatitën pyetjet e Kuizit ishte kryesisht nga planprogrami i medresesë "Isa Beu", kishte dhe pyetje të tjera, nga aktivitetet e lira, përfshi këtu edhe pyetjet logjike. Pyetjet ishin të ndara në tri grupe.

Juria e cila bëri vlerësimin e për-

gjigjeve dhe në fund shpalli rezultatet ishte e përbërë prej dr. Mevlud Aliu, dr. Islam Islami dhe mr. Lutfi Nexhipi.

Kuizi zgjati rreth një orë. Në fund juria shpalli rezultatet, ku si ekip fitues doli Grupi A.

Në fund, për të gjithë pjesëmarrësit u ndan mirënjohje dhe për fituesit dhurata. Shpërndarjen e tyre e bëri Drejtori i Medresesë, prof. Ibrahim Idrizi. Programi u mbyll me ashere nga hafëz Hasip Emrullai dhe në fund duanë e bëri hafëz prof. Sheval Azizi. (21.12.2021)

## MARVINA KALON NË ISLAM

Në Myftininë e BFI-Shkup, Marvina Alili deklaroi shehadetin dhe u pranua në Islam. Myftiu dr. Qenan ef. Ismaili mirëpriti znj. Malvina Alili dhe bashkëshortin e saj, z. Ramazan Alili, më 13 janar, 2022, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Shkupit.

Pas një bashkëbisede me znj. Malvina Alili, rreth njohurive për Islamin dhe arsyes për këtë vendim të saj për pranimin e Islamit, publikisht, me vetëdije e bindje të plotë, me vetdëshirë dhe vullnet të lirë, deklaroi shehadetin, me çka edhe e pranoi fenë islame si fe të saj.

Ndryshe, znj. Alili jeton dhe vepron në Berlin të Gjermanisë.

"Lusim Allahun e madhërishtëm që t'u falë lumturi, mirëkuptim e harmoni familjare; t'i begatojë me mirësitë e panumërta të kësaj bote dhe të Ahiretit"- thuhet në njoftimin e Myftinisë së BFI-Shkup.



# SËRISH HAP DYERT XHAMIA “HAMZA” NË DOBËRDOLL

Më 24 dhjetor, 2021, pas meremetimit, xhamia “Hamza” në Dobërdoll (Gostivar) sërish ka hapur dyert për namaz. Në ceremoninë e organizuar me këtë rast mori pjesë edhe Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Reis’ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, me bashkëpunëtorë, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Ceremonia madhështore u organizua nga Myftinia e BFI-Gostivar, nën udhëheqjen e Myftiut h. Sabahudin ef. Zendeli dhe Këshilli iniciativ i Xhamisë. Ajo filloi me lexim të Kuranit fisnik nga Ensar ef. Sinani, Imam në Hamburg të Gjermanisë dhe vazhdoi nën moderimin e Jusuf ef. Xheladini.

Reis’ul-Ulemaja u shoqërua nga Myftiu i Shkupit dr. Qenan ef. Ismaili, Myftiu i Kërçovës mr. Qamil ef. Rushiti, Myftiu i Manastirit h. Amit ef. Rasimi, Myftiu i Shtipit mr. Nasir ef. Rexhepi, Myftiu i Ohrit Samet ef. Ajdari, Sekretari i Përgjithshëm i BFI-së h. Irsal ef. Jakupi, Kryetari i Kuvendit të BFI-së h. Fejsal ef. Kadriu, Kryetari i Shoqatës së Ulemave Rexhep ef. Ziberi, Drejtori i Sektorit për Arsim dhe Shkencë prof. Jusuf ef. Zimeri, Drejtori i Agjencisë për Hallall Standard Muhamer ef. Veseli, Drejtori i Sektorit për Diasporë dr. Selver ef. Xhemaili, Drejtori i Sektorit për Bashkëpunim me Jashtë dhe OSBE-në Mustafa ef. Dauti, Drejtori i Sektorit për Kulturë Musanif ef. Rufati, Prodekani i FSHI dr. Muaz



ef. Agushi, Shefi i Kabinetit të Reis’ul-Ulemasë dr. Abdylqerim Iseni, profesorë të Fakultetit të Shkencave Islame-Shkup dhe të medresesë “Isa Beu”, hoxhallarë dhe mysafirë nga vendi dhe nga jashtë.

Prezent në këtë ceremoni ishte edhe Kryetari i Komunës së Vrapçishtit, z. Isen Shabani.

Fillimisht, z. Femi Asllani - arkëtar i Këshillit iniciativ - dha një raport të hollësishëm për kontribuesit e kësaj xhamie dhe mënyrën me të cilën kanë ecur punimet e renovimit të xhamisë. Më pas të pranishmit i përshëndeti edhe Imami i Xhamisë, h. Afet ef. Beadini.

Myftiu i Gostivarit, h. Sabahudin ef. Zendeli, i falënderoi të pranishmit për interesin e treguar që bashkërisht të lë-

shohet në përdorim xhamia e renovuar “Hamza”, një ndër objektet fetare më të bukura në Myftininë e Gostivarit. Ai gjithashtu falënderoi Këshillin inicues dhe donatorët, të cilët me kontributin dhe sakrificën e tyre bënë të mundur që t’i rikthehet shkëlqimi kësaj bukurosheje të Gostivarit.

Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis’ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, kishte nderin që të mbajë fjalën kryesore të kësaj ceremonie. Ai foli rreth rëndësisë që ka mirëmbajtja e objekteve fetare në çuarjen përpara të amanetit të gjyshërve tanë në kultivimin e vlerave të mirëfillta fetare dhe kombëtare. Tradita dhe Islami burimor janë vlera të cilat mund të përçohen dhe të ecin me kohën vetëm nëse në mesin e besimtarëve ka iman të paluhatsëm dhe përkushtim të palodhshëm. Këtë gjë e dëshmuam më së miri xhemati i xhamisë “Hamza”, tha mes tjerash Reis’ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu.

Për kontribuesit më të spikatur, në emër të BFI të RMV u ndanë mirënjohje dhe falënderime, pjesë nga Kurani fisnik lexoi Arben Emmini, ndërsa duanë e Xhamisë e bëri Myftiu i Kërçovës, mr. Qamil ef. Rushiti. Hytben e Xhumasë e mbajti Myftiu i Shkupit, dr. Qenan ef. Ismaili. Reis’ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu udhëhoqi me namazin e Xhumasë, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Në kohë reale, BFI e RMV në platformat e saj audio-vizive bëri transmetim direkt nga hapja e sërishme e xhamisë “Hamza” në Dobërdoll, pas meremetimit të saj.

# XHAMIA E VRANJOVCËS, SI E RE



Më 31 dhjetor, 2021, në prezencë të shumë besimtarëve, u bë hapja solemne e Xhamisë së fshatit Vranjovcë, Komuna e Vrapçishtit, pas renovimit të saj të tërësishtëm. Ajo tashmë duket si e re, thuhet në njoftimin e Myftinisë së BFI-Gostivar.

I pranishëm në këtë ngjarje ishte një delegacion nga Myftinia e Gostivarit, e përfaqësuar nga hfz. Jusuf ef. Xheladini - Referent Fetar-Arsimor dhe mr. Eljesa ef. Asani - Referent për Kulturë dhe njëkohësisht Drejtor i Institutit të Hifz-it dhe të Bukurleximit të Kuranit Famëlartë në Gostivar. Kishin ardhur po ashtu edhe përfaqësues të jetës publike dhe shoqërore në vend, afaristë, intelektualë e shumë të tjerë. Programi u hap me një ashere nga

mr. Eljesa ef. Asani, ndërsa udhëheqjen e programit e bëri hfz. Jusuf ef. Xheladini. Në vazhdim h. Jusuf Islami, Kryetar i Këshillit të Xhamisë, në emër të besimtarëve bamirës referoi rreth ecurisë së punëve dhe harxhimeve që janë bërë deri në përfundimin e renovimit të Xhamisë.

Fjalë mirëseardhjeje shprehu Imami i kësaj xhamie, Bujar ef. Mezini, i cili falënderoi për prezencën e të gjithë mysafirëve, duke shprehur falënderim për kontribuesit dhe xhematin e fshatit Vranjovcë e më gjerë për këtë vepër madhore.

Fjalë përshëndetëse si nikoqir pati përfaqësuesi i Myftiut të Gostivarit, h. Sabahudin ef. Zendeli, hfz. Jusuf ef. Xheladini, i cili në fillim përshëndeti në emër të Myf-

tiut dhe të Reis’ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, të cilët ndodhen në Umra në vendet e bekuara. Referenti Fetar-Arsimor vlerësoi lart këtë vepër madhore, e cila sot po bëhet realitet, pas një pune dhe angazhimi maksimal.

Përfaqësuesit të Myftinisë, Imamit të Xhamisë, Bujar ef. Mezini dhe Këshillit të Xhamisë iu ndanë mirënjohje për angazhimin e tyre permanent, deri në finalizimin e këtij projekti.

Mr. Eljesa ef. Asani këndoi ashere, ndërsa duanë e bëri hfz. Jusuf ef. Xheladini, i cili mbajti edhe hytben e Xhumasë. Në namazin e Xhumasë priu Imam mr. Eljesa ef. Asani, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Gostivarit.

## SOS VITA NË BFI



Më 21 dhjetor, 2021, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Reis’ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, priti në takim zyrtar z. Ertan Shaqiri, Kryetar i Shoqatës së personave me nevoja të veçanta SOS Vita, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Bashkësia Fetare Islame e RMV gjithmonë ka qenë dhe vazhdon të jetë në ndihmë dhe në shërbim të atyre që kanë nevojë për t’iu qenë afër, siç kemi nevojë të gjithë për ndihmë nga të tjerët. Z. Ertan Shaqiri është duke bërë një veprimtari të jashtëzakonshme për të sensibilizuar të gjithë që të jenë humanë e solidarë ndaj

të tjerëve. Angazhimi i tij është për sigurim të pozicionit të rehatshëm të tyre në shoqëri. Kjo e bën të lumtur dhe krenar, ndërsa të tjerëve u jep inspirimin dhe optimizmin. Kryetari i BFI pati një bisedë konstruktive me Kryetarin e SOS Vita dhe u ra dakord që Bashkësia Fetare Islame të jetë gjithmonë afër personave me nevoja të veçanta, thuhet në njoftimin e BFI-së.

“Biseduam të jemi sa më afër tyre. Zoti e bekoftë me të mirat e Tij”, ka shkruar Kryetari i BFI-së në Facebook pas takimit me z. Ertan Shaqiri, Kryetar i Shoqatës së personave me nevoja të veçanta SOS Vita, Shkup.

# XHUMAJA E FUNDIT SI IMAM I FSHATIT KORITË

Gostivar, 1 janar (TV Globi) - Të paktë janë qytetarët e Gostivarit dhe rrethinës që nuk e kanë takuar, nuk e njohin apo nuk e mbajnë mend një këshillë dhe një udhëzim nga hafëz Seferi, hoxha i nderuar i cili 58 vjet të plota ka udhëhequr në mësimbesim, në namaz dhe në ceremonitë tjera fetare që janë zhvilluar në Koritë dhe në fshatrat përreth.

Baba Hoxhë i Koritës, siç e njohin qytetarët e Gostivarit dhe më gjerë, përherë i gatshëm për udhëzim, këshillë, por edhe për të bërë vërejtje në rast nevojë, në moshën 84-vjeçare ka falur dje xhumanë e fundit si Imam.

Hoxha Sefer Emini nis shërbimin si hoxhë rreth viteve të 60-ta, që asokohe nuk ishin shumë, duke shërbyer gjithandej Koritës dhe vendbanimeve përreth, posaçërisht në raste të festave, por edhe shërbimeve të tjera fetare që kërkoheshin.

“Ne në çdo hap kemi qenë të përcjellë, të kontrolluar dhe të vëzhguar në ligjëratat tona, nëse do ndërlihdeshin me çështje politike të kohës apo edhe më çështjen kombëtare, ku gjendja e popullit shqiptar ishte larg drejtësisë e barazisë”, kujton sot hoxha, i cili ende duket shumë i kthjellët në rezonim, në përkujtim, por edhe në këshilla.

Duke qenë pjesë e shumë zhvillimeve, por edhe nga vetë nevoja për shërbime, kam shkelur pa dyshim secilin lokalitet të komunës së Gostivarit e të Tetovës, shprehur hafëz Seferi, duke përmendur se përherë ka insistuar në ligjëratat që të dëgjohen dhe të kuptohen mirë, pasi ka shumë rëndësi interpretimi dhe mënyrat



Foto: TV Globi, Gostivar

si janë transmetuar, ndërkohë që ka kërkuar që zakonisht të flitet me emër dhe jo me përgjithësim në secilën ligjëratë apo këshillim.

Vetëm gjatë kohës që ka shërbyer në Xhaminë e Koritës, hafëz Seferi ka mbajtur kurse të mësimbesimit, ku mësimet e para, besimin, kushtet e namazit dhe duatë e ndryshme i kanë mësuar shumë fëmijë të fshatit.

Hoxhë Sefer Emini shpreh kënaqësinë që sot, në krahasim me kohën kur ai nisi rrugën për mësues feje, gjeneratat e reja

kanë mundësi që të mësojnë, të edukohen, të arsimohen dhe të përgatiten për punë dhe për jetë, ndonëse përpara besimtarët ishin të lidhur fort mes vete, ndërsa tash jo vetëm në besim, por as në familje nuk është situata që ka qenë më herët në familjet shqiptare.

Vlen të theksohet se rrugën e hoxhës Sefer Emini sot e ndjekin edhe shumë nipër e familjarë të tij.

Burimi (në bashkëpunim):

<http://globi.mk/xhumaja-e-fundit-si-imam-i-fshatit-korite>

## MIRËSEARDHJE BASHKATDHETARËVE

Me mall të madh bashkatdhetarët tanë kanë filluar të vijnë në vatrën e tyre. Nga të gjitha anët, të gëzuar, kthehen për të pushuar shpirtin dhe për ta bërë të lumtur atë, ka shkruar Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis’ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, në faqen e vet në Facebook.

Ne me shpirt i mirëpresim, sepse ata këtë e meritojnë. Kudo që shkojnë, përsëri kontributi i tyre është i madh dhe i vazhdueshëm në shërbim të kombit, të Islamit dhe të atdheut.

Zoti ju bekoftë dhe mirë se na vini, bashkatdhetarë të respektuar, ka shkruar Reis’ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu. (23.12.2021)



## TAKIM PUNE ME MYFTIUN E MANASTIRIT

Më 18 janar, 2022, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis’ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, pati një takim pune me Myftiun e Manastirit, h. Amit ef. Rasimi, në Rijaset, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Në takim u bisedua në lidhje me konsultimin për punët e Myftinisë, në veçanti për realizimin e projekteve që janë në vazhdim e sipër, si dhe për projektin e ri të renovimit të "Koxha-Xhamisë" të periudhës osmane, si dhe për idetë tjera që kanë të bëjnë me të ardhmen e myslimanëve në përgjithësi.

Myftinia e Manastirit është mjaft mirë e organizuar dhe ka strategji për një rrugëtim bashkëkohor të prezantimit të Islamit. Reis’ul-Ulemaja dhe Rijaseti i BFI-së sa herë që e do nevoja i



japin përkrahje maksimale në këtë drejtim.

Myftiu i Manastirit shoqërohej nga

bashkëpunëtorët z. Orhan ef. Demiri, z. Ilmi ef. Osmani dhe z. Vebi ef. Klenja, thuhet në njoftimin e BFI-së.

## KUJTIM MIRZO TAKON KRYETARIN E BFI-së



Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis’ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, më 18 janar, 2022, priti në

Rijaset dr. Kujtim ef. Mirzon, arabolog i spikatur dhe i devotshëm nga Dibra e Madhe, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Në këtë takim me mysafirin u bisedua për tema të ndryshme, sidomos për rrjedhat e Islamit në kohë dhe në vend. Nga ana e tij, Reis’ul-Ulemaja falënderoi mysafirin për vizitën, si dhe për idetë e tij të shëndosha në prezantimin e Islamit në trevat tona. E ardhmja iu takon kadrovë profesionalist të përgatitura dhe moralisht të fortë.

Dr. Kujtimi aktualisht me suksesin më të madh kryen detyrën e ligjëruesit dhe të imamit në një ndër xhamitë më të njohura të Dibrës, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Ishte kënaqësi. Zoti e bekoftë – ka shkruar në faqen e vet në Facebook Kryetari i BFI të RMV, Reis’ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu.

## VAZHDON UNIFIKIMI I TABELAVE

Ka vazhduar unifikimi i tabelave të xhamive në Shkup. Myftinia e Shkupit në planin e aktiviteteve vjetore planifikon unifikimin e tabelave nëpër të gjitha xhamitë e Shkupit me identitetin institucional të Myftinisë, thuhet në njoftimin e Myftiut të Shkupit, dr. Qenan ef. Ismaili.

Tabelat e reja përmbajnë logon e BFI-së dhe të Myftinisë së Shkupit, emërtimin

e xhamisë, datën e ndërtimit, datën e rindërtimit dhe datën e restaurimit të xhamisë.

Pasi të vihen tabelat nëpër të gjitha xhamitë e zonës së qytetit, ekipi realizues do të vazhdojë punën nëpër rajonet tjera të Shkupit: Karadak, Karshiakë dhe Derven, thuhet në njoftimin e Myftiut të Myftinisë së BFI-Shkup. (23.12.2021)



# HATME NË KOPANICË

Në xhaminë "Lejletul Kadër" të fshatit Kopanicë, më 31 dhjetor, 2021, u mbajt solemniteti i dytë së hatmes me rastin e diplomimit të 14 nxënësve në bazat e mësimbesimit islam, pranë mualimit Ahmed ef. Çilafi, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Shkupit.

Këtë manifestim e nderuan: Referenti i Vakëfit të Myftinisë së Shkupit, Fejsall ef. Kadriu; Referenti i Arsimit Fetar, hfz. Irfan ef. Sulejmani; Referenti Armend Halimi, hoxhallarë, hafëzllarë e familjarë të nxënësve, si dhe xhemati i fshatit Kopanicë.

Ceremoninë e hapi Ahmed ef. Çilafi, mualim i nxënësve, i cili në emër të familjarëve të nxënësve falënderoi të pranishmit që kishin ndarë kohë për të ndjekur këtë ceremoni me rastin e diplomimit të gjeneratës së pestë, që nga ushtrimi i detyrës së tij si mualim pranë xhamisë "Lejletul Kadër".

Fjala e rastit i takoi Fejsall ef. Kadriu, i cili përshëndeti të gjithë të pranishmit në emër të Myftiut të Shkupit, dr. Qenan ef. Ismaili. Në fjalën e tij ai shprehu mirënjohje për kontributin dhe përkushtimin e Ahmed efendiut në detyrën e tij të shenjtë, uroi nxënësit për su-



sesin e arritur si dhe prindërit për orientimin e fëmijëve të tyre për të mësuar rregullat bazë të fesë islame.

Më pas vijoi programi i përgatitur nga nxënësit që kishin përfunduar hatmen e Kuranit.

Pas programit, Fejsall efendiut e bëri duanë e hatmes.

Për të gjithë, në emër të Myftinisë së Shkupit, Fejsall efendiut nxënësve u dhu-

roi diploma dhe më pas mbajti hytben e xhumasë. Hfz. Irfan ef. Sulejmani, ndërkaq, udhëhoqi xhematin në faljen e namazit të xhumasë.

Allahu ju dhashtë sukses dhe mbarësi të gjithë nxënësve, ndërsa Ahmed efendiut, për kontributin e tij të pakursyer, e shpërbleftë me mirësitë e panumërta të dynjasë dhe të ahiretit, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Shkupit.

# "IKRE" NXORI GJENERATËN E TETË



Më 4 janar, 2022, u realizua ceremonia e dytë së hatmes me rastin e diplomimit të 46 nxënësve pranë mektebit (mejtëpit) të xhamisë 'Ikre' në Saraj, thuhet në njoftimin e Myftinisë së BFI-Shkup.

Programin e hapi Xheuhere Huseini Ramani, mualime e nxënësve, e cila në emër të familjarëve të nxënësve falënderoi të pranishmit që kishin ndarë kohë për të ndjekur këtë manifestim, duke lutur Alla-

hun e madhërishtëm që nxënësit hatmexhinj t'i shpërblejë për sakrificën dhe angazhimin e tyre në mësimin e Fjalës së Allahut dhe rregullave bazë të Islamit.

Në ceremoninë e mbajtur u paraqitën pjesë të mësimave që kishin ndjekur, recituan pjesë nga Kurani famëlartë dhe ilahi. Mubera J. Asani, anëtare e Komisionit, mbajti fjalën e rastit, me ç'rast shprehu mirënjohje dhe vlerësimet e saj

të larta për punën e pakursyer të mualimes dhe njëkohësisht uroi nxënësit për suksesin e arritur.

Pas programit u bë ndarja e diplomave, ndërsa mualimes iu dhurua mirënjohje dhe një libër në emër të Myftinisë, në shenjë falënderimi për kontributin e dhënë në mbarëvajtjen e mësimbesimit islam në mektebin e Xhamisë, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Shkupit.

# DEKORATË PËR SHEMSUDIN EF. ISMAILIN

Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, priti në Rijaset, më 21 dhjetor, 2021, teologun dhe alimin e mirënjohur mr. Shemsudin ef. Ismaili nga fshati Sellarcë i Tetovës, i cili aktualisht është aktivist dhe Imam në Zvicër, tashmë afër 20 vjet. Më herët ka qenë plot 11 vjet në Xhaminë e Tabhanes në Tetovë, ku u shqua si një vaiz i suksesshëm dhe dy vite ligjëroi në Fakultetin e Shkencave Islame të Shkupit, duke qenë në të njëjtën kohë edhe Imam në fshatin Sellarcë, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu dhe mr. Shemsudin ef. Ismaili njihen që në ditët e rinisë, kur së bashku kanë mësuar për 5 vite në Medresenë Alauddin në Prishtinë dhe 4 vite në Fakultetin Teologjik Islam në Sarajevë.

Për punën e madhe dhe të palodhshme në shërbim të fesë, të atdheut dhe të BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu i shprehu mirënjohje dhe i ndau një dekoratë, duke i dëshiruar jetë të gjatë dhe suksese të reja.



Atë e shoqëronte Imami i mirënjohur nga Sellarca e Tetovës, h. Xhelal ef. Xhemali, një personalitet i cili tërë jetën ia kushtoi Islamit. Reis'ul-Ule-

manë, ndërkaq, e shoqëronte z. Qufli Osmani, Udhëheqës i Sektorit Administrativ të BFI, thuhet në njoftimin e BFI-së.

# FUTBOLLISTI ZENI HUSMANI NË BFI



Më 21 dhjetor, 2021, Kryetarin e Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, e vizitoi z. Bajram Husmani nga Çegrani me të birin, futbollistin e mirënjohur shqiptar z. Zeni Husmani, aktualisht futbollist i NK Domžale, Slloveni, një lojtar i cili me dinjitetin më të madh profesional sportiv dhe moral ka prezantuar gjithë shqiptarët

dhe Islamit në përgjithësi, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Talentin e tij së pari e ka treguar në KF Shibenik të Kroacisë. Një kohë ka qenë lojtar i Shkëndijës në Tetovë dhe në Turqi.

Familja Husmani është e njohur për dashurinë ndaj sportit, në veçanti nga gjyshi i Zeniut, z. Kasami, si dhe vetë babai, z. Bajram Husmani, i cili po ashtu një

kohë ka luajtur mirë futboll në Shibenik.

Gjatë kësaj vizite vëllazërore, futbollisti i mirënjohur z. Zeni Husmani i dhuroi Reis'ul-Ulemasë dresin e tij të NK Domžale, ndërsa Kryetari i BFI-së, në shenjë respekti dhe mirënjohjeje, i ndau dekoratën e BFI të RMV dhe e falënderoi për vizitën e tij, duke i dëshiruar shëndet dhe jetë të gjatë, thuhet në njoftimin e BFI-së.

# VAKËFI HÜDAYI VIZITON KUMANOVËN



Më 21 dhjetor, 2021, patëm nderin që Myftininë e Kumanovës dhe Kursin e saj të Kuranit ta vizitojnë mysafirë shumë të respektuar nga Republika e Turqisë: Drejtori i Hüdayi Vakfit dr. Alican Tatlı, dy zëvendës drejtorët e tij: z. Mübarek Erkul dhe Shuayib Başhan, pastaj z. Rafet Bilaç, përgjegjës i Kurseve të Ku-

ranit në Ballkan dhe dr. Ahmet Lokche, koordinator i Kursit të Kuranit në Shkup, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Kumanovës.

Myftiu h. Abedin Imeri i informoi mysafirët për ecurinë e punëve në Myftininë e Kumanovës dhe në Kursin e Kuranit, që është në kuadër të Myftinisë. Ai

po ashtu i falënderoi mysafirët, respektivisht drejtorin dr. Alican Tatlı dhe Hüdayi Vakfin, për kontributin e dhënë në mirëmbajtjen e Kursit të Kuranit, duke lutur Allahun e plotfuqishëm që t'i shpërblejë me shpërblimet më të çmueshme që ka Madhëria e Tij, thuhet në njoftimin e Myftinisë së BFI-Kumanovë.

# MYFTINISË SË KËRÇOVËS I SHTOHET NJË MAGJISTËR

Myftiu i Myftinisë së BFI-Kërçovë, Qamil ef. Rushiti, më 23 dhjetor, 2021, ka bërë një njoftim në të cilin thuhet: Myftinisë së Kërçovës i shtohet një magjistër në shkencat e filologjisë orientale.

Në Universitetin e Tetovës, në kuadër të Fakultetit Filozofik, mbrojti me sukses të lartë temën e magistraturës Sekretari i Myftinisë së Kërçovës, Xhemail ef. Ahmedi.

Përpara komisionit ai prezantoi temën: "Veçoritë gjuhësore të veprës Kurani, me përkthim të Salih Ferhat Hoxhës", një tematikë e cila do t'i shërbejë xhematit tonë për t'u njohur me përkthimet e Kuranit në gjuhën amtare shqipe.

Xhemailit i dëshirojmë shumë suksese në jetën e tij akademike, thuhet në njoftimin e Qamil ef. Rushitit, Myftiu i Myftinisë së Kërçovës.



# SINDROMA MESIANIKE...

Është një sëmundje që mund t'i prek ulematë dhe ndonjëherë kjo bëhet e pashërueshme. Kjo sëmundje është e ashtuquajtura Sindroma mesianike (Syndrome messianicae, lat.) dhe vjen atëherë kur fillojmë të besojmë se jemi

të pazëvendësueshëm, apo se i kemi të gjitha zgjidhjet. Nga kjo sindromë unë e paralajmëroj veten dhe kolegët e mi, imamët dhe myftinjët që të kemi kujdes. Ne, në Islam, nuk jemi të shenjtë dhe as mendimet dhe zgjidhjet tona nuk

janë të shenjta. Husein ef. Kavazović, Reis'ul-Ulema i Bosnjë dhe Hercegovinës (Islampress.ch/në bashkëpunim, 12.01.2022)

# MYFTI NESIMI HAPI PANAIRIN E LIBRIT "TETOVA 2021"

Më 27 dhjetor, 2021, Myftiu i Myftinisë së BFI-Tetovë, prof. dr. Qani ef. Nesimi, në Pallatin e Kulturës bëri hapjen e panairit tradicional të librit "Tetova 2021", të organizuar nga Shoqata e Botuesve Shqiptarë në RMV, në të cilin deri më 31 dhjetor ishin ekspozuar një numër i madh librash prej botuesish të ndryshëm, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Tetovës.

Fjalimin e vet Myftiu i Tetovës e filloi me leximin e 5 ajeteve të para të sures Alek, ku Allahu fuqiptotë thotë: "Lexo në emër të Zotit tënd, i cili ka krijuar (të gjitha), i cili e krijoi njeriun nga gjaku i droçkur (embrioni); lexo, se Zoti yt është më bujari, që ia mësoi njeriut penën (të shkruajë), që njeriut ia mësoi atë që nuk e diti."

Ai në vazhdim tha: Dituria është cilësi e vërtetë, edhe besimi fillon me dije dhe njohjen e Zotit. Libri është burimi kryesor që do të na udhëzojë drejt dijes së të vërtetës. Emri i përgjithshëm i këtij zbulimi është leximi; edhe urdhri i parë i Kuranit ishte 'lexo'.

Gjithashtu, Myftiu potencoi se libri është pasqyrë e realitetit shoqëror, për një epokë të caktuar. Libri është kulturë, dije, informacion, ndjenjë, emocion dhe fan-



## Panair në ReMall

Në datat 25-30 dhjetor, 2021, në qendrën tregtare "ReMall" në Tetovë është mbajtur po ashtu një panair libri, me të njëjtin titull: "Tetova 2021". Dy shtëpitë botuese tetovare "Syth" dhe "Nobel" këtë vit vendosën të sjellin një panair libri pak më ndryshe se herave të tjera në Tetovë. Panairi i librit këtë vit vjen në një lokacion të ri dhe më të frekuentuar nga qytetarët, përkatësisht në qendrën tregtare "ReMall". Ajo që ra në sy gjatë hapjes së panairit, ishte mungesa e profesorëve, e arsimtarëve, e nxënësve dhe e studentëve, ka shkruar Portalb.mk. Panairi është hapur nga shkrimtari Salajdin Saliu. Në hapjen e tij ka folur edhe profesora universitare Vjollcë Berisha.

tazi. Libri ka lule dhe plagë, të cilat e tregojnë fytyrën e shoqërisë njerëzore. Libri është i bukur kur me gjuhë të pastër e thotë të vërtetën. Libri ka vetëm një gjykatës të ndershëm dhe ai është lexuesi.

Pasi e shpalli të hapur Panairin e Librit, ai uroi që ky panair të jetë i mbarë, të ketë sa më tepër njerëz që e njohin artin e të shkruarit dhe që e duan librin, thuhet në njoftimin e Myftinisë së BFI-Tetovë.

## TREGIM

# BËNI DURIM

*Ka qenë një burrë. Allahu i kishte dhënë një djalë. Kur i bëri djali dy vjet, vdiq. U mërzi për të.*

*Pastaj, bashkëshortja e tij ngeli me barrë dhe i lindi atij djalin e dytë. Edhe ky nuk e bëri as edhe një vit dhe vdiq edhe djali i dytë.*

*Sa u bënë tani? Dy vdiqën dhe i varrosi me duart e veta.*

*Pastaj Allahu i dha katër vajza, njëra pas tjetrës. Vajzat u rritën. E para u martua. Kur u martua, u gëzua dhe ishte i lumtur me të. Vdiq edhe ajo, gjithashtu. Moshë e saj ishte në të njëzetat.*

*E varrosi atë. Pastaj u martua e dyta. Dhe, kur i lindi një fëmijë, u gëzua me të. Vdiq edhe ajo dhe e varrosi atë.*

*Sa u bënë tani? Dy vajza dhe dy djem.*

*Pastaj vajza e tretë. Moshë e saj nuk i arriti të shtatëmbëdhjetat. U sëmur dhe vdiq.*

*Tani u bënë tri vajza dhe dy djem.*

*Pas gjithë kësaj dhimbjeje dhe vuajtjeje, nuk i ngeli atij vetëm se një vajzë. Pastaj Allahu i lartësuar i dha një djalë. Lidhet me djalin dhe e do me një dashuri të madhe. Djali kur i*



bëri një vjet e gjysmë, vdes dhe e varros edhe atë.

Atëherë, sa i varrosi? Gjashtë: tre djem dhe tri vajza.

E dini kush është ky? Ky është Muhamedi (s.a.v.s.).

Andaj, të gjithë atyre që u ka vdekur ndonjë i dashur: A jeni ju më të mirë se Muhamedi (a. s.)?

Atij i vdiqën të gjithë ata. Çështja e provës nuk është se Allahu hakmerret ndaj jush. Jo! Jo! Jo!

Allahu ka urtësi për atë që e merr dhe Allahu ka urtësi për atë që e jep. Kjo të qetëson mendjen dhe kur e kujton se çfarë i ka ndodhur të dërguarit të Allahut (s.a.v.s.)!

Përktheu nga gjuha arabe: Muhamed Sadiku



## BEGZAT BEGZATI, AUTORI I “SULLTANËS”, I “XHEMË HASËS” ...

Shkrimtari Begzat Begzati është figura më e dashur për shumë xhemate të Myftinisë së Gostivarit, në qytet dhe nëpër fshatra. Ai në vitin 2008 ka botuar librin me titull “Zëri i shpirtit, mrekulli e Zotit”, i cilësuar si “një kontribut i vërtetë në sferën fetare-shkencore të nënqiellit tonë, me çka begatohet edhe më tepër fondi i literaturës fetare, duke i dhënë hapësirë lexuesit për të thelluar njohjen e vlerave fetare-islame, përkatësisht vlerat edukative, arsimore, në përgjithësi”.

Këtë vepër e përshkon fryma e lirisë së të menduarit për t’u thelluar në fenomenet fetare-islame, me qëllim të shpjegimit të tyre në frymën e kohës, që ato të jenë sa më afër bindjes së besimtarit në përgjithësi. Kjo frymë e bën veprën përmbajtjesore, atraktive, të freskët dhe tërheqëse për atë që e lexon dhe që mundohet të thellohet në kuptimin e saj. Ajo që veprën e dallon nga veprat e shumta në gjuhën shqipe, është fakti se autori tenton që t’i shpjegojë porosinë e Kuranit famëlartë në frymën e shkencave të ndryshme, që në të njëjtën kohë është edhe guxim i pashoq për të treguar se Kurani famëlartë është i vlefshëm për çdo kohë dhe për çdo vend, pa marrë parasysh nivelin e ngritjes shkencore të njerëzimit, vlerësojnë studiuesit e saj.

Begzat Begzati u lind në vitin 1936 në

fshatin Gjonovicë të Gostivarit. Punoi si arsimtar dhe administrator në arsim. Veprën artistike dokumentare “Sulltana” e botoi më 1993, e cila u ribotua më 1995 dhe 2003. Më 1994 botoi monografinë “Xhemë Hasa - ushtarak demokrat”, e cila u ribotua më 1995. Në vitin 1998 botoi veprën në vargje “Pa konsensus”, kurse në vitin 2000 novelën “Zonja e Tugut”. Në vitin 2004 ribotoi monografinë “Sulltana”, me plotësime dhe ilustrime fotografish, si botim i veçantë. Kjo monografi ishte inspirimi i parë për organizimin e manifestimeve përkujtimore dhe ngritjen e përmendores për trimëshën legjendare Sulltane Saliu-Qafa. Monografia “Xhemë Hasa-ushtarak demokrat” u botua në tërësi edhe në gazetën FAKTI në diasporë, në disa vazhdimë. Të dyja këto monografi janë komentuar dhe vlerësuar në programin historik të TV Shqiptar “Bota shqiptare”, si dhe nga media të tjera. Vlerësohet se mu këto dy monografi “hasën në shënjestrën e turmave të lukunisë mediokre, të cilat u vërsulën në shtegun e gatshëm, duke bërë matrapazllëqe, mistifikime dhe plagjiatura”. Aleatët e këtyre hibridëve – thuhet më tej në këtë vlerësim - ishin edhe organet e pushtetit të kohës, të cilët sekuestruan disa ekzemplare të këtyre veprave.

Pjesa e ndritshme dhe meritore për vle-

rësim, megjithatë, ishin insitucionet dhe intelektualët e mirëfilltë, si dhe popullata progresive shqiptare. Begzat Begzati në vitin 2008, krahas veprës “Zëri i shpirtit, mrekulli e Zotit”, botoi edhe librin “Një jetë kushtuar të vërtetës”, që është vepra e shtatë e autorit.

Begzat Begzati me gazetari merret që nga viti 1969. Ka botuar një sërë artikujsh me tematikë të aktualiteteve me interes shoqëror dhe kombëtar. Është anëtar i Shoqatës së Shkrimtarëve Shqiptarë në Maqedoni të Veriut dhe në Shqipëri.

Librat me tematikë historike i kam shkruar me qëllim që vlerat e kësaj pjese të historisë sonë të dalin nga anonimiteti dhe të zënë vendin e merituar në analet historike të popullit shqiptar, deklaroi ai për “Hënën e Re”.

Begzat Begzati është autor edhe i monografisë “Gjonovica, kështjellë iliro-shqiptare”. Në vitin 2013 Komuna e Gostivarit kishte shënuar 100-vjetorin e masakrës së Gjonovicës, ndriçimin e së cilës e kishte bërë pikërisht ky shkrimtar. Në këtë përvjetor në Gjonovicë ishte ngritur edhe një monument kulturor-historik për të përkujtuar masakrën e vitit 1913. Raportohet se për masakrën e Gjonovicës kishte folur edhe shkrimtari Begzat Begzati, banor i fshatit. “Bëhet fjalë për një masakër qyqare, për një masakër shumë të egër. Në lagjen Bigor kanë vrarë 24 banorë, pleq, djem dhe fëmijë. Qëllimi për Gjonovicën ka qenë që rinia më vitale, më e shëndoshë dhe më aktive të arrestohet. Dymbëdhjetë banorë të fshatit Gjonovicë i kanë arrestuar dhe bashkë me 63 banorë të fshatit Simnicë i kanë dërguar në fshatin Cerovë dhe më pas i kanë masakruar. Skenari i kësaj masakre ka qenë shfarosja e banorëve të Gjonovicës dhe të Simnicës”, ka thënë me këtë rast autori i monografisë “Gjonovica, kështjellë iliro-shqiptare”, Begzat Begzati.

Ky shkrimtar është mjaft popullor në Myftininë e Gostivarit, shumë i dashur për çdo besimtar islam në qytetin e Gostivarit dhe në rrethinat e tij. Ai po ashtu ka zënë një vend meritor në panteonin e shkrimtarëve bashkëkohorë shqiptarë. (+HeR)





## “SHKENCA E HADITHIT” NGA FARE DIN EBIBI

Viti 2022 është nisur mbarë në sferën e botimeve: ka dalë nga shtypi libri “Shkenca e hadithit, disiplinat dhe procesi i zhvillimit” i autorit prof. dr. Faredin Ebibi.

Falë rrethanave të krijuara dhe donatorëve, u mundësua publikimi i kësaj vepre kapitale. Me këtë rast shfrytëzoj rastin t’i falënderoj për zemërsisht vëllezërit Elez dhe Adem Aliun, me punë në Zvicër, të cilët me mjetet e tyre materiale e kanë mbështetur këtë projekt, deklaroi autori.

Vepra është nga fusha e Hadithit, është libër profesional, që do t’u shërbejë atyre që merren me studimin e kësaj fushe. Në kuadër të burimeve themelore të fesë islame shkenca e Hadithit e pason Kuranin famëlartë, si burim i dytë i tij. Rëndësia shihet që në nismë: është në funksion të kultivimit të vlerave fetare dhe të zhvillimit të trashëgimisë kulturore të Muhamedit [sal-lall-llahu alejhi vesel-lem].

Myslimanët e parë (sahabët) eksploruan me kohë seriozitetin e kësaj shkence, prandaj ishin të përkushtuar thellë në ruajtjen dhe transmetimin e haditheve në mënyrë verbale. Pra, sipas kësaj rezultoi se edhe filltet e para të kësaj shkence paraqiten atëherë kur ka filluar transmetimi i haditheve në mënyrë gojore. Në të njëjtën kohë, janë zbatuar metoda dhe mënyra të ndryshme të kultivimit, por dhe forma të ndryshme të transmetimit dhe të verifikimit të haditheve. Më saktësisht, në këtë periudhë kohore ka filluar vënia e bazave të strukturës së përgjithshme të gjymtyrëve dhe të disiplinave të shkencës së hadithit, vlerësojnë njohësit e kësaj problematike. (17.01.2022)



## “CIVILIZIMI ISLAM” NË SHQIP

Ka dalë nga shtypi libri “Civilizimi islam - rënia dhe ripërtëritja e tij (Rrënjët kulturore dhe edukative)” i autorit dhe mendimtarit të njohur islam Abdulhamid Ebu Sulejman, ka njoftuar në faqen e vet në Facebook prof. dr. Naser Ramadani.

Libri trajton tema kulturore dhe pedagogjike. Trajton shkaqet e rënies së civilizimit islam dhe mënyrat e ripërtëritjes, me theks të veçantë edukimin e fëmijëve dhe rolin e familjes. Kapitulli i parë trajton problemin e hulumtimit dhe rrënjët e krizës. Vijon me identifikimin e sëmundjes. Kapitulli i tretë ka këtë përmbajtje: Fëmija, bazamenti i nisjes. Zgjidhja bazë – formimi i fëmijërisë, është kapitulli vijues. Kapitulli i pestë titullohet “Familja myslimane është burim i ndjenjave”. Libri mbyllet me ‘planin e punës’, me Përfundimin dhe me literaturën e konsultuar.


Përkthyes është Naser Ramadani, ndërsa libri është botuar nga shtëpia botuese Logos-A, Shkup, 2021. (12.01.2022)

# MONOGRAFIA E PARË E NJË XHAMIE NË DIASPORË

Përkritazi me monografinë me titull "Xhamia 'Ebu Hanife' në Grenchen", të autorit Rexhep Ismaili, teolog nga Kumanova, botuar nga Bashkësia Islame Shqiptare "Ebu Hanife" – Grenchen (Zvicër) në dhjetor të vitit të kaluar. Recensentë të kësaj vepre janë dr. Zija Abdullahu dhe dr. Avni Avdiu.

Monografia është me 260 faqe, e disenjuar në mënyrë përfekte, me tekst dhe fotografi që flasin. Ajo lexuesit i ofron material dhe të dhëna nga më të ndryshmet, që kanë të bëjnë me ecurinë e organizimit të jetës fetare në mërgim, respektivisht në Grenchen (Grenhen) të Zvicrës e më gjerë.

Përmbajtja e kësaj vepre ndahet në dhjetë kapituj, ose pjesë. Në pjesën e parë, që titullohet "Hyrje", përfshihet fjala e recensentëve, parathënia dhe falënderimi për rata që e ndihmuar projektin e ndërtimit të kësaj xhamie. Në pjesën e dytë, e cila është titulluar "Një



histori e shkurtër për Zvicrën", ku fillimisht autori jep një letërnjoftim mbi Kon-

federatën Zvicëranë. Më pastaj vijojnë materialet mbi arsimin fetar-islam në Zvicër, mbi Kantonin e Solothurnit, qytetin e Grenhenit, mbi ardhjen e shqiptarëve në Grenhen, migrimin dhe Islami në Zvicër. Në pjesën e tretë, të titulluar "Misioni i Xhamisë", flitet për rolin e xhamisë në ndërtimin e qytetërimit islam; domethënien e nocioneve "xhami" dhe "mesxhid"; dimensionin socio-kulturor dhe arsimor të xhamisë; xhaminë si vend i dialogut ndërfaqet; xhamitë në diasporë, rolin e tyre në ngritjen e vetëdijes fetare dhe kombëtare dhe rolin e xhamisë në mbrojtjen e identitetit të qenies sonë në mërgim.

Nga pjesa e katërt deri në pjesën e nëntë flitet për Xhaminë e Grenhenit, për zanafillën e saj, për mënyrën e funksionimit, emërtimin e saj me emrin "Ebu Hanife", për të vazhduar për nevojën e ndërtimit të xhamisë së re, blerjen e vendndërtimit, sfidat dhe sprovat në të cilën ka kaluar kjo xhami, lejen e ndërtimit, ecurinë e ndërtimit, hapësirat e xhamisë. Më pastaj përshkruhet hapësira e brendshme e xhamisë, e cila mahnit syrin e çdokujt që e sheh. Përshkruhet akti i hapjes solemne, jepen të dhëna për strukturën udhëheqëse të xhamisë, për Forumin rinor dhe atë të gjinisë femrore. Në pjesën e nëntë përshkruhet roli dhe funksionimi i tanishëm i Xhamisë, ku pos kryerjes së obligimeve fetare, mbajtjes së mësimbesimit, xhamia rol të rëndësishëm luan edhe në aspektin humanitar dhe bamirës, duke ndihmuar njerëzit në nevojë. Po ashtu, përshkruhet edhe biblioteka e Xhamisë, e cila ka një fond të konsiderueshëm librash me tematikë të ndryshme.

Me një fjalë, autori i kësaj monografie me një kujdes të madh i përshkruan të gjitha detajet që kanë të bëjnë me xhaminë "Ebu Hanife" në Grenhen, duke i ilustruar ato edhe me fotografi kolor, që i japin një estetikë të veçantë kësaj vepre. Kjo vepër është për t'u marrë si shembull edhe nga qendrat tjera islame, respektivisht xhamitë tjera jo vetëm në Zvicër, por edhe në shtetet tjera perëndimore, sepse fjala e shkruar mbetet argument i paluhatshëm në histori.

Q. Osmani

## SI E NJOHA MULLA JAKUP ASIPIN

*Ai me të drejtë mund të llogaritet një mufesir i rrallë ndër shqiptarët, sepse ai nuk përdori gjuhën e juristëve myslimanë, pasi ajo mbart disa kuptime gjuhësore e as që përdori gjuhën e filozofëve modernistë, duke përfshirë vështirësitë dhe misteret që përmban, por më tepër ai përdori gjuhën e shkrimtarit dhe bukurinë e gjuhës së popullit, dhe kjo ishte ajo që e bëri unik dhe të veçantë.*

**Nga Hoxhë Nehat Ismaili**

Unë nuk kam njohur mendimtar dhe imam shqiptar më të guximshëm se Hoxhë Jakup Asipin, Allahu e mëshiroftë! Nuk kam njohur komentues të Kuranit fisnik më të zhdërvjellët, më të sinqertë dhe më inteligjent se Mulla Jakupi. Ai ishte një mendimtar dhe imam me dituri enciklopedike në epokën moderne. Ai nuk kishte përvetësuar ngurtësinë metodologjike në interpretimin e fesë, por ishte shumë fleksibil sa i përket materializimit të ideve të tij dhe konvertimit të tyre në programe praktike dhe vizione politike. Ishte një intelektual me një nivel të lartë profesionalizmi, e kjo vërehej sidomos gjatë interpretimit të teksteve të Kuranit fisnik, të cilat te njeriu krijojnë ndjesinë sikur lundron nëpër oqeanë. Idetë dhe mendimet e tij ishin cilësore, ndonëse ai nuk la shumë libra pas vetes shkaku i natyrës së veprimtarisë së tij, por ato që i la ishin me bollëk njohurish, me fjalë të urta, mesazhe, analiza dhe vizione për të ardhmen, të mbështetura mbi forcën e argumenteve dhe të provave, mbi forcën e mendimit.

Ishte i larmishëm gjatë ligjëritimit. Teksa komentonte Kurantin fisnik, kombinonte midis qetësisë shpirtërore dhe suksesit, midis teorisë dhe praktikës. Ai i drejtohej rinisë shqiptare bashkëkohore duke i thënë: « Ju duhet të lexoni libra cilësorë, e jo me cilësi të lartë të kopertinës e as me cilësi të dobët të mendimit. » Ishte si një dritare e re, që jepte shpresë për një të ardhme më të mirë për rininë shqiptare dhe për shqiptarët e proveniencës myslimane viteve tetëdhjetë të shekullit të kaluar, që për të gjithë feja ishte një botë e re, deri atëherë shumë pak e njohur, përpos disa njohurive elementare të Ilmihalit dhe një grupi të kufizuar që

praktinon faljen e namazit.

Ai fliste për bukurinë e Kuranit, për magjinë e Kuranit, për qartësinë e Kuranit, për ndikimin e Kuranit dhe larminë e metodave të Kuranit, por të gjitha këto i interpretonte në një gjuhë të bukur, me një stil unik dhe në një formë të mrekulueshme prej një oratori të rrallë dhe mendjendritur, Zoti e mëshiroftë. Ai përfitoi nga filozofi dhe mufesiri i madh Fahrudin er- Razi, të cilin e kishte lexuar disa herë me radhë. Dhe, sa herë që e pyesja për ndonjë ajet dhe domethënie e tij, me shumë kënaqësi dhe buzëqeshje karakteristike, duke e tundur kokën, thoshte: « Kështu e ka komentuar Imam Raziu. » Rahmet i pastë shpirti!

Mulla Jakupi, përpos që ripërtëriu mendimin dhe diskursin fetar ndër shqiptarët, ai nuk ishte vetëm një përsëritës i ideve të vjetra, por ato i diskutoi, i futi nën thjerrëzën e kritikës shkencore; shumë të tilla i refuzoi dhe disa i pranoi. Nga gjërat më të mira që ai i bëri ishte që ai kërkoi jetën e Kuranit në tekstet e tij, në stilin e tij, dhe ndaloi në çdo tekst duke i bërë analizë gjuhësore dhe përmbajtësore. Ai me të drejtë mund të llogaritet një mufesir i rrallë ndër shqiptarët, sepse ai nuk përdori gjuhën e juristëve myslimanë, pasi ajo mbart disa kuptime gjuhësore e as që përdori gjuhën e filozofëve modernistë, duke përfshirë vështirësitë dhe misteret që përmban, por më tepër ai përdori gjuhën e shkrimtarit dhe bukurinë e gjuhës së popullit, dhe kjo ishte ajo që e bëri unik dhe të veçantë.

Kam pasur nderin dhe rastin të bisedoj shpeshherë për tema më komplekse, por sinqerisht ai njeri ishte një gjeni i vërtetë përplot dituri të thella, teza të ndryshme dhe të llojlloshme. Ai kishte një lexim cilësor të librave të besimeve qiellore; leximi i tij nuk ishte konfuz dhe sipërfaqësor, por me një qëndrim prej



intelektuali i diskutonte dhe i analizonte tekstet e librave të besimeve qiellore, sepse kishte një metodologji të rreptë shkencore.

Vetëm një besimtar si ai mund ta bëjë këtë krijimtari me argumente të besimit, një njeri i cili dëshironte që rininë shqiptare ta largojë nga bota e dyshimit në botën e bindjes ndaj Zotit dhe dorëzimit ndaj Tij. Ai kishte marrë përsipër vendosmërinë për t'i çliruar shqiptarët nga injoranca, nga ndikimi i ideologjisë komuniste dhe ateiste dhe për t'i çliruar nga varësia e mendimit marksist-leninist. Prandaj, oratoria e tij ishte e bukur për nga performanca, stili dhe diskursi i tij ishin shumë të fortë për sa i përket koherencës metodologjike.

Ishte rebel ndaj stereotipeve; e refuzonte traditën e deriatëhershme të interpretimit të fesë, e cila në vitet tetëdhjetë ishte në rol defensiv; ishte i pasionuar pas ripërtëritjes së mendimit dhe diskursit fetar, i thhtar i denjë dhe i pasionuar për rininë e kombit shqiptar (ishte pjesëtar i UÇK-së në konfliktin e 2001-shit) dhe kishte dëshirë të jashtëzakonshme për të thyer mitologjitë dhe besëtytnitë që ishin të shenjta në emër të traditës.

Ai nuk dorëzohej lehtë dhe nuk i pëlqente të jetë si të tjerët, sepse ishte unik në ide, në veprimtari dhe në metodologji dhe si i tillë edhe ia dorëzoi shpirtin Zotit të Plotfuqishëm.

Rahmet pastë shpirti Yt, Hoxhë Jakup Asipi!

Zvicër, Aarburg, 7.01.2021

## PROMOVIM NË GRENCHEN

Më 16 janar, 2022, në Xhaminë Ebu Hanife-Grenchen, Kanton Solothurn, Zvicër, pas namazit të drekës, në prezencën e shumë mysafirëve, u mbajt promovimi i librit (monografi) "Xhamia Ebu Hanife-Grenchen", thuhet në njoftimin e Xhamisë Ebu Hanife-Grenchen.

Të ftuar, si mysafirë, ishin prof. dr. Avni Avdiu nga Kumanova, njëherësh recensent i librit, i cili foli para të pranishmëve për institucionin e xhamisë dhe për librin. Recensenti tjetër, prof. dr. Zija Abdullahu, për shkaqe objektive nuk pati mundësi të jetë prezent.

Autori i monografisë, Rexhep Ismaili, shtjelloi përmbajtjen e librit.

Me fjalë përshëndetëse u paraqit dr. Besim

Nuzi nga Shqipëria, Imam në Langenthal. Moderator ishte mr. Ragmi Destani, Imam i përkohshëm në këtë xhami.

Programi u hap me disa ajete kuranore, të kënduara nga hoxhë Baki Mustafa, imam në Lucern (Luzern). Kryetari i Xhamisë, Fitim Shabani, përshëndeti të pranishmit dhe falënderoi për prezencën e tyre.

Mbyllja e programit u bë me disa ajete kuranore, të kënduara nga hoxhë Emin Odai, Imam në Biel/Bienne. Krejt në fund, duanë e bëri hoxhë Abdullah Esati, Imam në Zuzwil SG, thuhet në njoftimin e Xhamisë Ebu Hanife-Grenchen drejtuar "Hënës së Re" nga Rexhep Ismaili.



# BIOGRAFI E JAKUP ASIPIT (1951-2006)

**Thirrjen e kishte pjesë të përditshmërisë së vet. Jo vetëm në xhami, apo në momente zyrtare. Ai thirrte për Islam në çdo moment, në çdo kohë, në çdo rast.**

**Nga Sead Ramadani  
(Enkas për HeR)**

Hoxhë Jakup Asipi lindi në fshatin Sllupçan të Kumanovës më 2 shkurt 1951. Rrjedh nga një familje fetare. Babai i tij ishte Asipi, kurse nëna Vailja. Vlen të përmendet se edhe gjyshi nga nëna, Adem Ademi, nga fshati Miratoc i Preshevës, ishin familje fetare. Këtë e dëshmon shkruarja në haxh: edhe babai i nënës Ademi, edhe gjyshi Ramadan Asipi, që të dy, kishin qenë në haxh gjatë viteve tridhjetë, para Luftës së Dytë Botërore.

Jakup Asipi ishte fëmija i 6-të i nënës Vaile dhe babait Asip. Prindërit e tij i kishin 8 fëmijë: 3 vajza dhe 5 djem. Vailja kishte lindur edhe fëmijë tjerë, të cilët i kishin vdekur si foshnjë.

Gjatë ditëve kur u lind Jakup Asipi ishte kohë e vështirë: në vendlindjen e tij po zbatohesh vendimi për heqjen e mbulesës së femrave myslimane. Ky vendim në fshatin Sllupçan, ku lindi Jakup Asipi, u realizua me armë dhe me njësite ushtarako-policore. Vetëm 3 ditë pasi që kishte lindur Jakup Asipi, në Sllupçan prezantuan një numër shumë i madh i forcave ushtarako-policore për ta zbatuar këtë vendim, në lidhje me mbulesën. Disa nga njerëzit më me ndikim të fshatit i kishin mbyllur në burg; ndër ta edhe gjyshin e Jakup Asipit, siç i thonin fshatarët - haxhi Danin. Gjatë këtyre ditëve gjyshi i tij, Haxhi Dani, ishte në burg. Pasi që presionet dita-ditës shtoheshin, ka filluar edhe periudha e shpënguljeve. Gjatë periudhës së shpërnguljes së shqiptarëve për në Turqi, familja e Jakup Asipit kanë menduar edhe ata të shpërngulen, por jo në Turqi, por në Sham (Damask). Ky ishte mendimi i gjyshit të Jakup Asipit, sepse Damasku i kishte lënë shumë përshtypje gjatë udhëtimit për në haxh.



## NË KUSHTE TË RËNDA EKONOMIKE

Fëmijërinë e hershme Jakup Asipi e bëri në kushte shumë të rënda për nga aspekti ekonomik. Në atë kohë familja ka përjetuar edhe urinë e skajshme, deri në 3 ditë pa ngrënë; jo pse ishin shumë të varfër, por vetëm 2 ditë pas shitjes së grurit, që e kishin pasur me bollëk, kishin ardhur

nëpunësit e shtetit dhe ia kishin marrë të tërin, deri në kokrrën e fundit, kështu që familja mbetet pa bukë. Babai i Jakup Asipit detyrohet të kërkojë bukë për fëmijët dhe niset për në malësi. Shkon deri në Lubisht të Vitisë dhe atje gjen një breme (barrë) miell të misrit dhe e sjell në shtëpi.

Shkollën fillore e kreu në vendlindje, me sukses të shkëlqyeshëm. Pas mbari-

mit të shkollës fillore vazhdoi t'i ndihmojë familjes, duke iu bashkëngjitur vëllezërve në punët bujqësore. U bë njëri nga punëtorët më të rëndësishëm të familjes. Në moshën 16-vjeçare filloi të mësojë hivzin e Kuranit te hoxha i fshatit Ejub Jashari. Hivzin e vazhdoi deri në devren e tretë, metodë kjo sipas traditës së mësimt të hivzit në këto anë. Mirëpo, për shkak të rrethanave të asaj kohe nuk arriti ta kryente hivzin. Gjatë kësaj periudhe ai ruante edhe bagëtitë e shtëpisë, edhe Kuranin e merrte me vete për të mësuar.

Shërbimin ushtarak e kreu në Armatën e Jugosllavisë. Shërbeu në qytetin Novi-Sad të Vojvodinës.

Në këtë periudhë është interesuar për gjendjen e Islamit dhe të myslimanëve. Në shtëpi ka pasur Kuranin në gjuhën boshnjake, si dhe revistën "Preporod", që ishte organ i Bashkësisë Islame të Jugosllavisë asokohe.

Në moshën 23-vjeçare, në vitin 1974, martohet me Bedrije Selmanin nga fshati Orizare, të bijën e hoxhë Fejzi Selmanit. Nga kjo martesë i lindën 6 fëmijë - 3 prej të cilëve i vdiqën në moshë shumë të vogël, kurse Rejhania, Sadudini dhe Ir-fani jetuan.

Në vitin 1975 shkoi në Damask të Sirisë. Është Damasku qyteti i muhabetëve të familjes së Jakup Asipit, sepse gjyshi i tij haxhi Ramadani gjatë udhëtimit të tij për në haxh në vitin 1938, qyteti që më së shumti i kishte lënë përshtypje ishte Damasku. Për këtë qytet ai kishte biseduar shumë në dhomën e miqve.

Në Damask u regjistrua në medresenë e quajtur El-Furkan. Aty mësoi plot 5 vjet. Vitin e gjuhës dhe vitin e parë të shkollës i kreu për një vit. Qysh në vitet e para u njoh si nxënës shumë i dalluar, aktiv dhe i shoqëruar me njerëz.

Tregojnë shokët se në vitin e dytë u organizua një program për ditëlindjen e Muhamedit (a. s.) dhe drejtori i shkollës e kishte caktuar si moderator të programit. Programi, kuptohet, kishte qenë në gjuhën arabe.

Gjatë periudhës së mësimt në Medresenë e Damaskut, me banim qëndroi në lagjen El-Muhaxhirin, në konviktin e quajtur El-Kehf, na thotë Ridvan Neziri nga Opaja.

## SHUMË AKTIV NË SHPJEGIMIN E KURANIT

Menjëherë pas mbarimit të vitit të dytë u caktua si ligjërues Ramazani në fshatin Sllupçan dhe kështu vazhdoi të jetë vazhdimisht i angazhuar për çdo Ra-

mazan. Në vitin 1979, në një kohë dimri, në xhaminë e fshatit organizoi një tubim me rastin e ditëlindjes së Muhamedit (a. s.). Në xhami qenë tubuar të gjithë hoxhallarët e rrethit. Ishte një program i stilit të veçantë, për shkak se rrjedha e tij bëhej me anë të moderimit. Ai në këto vite ishte shumë aktiv për ta shpjeguar atë që e mësonte. Jo vetëm në xhami, apo në vende publik, por edhe në familje. Zakonisht, pas namazit të jacisë merrte një libër në gjuhën arabe dhe dilte para gjithë anëtarëve të familjes dhe shpjegonte për Islamin. Dilte në mes të dhomës dhe përballë i kishte babën, nënën, vëllezërit, si dhe nipat - 31 veta sa numëronte tërë familja e gjerë. Kështu që, ajo bisedë kishte tamam kuptimin e një ligjërate.

Kishte edhe aftësi humorit të lezetshëm. Gjatë qëndrimit në shtëpi nga pushimet shkollore, një ditë doli nga shtëpia me një çadër grash. Fqinjët kishin dashur ta ngacmonin dhe i kishin thënë: "A bën hoxha me çadër grash të dalë?!" Ai ua kishte kthyer: "Hoxha po bën grua të ketë, e çadër grash s'po bëka!", tregojnë nga familja.

Thirrjen e kishte pjesë të përditshmërisë së vet. Jo vetëm në xhami, apo në momente zyrtare. Ai thirrte për Islam në çdo moment, në çdo kohë, në çdo rast. Krahas punës si hoxhë, ai punonte edhe në shërbim të familjes. Jakup Asipi ndiqte pazaret duke çuar në to prodhimet bujqësore që prodhonte familja e tij. Pazaret që i përcillte ishin: Presheva, Bujanoci, Gjilani, Kamenica, Rogoçica, Hogoshti.

Në vitin 1980, pas mbarimit të Medresesë, u regjistrua në Universitetin El-Az'harit në Kajro të Egjiptit, Fakultetin e Usulludinit-drejtimi Tefsiri i Kuranit. Në vitin 1985 ky universitet festoi 1000-vjetorin e themelimit, rast ky në të cilin studentët e të gjitha rajoneve të botës prezantuanin me nga një përfaqësues. Jakup Asipi përfaqësoi studentët e Jugosllavisë. Në atë ngjarje duhej të përfaqësohet çdokush në tavolinën e vet përpara me flamurin e vet. Jakup Asipi thotë se ka shkuar në Ambasadën e Shqipërisë në atë kohë dhe ka marrë një flamur shqiptar dhe i ka vënë edhe atë jugosllav, por edhe atë shqiptar. Si përfaqësues gjithashtu dhe diskutoi 10 minuta para të gjithë atyre që ishin të pranishëm, duke përfshirë edhe korin diplomatik në Kajro nga mbarë bota.

Gjatë periudhës së studimeve banoi në lagjen "Heliopolis" të Kajros. Vizitoi edhe pendën e Asuanit, një ndër projektet shumë të rëndësishme të Egjiptit.

Pas mbarimit të fakultetit pati një

ftesë që të shërbejë si imam në një xhami të Leverkusenit në Gjermani. Nga dashuria e madhe dhe dhimbja për Xhaminë e Kudsit, ai xhamisë ku vepronte ia dha emrin "Xhamia Aksa-Leverkuzen". Aty Jakup Asipi shërbeu plot 5 vjet me radhë. Kur shkoi Jakup Asipi në Leverkusen, gjeti një numër shumë të vogël njerëzish që shkonin në xhami. Ishte një xhami e vogël dhe filloi bisedat për punën në atë xhami me njerëzit që ishin përgjegjës aty.

## ISHTE ATY KU ISHIN SHQIPTARËT

Jakup Asipit nuk i kishin pëlqyer përmasat e xhamisë. Kishte thënë se xhamia është e vogël. Ata që ishin përgjegjës i thonë: "Çfarë e vogël? Ne s'jemi aq shumë, sa që kjo xhami të jetë e vogël!" Ai i thotë se duhet ta zgjerojnë xhaminë, për shkak se do të shtohet xhemati. Pak kohë pasi filloi punën në xhami, u regjistruan 300 anëtarë - thotë njëri nga përgjegjësit e xhamisë, Mehdi Osmani. Ky thotë se Jakup Asipi terren për punë e kishte çdo vend ku rrinin shqiptarët, si në kafiteri, në klube; gjithkund ku ishin shqiptarët, ai aty ishte për t'u thënë diçka për fenë islame.

Gjatë kësaj periudhe Jakup Asipi bashkëpunoi edhe me klubin e shqiptarëve "Xheladin Zeqiri" në Leverkusen, klub ky i cili e dërgoi si përfaqësues në takimin e Alternativës Kosovare në vitin 1990 në Cankarjev Dom të Lubjanës. Në këtë ngjarje pati rastin edhe të marrë fjalën, ku dha mendimin e tij për të ardhmen e Kosovës. Në tubimin e Lubjanës morën pjesë fytyrat kryesore të Kosovës, të asaj kohe, si: Rexhep Qosja, Adem Demaçi, Zekerja Cana e shumë veprimtarë të tjerë. Kontribut shumë të çmueshëm dha edhe në krah të rezistencës së shqiptarëve në diasporë. Mori pjesë në demonstratat e Gjenezës me plis të bardhë në kokë. Ishte edhe organizator i madh i aksioneve humanitare për ndihma familjeve të rrezikuara në Kosovë, ku dhe bënte shpërndarjen e ndihmave shtëpi më shtëpi nëpër Kosovë.

Gjatë qëndrimit në Gjermani kreu edhe kursin e gjuhës gjermane në Keln.

Në vitin 1990, me kërkesë të bashkëfshatarëve të tij, u kthye në Sllupçan, për t'ia filluar një epokë të re veprimtarie. Në Sllupçan nuk u kthye vetëm si një hoxhë xhamie, por si një frymëzues, si lider i rinisë, si motivues i denjë, si një zë i fuqishëm i arsyes dhe i ngritjes së vlerave morale. /Kryhet në numrin tjetër/

(Autori i këtij teksti është nip, djalë vëllai, i Mulla Jakup Asipit)

# TRANSPLANTI I ZEMRËS SË DERRIT TË MODIFIKUAR GJENETIKISHT NË TRUPIN E NJERIUT

Shkruan: Jusuf Zimeri

Transplantimi është zëvendësimi i një organi që nuk funksionon në trupin e njeriut me një organ tjetër të ri, i cili funksionon. Nuk ka dilemë se përparimi i mjekësisë dhe teknologjisë bëri të mundur transplantimin e organeve prej një organizmi në organizmin tjetër. Me problematikën e transplantimit mjekësia bashkëkohore filloi të merret pas gjysmës së dytë të shekullit XX, dhe si i tillë transplantimi paraqitet si çështje imanente e medicinës, por patjetër të jetë e rregulluar sipas normave juridik .

Në Amerikë një pacient me emrin David Bennet ishte në prag të vdekjes, kurse zemra e derrit në trupin e tij jepte një fije shprese të fundit për jetën e tij. Operatorët amerikanë në qendrën mjekësore të Universitetit të Marilandit morën një leje të veçantë nga autoritetet mjekësore për të kryer operacionin e transplantimit të zemrës së derrit në trupin e Davidit. Operacioni është kryer brenda shtatë –tetë orëve dhe fillimisht është tre-

guar i suksesshëm, por nuk dihet nëse shanset e pacientit për të mbijetuar më gjatë ekzistojnë ose jo.

## “SUPERHEROI”, NJË PAKISTANEZ

Operacioni është kryer nga një ekip mjekësor në krye me mjekun amerikan me origjinë pakistaneze Dr. Muhjudin , i cili u cilësua si një superhero dhe si një nga ekspertët kryesorë në botën e transplantimit të organeve të kafshëve në trupin e njeriut, që quhet ksenotransplantim. Kjo çështje po studiohet prej shumë vitesh, kurse derri i përdorur në këtë proces është i modifikuar gjenetikisht për të prodhuar një gjen që mund të shkaktojë një përgjigje imune te njerëzit.

Vlen të theksohet për lexuesin se para se të bëhet transplantimi i zemrës së derrit të modifikuar gjenetikisht në trupin e njeriut, në tetorin e vitit të kaluar operatorët amerikanë për herë të parë kishin transplantuar një veshkë derri në trupin e njeriut dhe sistemi i imunitetit të njeriut nuk e kishte refuzuar organin e transplantuar nga derri. Modifikimi gjenetik

nënkupton ndryshimet gjenetike që i janë bërë zemrës së derrit dhe heqja e një molekule sheqeri nga indet, gjë që çon në refuzimin e trupit të njeriut.

Ky rast u njoh si përparim i madh, që potencialisht mund të zbusë mungesën e rëndë të organeve njerëzore për transplantim. Mirëpo, pas transplantimit të veshkës së një derri në trupin e njeriut me informacionin që dhanë kirurgët amerikanë nga Universiteti i Marilandit, ku njoftuan se tanimë kanë arritur të bëjnë transplantimin e zemrës së një derri të modifikuar gjenetikisht te një njeri i sëmurë, ngjallën debate dhe polemika të mëdha jo vetëm në mesin e dijetarëve islamë dhe institucioneve relevante islame rreth dispozitës së këtij transplantimi, por edhe te faktorët tjerë ndërkom-bëtarë. Gazeta britanike “The Guardian” më 12 janar 2022 e përshkroi transplantin e parë transgjenik të zemrës së derrit brenda trupit të njeriut si një përparim të dukshëm në shkencën mjekësore, por deklaroi se operacioni ngriti edhe shqetësime të mëdha sigurie dhe etike.

Shkencëtarët gjatë viteve nëntëdhjetë të shekullit të kaluar kishin ndaluar përdorimin e organeve të derrit, kur kishin konstatuar se në ADN e derrit fshiheshin viruse të cilat mund të infektin qelizat njerëzore. Mirëpo, për të tejkaluar këtë problematikë ata vazhduan me kërkime, duke modifikuar ADN-në e derrit, me qëllim që t’i heqin molekulat që çojnë refuzimin imunitar. Shkencëtarët kanë bërë modifikime delikate, që heqin dhjetëra viruse nga indet e derrit, me shpresë se organet do të jenë më të sigurta.

Thënë të vërtetën, transplantimi i organeve të kafshëve te njeriu ka një histori bukur të gjatë. Mjekët amerikanë gjatë viteve gjashtëdhjetë të shekullit të kaluar kishin transplantuar veshkë nga majmuni e llojit Shimpanza te dymbëdhjetë pacientë, porse me përjashtim të njërit, të gjithë vdiqën brenda disa javëve. Po ashtu edhe gjatë viteve tetëdhjetë kishin transplantuar zemrën e majmunit të llojit Babun te një fëmijë në Kaliforni, por ai vdiq pas tri javëve.

## QËNDRIMET E DIJETARËVE ISLAMË

Ashtu siç potencuam edhe më parë, ky veprim ngjalli edhe reagime të shumta

edhe te dijetarët islamë. Që në fillim të theksojmë një të vërtetë madhore, për të cilën ekziston konsensus mes dijetarëve islamë, se derri është i ndytë (nexhis) në esencë, prandaj ky element nuk mund të anashkalohej në asnjë mënyrë.

Në një ndërhyrje në programet satelitore prof. Ahmed Karima, ligjërues i fikhut krahasues në Universitetin Al-Az’har, shprehu një refuzim të plotë të lejimit të një operacioni të tillë, bile edhe nëse është çështje vdekjeje ose jete. Sipas tij, shenjtëria e kësaj çështje vërtetohet me tekst autentik dhe nuk pranon kurrfarë ixtihadi.

Një qëndrim të kundërt ndaj kësaj çështjeje mban dijetari Halid el-Xhundi, anëtar i Këshillit Suprem për Çështje Islame, i cili mendon se për një veprim të tillë duhet falënderuar Allahun (xh. sh.) për begatinë që na dhuroi dijetarë dhe shkencë që të mund të zbulojnë gjëra që shpëtojnë njerëzinë dhe jetën e tyre.

Duke respektuar mendimet e këtyre dijetarëve, mendoj se janë pak qëndrime ekstremiste, të kundërta mes vete, sepse përveç faktit se ka ndodhur transplantimi i zemrës së derrit në trupin e njeriut dhe ka

dhënë rezultatet e para, ende nuk dihet procesi i mëtutjeshëm i mbijetimit apo edhe pasojat që mund të ketë ky lloj transplantimi, që të mund të merren edhe vendime përfundimtare mbi çështjen.

Këtë debat e ka interpretuar edhe Akademia e Fetvasë së Egjipti, duke thënë: Dihet fakti se kërkimi i mjekimit është çështje e ligjësuar sipas Islamit, por jo edhe përdorimi i ndonjë gjymtyre të derrit. Sipas kësaj Akademie, gjymtyra e derrit për mjekim mund të përdoret nëse nuk ekziston alternativë tjetër, sepse ruajtja e jetës është synim i sheriatit. Qëndrim të përafërt ka edhe Universiteti i Az’harit, kur thonë se mjekimi me një gjymtyrë të derrit lejohet nëse plotësohen këto dy kushte, që janë:

- Nëse nuk ka alternativë tjetër, pra nëse nuk ekziston ndonjë mjet tjetër që mund ta kompensojë përdorimin e gjymtyrës së derrit, dhe

- Që pasojat eventuale nga transplantimi të jenë më të pakta sesa pasojat nga mostransplantimi.

Vallahu ealem - Allahu e di më së miri.

## PACIENTI: “KËRKIM NË ERRËSIRË”

Ende nuk dihet nëse operimi do të ketë sukses afatgjatë, mirëpo mjekët e Qendrës Mjekësore të Universitetit Marillend kanë thënë më 10 janar se procedura ka treguar se zemra e një kafshe mund të mbijetojë në trupin e njeriut, pa refuzim të menjëhershëm. Operimi është kryer më 7 janar te një pacient që nuk ka mundur të kryejë transplantim normal dhe ka qenë në prag të vdekjes.

“Ose do të vdisja, ose do të bëja këtë transplantim. Dua të jetoj. E di që është kërkim në errësi, mirëpo është mundësia ime e vetme”, ka thënë 57-vjeçari David Bennett para operimit.

Kompania bioteknologjike “Revivacor”, e cila e ka dhënë zemrën e derrit, ka ofruar edhe veshkën e një derri në tetor, për të kryer transplantimin e parë të veshkës së një kafshe te një njeri, ndonëse truri i pacientit ka qenë i vdekur. Operimi është kryer në Nju-Jork.

Aktualisht ka kërkesë të madhe për



transplantim të organeve, mirëpo ka pak të tilla në dispozicion, andaj kjo gjë ka shtyrë shkencëtarët që të kërkojnë për mënyra alternative.

(REL; 11 janar, 2022, Nju-Jork)

Kirurgu dr. Bartley Griffith, udhëheqës i ekipit që e kreu transplantin e zemrës së derrit te David Bennett, ka dhënë një intervistë ekskluzive për Euronews Albania më 17 janar, 2022.

# TRU BRENDË ZEMRËS

**Ajo që ne e quajmë “mendje” është në qendër të “pompës së gjakut”.**

Shkruan: prof. dr. Jusrije Et-Tavil

Zemra nuk është vetëm një pompë gjaku e thjeshtë, siç pretenduan mjekët më parë. Shkencëtarët sot me seriozitetin më të madh po flasin për një tru që gjendet brenda në zemër e që përbëhet prej 40.000 neuroneve, domethënë ajo që ne e quajmë “mendje” është në qendër të zemrës. Kjo qendër është ajo që drejton trurin që ta kryejë funksionin e vet. Prandaj Allahu i madhërisëm e ka bërë zemrën mjet për të kuptuar dhe logjikuar ne. Allahu (xh. sh.) thotë: **“A nuk udhëtuan ata nëpër tokë e të kenë zemra me të cilat do të kuptojnë, dhe veshë me të cilët do të dëgjojnë? Pse, në të vërtetë, sytë nuk verbohën, por verbohën zemrat në kraharor.”** (Surja El-Haxhu: 46)

Në ajetin tjetër thotë: **“Ata nuk kanë zemra, që me to nuk kuptojnë.”** (El Earaf: 179)

Nga këto ajete qartë na bëhet me dije se Kurani fisnik e ka përcaktuar qendrën e perceptimit të njeriut, e që është zemra, të cilën po e zbulojnë sot shkencëtarët. Allahu i madhërisëm tha: **“Edhe pas (fakteve të qarta), zemrat tuaja u bënë pasandej të forta si guri; e edhe më të forta.”** (El Bekare: 74)

Karakteristikat, në Kuran



Kurani në këtë rast ka përcaktuar karakteristikat e zemrës, që janë ngurtësia dhe butësia. Prandaj, Allahu (xh. sh.) për pabesimtarët ka thënë: **“Të mjerë janë ata që nga zemërfortësia e tyre nuk përmendin Allahun; të tillët janë në humbje të qartë.”** (Zumeri: 22) Përkundër myslimanëve, për të cilët thotë: **“(prej leximit dhe dëgjimit të tij) rrëqethen lëkurat dhe zbuten zemrat e tyre.”** (Zumer: 23)

Secila nga qelizat e zemrës është një depo informacioni dhe ngjarjesh dhe për këtë arsye filluan të mendojnë dhe të flasin për kujtesën e zemrës. Allahu (xh. sh.)

na siguroi se çdo gjë gjendet në zemër dhe se Allahu (xh. sh.) na sprovon duke përjetuar atë që është në zemrat tona. Allahu (xh. sh.) thotë: **“Në mënyrë që Allahu të provojë atë që është në zemrat tuaja (sinqeritetin, ose hipokrizinë) dhe që të pastrojë atë që është në zemrat tuaja. Allahu i di shumë mirë të fshehtat në zemra.”** (Ali Imran: 154)

Defekti më i madh në sistemin e funksionimit të zemrës çon në humbjen e dëgjimit, andaj Allahu (xh. sh.) thotë: **“Ne i godasim (i dënojmë) për mëkatet e tyre, i mbyllim zemrat e tyre dhe ata nuk dëgjojnë (këshillat).”** (El Earaf: 100)

Zemrës i kushtohet një seriozitet shumë i rëndësishëm në shkencë dhe në studime, sepse zemra ndikon në drejtimin e qelizave të trurit. Prandaj Kurani fisnik ka bërë edhe lidhshmërinë mes zemrës dhe shkencës (diturisë). Allahu i madhërisëm thotë: **“Perëndia ua ka vulosur zemrat atyre, por ata nuk e dinë.”** (Teuvbe: 93)

Qendra e gënjeshtërisë gjendet në zonën e përparme, në pjesën më të lartë të trurit, kurse sa u përket informacioneve që i ruan zemra, (ato) janë të vërteta dhe të padyshimta. Prandaj, njeriu kur gënjen me gjuhën e tij, ai e thotë të kundërtën e asaj që e ruan zemra nga informacionet

dhe njohuritë. Prandaj, Allahu (xh. sh.) thotë: **“Ata flasin me gjuhën e tyre, atë që nuk e kanë në zemrat e tyre.”** (El Fet’hu: 11) Në këtë rast, gjuha lëviz me urdhrin që e merr nga pjesa e përparme e trurit, të cilën Allahu (xh. sh.) në Kuran e quan: **“pjesa e përparme e kokës, rrenacak mëkatar”.** (Alek: 16)

Besimi gjendet në zemër e jo në tru, e këtë e kanë vërtetuar disa hulumtues duke studiuar për rëndësinë e zemrës në besim dhe në iman. Allahu (xh. sh.) thotë: **“O ti i dërguar! Të mos bren-gos vrapimi në mosbesim i tyre, që me gojët e tyre thanë: ‘Ne kemi besuar’, e zemrat e tyre nuk kanë besuar.”** (El-Maide: 41)

Njeriu që ka zemër industriale, nuk ka frikë, nuk ndikohet dhe nuk i intereson asgjë për të ardhmen e tij. Këtë e ka definuar Kurani, ku thotë: **“E, besimtarë të vërtetë janë vetëm ata, të të cilëve kur përmendet Allahu rrëqethen zemrat e tyre; kur u lexohen ajetet e Tij, u shtohet besimi, dhe që janë të mbështetur vetëm te Zoti i tyre.”** (El Enfal: 2)

Po ashtu Allahu (xh. sh.) ka bërë që zemra të jetë edhe vendi i frikës dhe trishtimit, andaj Allahu (xh. sh.) thotë: **“dhe në zemrat e tyre hodhi frikën”.** (El Hashr: 2) Kjo është ajo që ne sot e shohim, e veçanërisht gjatë operimit të zemrave artificiale, ku shohim shqetësim të të gjitha sistemeve të trupit të njeriut.

Trajtimi më i mirë i zemrës


Të gjithë shkencëtarët konfirmojnë se shkak i parë për vdekjen e zemrës është çrregullimi i sistemit të funksionimit të zemrës, kurse rruga më e mirë e shërimit të saj është tentativa në vazhdimësi për të stabilizuar dhe qetësuar zemrën. Është vërtetuar se disa frekuenca të zërit ndikojnë në funksionimin e zemrës dhe ndihmojnë për stabilizimin e saj. Prandaj, Allahu fuqplotë thotë: **“Ata që besuan dhe me të përmendur Allahun, zemrat e tyre qetësohen; pra, ta dini se me të përmendur Allahun, zemrat stabilizohen.”** (Er-Ra’d: 28)

Për në fund, i lutemi Allahut fuqplotë që t’i përforcojë zemrat tona në besim, me lutjen e përgjithshme për tërë besimtarët: **“Zoti ynë, mos na i lako zemrat tona pasi na i drejtove; na dhuro mëshirën Tënde, pse vetëm Ti je dhuruesi i madh.”** (Ali Imran: 8)

(Autorja është Profesoreshë e Neurologjisë, Universiteti Zagazig, Egjipt. Nga arabishtja: Jusuf Zimeri)

# TRANSPLANTI I VALVULAVE TË ZEMRËS SË DERRIT TE NJERIU

**Debate të gjera në mesin e dijetarëve islamë në Universitetin e Az’harit në Kajro e më gjerë.**



Fetvaja e përdorimit të valvulave të zemrës së derrit, për shërimin e disa sëmundjeve të zemrës te njerëzit, ka shkakuar debate të gjera në mesin e dijetarëve islamë në Universitetin e Az’harit në Kajro dhe më gjerë. Dijetarët islamë kanë debatuar përkitazi me rregullat të cilave duhet përmbajtur në rast të përdorimit të disa pjesëve të derrit për kurimin e njeriut.

Ish myftiu i Egjiptit, Ali Xhumua, është i mendimit se në raste kur e kërkon

domosdoshmëria e mbrojtjes së shëndeti të njeriut, lejohet përdorimi i valvulave të zemrës së derrit te njeriu, nëse nuk ka mundësi tjetër që valvulat të zëvendësohen në ndonjë mënyrë tjetër të lejuar.

Dr. Muhamed Rewfet Othman, anëtar i Akademisë së Gjurmimeve Islame në Egjipt, fillimisht e konfirmon se në parim ndalohet përdorimi i derrit dhe i pjesëve të tij për ushqim dhe pije, ndërkaq kur është në pyetje përdorimi i pjesëve të derrit për shërim, përgjigjja në këtë pyetje



# ZEMRA DHE ROLI I SAJ NJOHËS



**Ai që nuk e njeh zemrën e vet, ai është injorant në krahasim me të tjerët.**

**Shkruan: Dr. Islam Islami  
(Enkas për HeR)**

Kjo zemër – emrin e së cilës e gjejmë pa realitetin e saj; ose kjo anë, që është pjesë e botës së përtejme, siç është shpirti, të cilin e njohim nga gjurmët e tij dhe jo nga vetvetja, përbën realitetin praktik të pranuar të logjikës së El-Muhasibijut. Ashtu si te sufistët, po ashtu edhe te filozofët myslimanë zemra konsiderohet si bazë e ndërlidhjes dhe e takimit midis botës materiale dhe asaj shpirtërore.

El-Muhasibiju e konsideron zemrën thelbin e vetes njerëzore, që ka pushtet mbi jetën e ndërgjegjshme dhe kuptuese. Nëpërmjet saj ne mund të mësojmë të vërtetën e botës praktike të jashtme dhe të brendshme, shpirtërore, dhe t'i shpjegojmë ato. Zemra përfaqëson personalitetin e njerëzimit, si një personalitet ekzistues, domethënë ekzistenca e saj në lidhje me këtë jetë dhe me jetën në botën tjetër.

Po ashtu, ekzistojnë edhe veprime të organeve të trupit që janë nën pushtetin e saj dhe të cilat ka mundësinë që t'i përballojë për të mirë apo për të keq. Zemra është tërësisht një aparat i brendshëm. Ajo karakterizohet nga vepra të brendshme, siç është operacioni i njohjes, i ndjenjave, i dëshirave, si dhe i veprave të mira dhe të turpshme të zemrës. Ndërsa zemra si organ trupor konsiderohet si kreu i trupit organor dhe kur është në rregull, është në rregull i tërë trupi. Kjo zemër morale është kreu dhe baza e çdo gjëje të brendshme dhe kur është e dobishme, edhe veprat e saj janë të dobishme dhe kur degjeneron, degjeneron gjithçka. Nga zemra fillon gjithçka: veprat e dobishme dhe ato të turpshme. Dhe, natyrisht, në vartësi të pastërtisë apo degjenerimit të saj, njeriu arrin lumturinë apo fatkeqësinë. Prandaj, njohja e zemrës dhe e cilësive të saj, e mënyrës së punës së saj, janë themeli i fesë dhe i besimit dhe filimi i rrugës nëpër të cilën njeriu shkon



drejt Allahut (xh. sh.).

El-Muhasibiju dhe Imam El-Gazali i kanë kushtuar shumë rëndësi zemrës në studimet, mendimet dhe orientimet e tyre.

## FJALA ZEMËR NË KURANIN E SHENJTË

Fjala *zemër* përmendet në Kuranin famëlartë në 144 raste dhe del se domethënëni më të shumta sillen rrotull kuptimit sentimental dhe mendor te njeriu (1). Ajo duket si baza e natyrës së pastër e të shëndoshë dhe të ndjenjave të ndryshme - si të atyre që ngrihen mbi elementet e dashurisë apo të urrejtjes, ashtu edhe të orientimit, besimit, dijeve, njohjes, dëshirave dhe përmbajtjes.

Në kuptimin semantik të fjalës, nga ana e natyrës së shëndoshë, i Madhërishtmi ka thënë: **“Vetëm kush i paraqitet Zotit me zemër të shëndoshë.”** (Surja Esh-Shu' Araë – 89)

Ndërsa, prova për konsideratën, kuptimin apo orientimin, duket në ajetet që vijnë: **“Në të gjitha këto, për atë që ka mendje të shëndoshë dhe që i ka vënë veshin me vëmendje, ka argumente.”** (Kaf: 37) Thënia e të Madhërishtmit: **“E kush i beson Allahut, Ai ia udhëzon zemrën atij; Allahu është i gjithëdijshëm për çdo send.”** (Et-Tegabun–11) Thënia e të Madhërishtmit: **“O ti, i Dërguar, të mos të të brengos vrapimi në mosbesim i atyre që me gojë të tyre thanë: ‘Ne kemi besuar’; e zemrat e tyre nuk kanë besuar (mynafikët)...”** (El Maide: 41) Thënia e Tij: **“...Por, Allahu juve ua bëri të dashur besimin dhe ua zbukuroi atë në zemrat tuaja.”** (El-Huxhurat: 7) Si dhe thënia e të Madhërishtmit: **“...përveç atij që është i detyruar me forcë, ndërkohë që zemra e tij është plot besim”.** (En-Nahl: 106)

Por, zemra jo gjithnjë është në rolin e orientuesit dhe të besimit. Ajo mund të drejtojë nga *mekati* dhe *mosbindja*, siç e thotë edhe i Madhërishtmi: **“Ja, kështu Ne e bëjmë mohimin të futet në zemrat e gjynahqarëve.”** (Surja El-Hixhr: 12), apo: **“Mos e fshehni dëshminë, sepse ai që e fsheh atë, ai është mëkatar, me zemrën e vet; Allahu di për atë që vepron.”** (El-Bekare: 283)

Ndërkaq, dëshmia e zemrës në lidhje me ndjenjat e ndryshme duket në ajetet që vijojnë: **“...në zemrat e pasuesve të tij mbollëm butësi dhe mëshirë...”** (El-Hadid: 27) Dhe: **“... Allahu ua bëri një dëshpërim në zemrat e tyre...”** (Ali Imran: 156), si dhe thënia e të Madhërishtmit: **“Ne do të mbjellim frikë në zemrat e atyre që nuk besuan...”** (Ali Imran: 151), si dhe thënia e të Madhërishtmit: **“Edhe pas (fakteve të qarta) zemrat tuaja u bënë mbasandej të forta si guri...”** (El-Bekare: 74)

Nga e gjithë kjo, neve na duket se kuptimi i zemrës në Kuran është shumë më i specializuar sesa shpirti, siç thotë edhe dr. Abdulkërim Othman. Ai nuk tregon për motive instiktive, apo për ndonjë

dallon sipas nivelit të domosdoshmërisë së përdorimit të tyre. Ai thekson: Në rast se përdorimi i një organi apo pjese të derrit është zgjidhja e vetme e mbetjes së të sëmurit në jetë, apo e shërimit të sëmundjeve të caktuara, nga aspekti fetar lejohet që të bëhet shërimi i të sëmurit përmes kësaj pjese të derrit. Kjo do të thotë se nuk është mëkat përdorimi i pjesëve të derrit për shërim, nëse nuk ka mënyra të tjera të shërimit përmes gjërave të lejuara, me kusht që organi në fjalë të shërohet dhe të ndryshohet natyra e fëlliqtë e pjesës së derrit.

Dr. Amine Nesir, profesoreshë e Akaidit në Universitetin e Az'harit, nuk e sheh problematik përdorimin e pjesëve të derrit për çështje medicinale. Ajo sqaron se nuk ka fare dyshim se Allahu i madhërishtëm e ka ndaluar ngrënien e mishit të derrit, por përdorimi i disa pjesëve të derrit për transplant te njeriu, nuk është ngrënie e mishit të derrit. Për këtë, ajo mendon se është e lejuar përdorimi i pjesëve të derrit për shërimin e njeriut.

Shejh Muhamed AbdulAziz, ish-kryetar i Komisionit për Fetva në Xhize, mendon se fetvaja për trasplantin e valvulave të derrit te njeriu nuk është diçka e re, ngase më herët shejh Atije Sakër, kryetar i mëparshëm i Komisionit për Fetva në Az'har, ka dhënë një fetva për lejimin e përdorimit të pankreasit të derrit për shërimin e njeriut, nisur nga fakti se diçka e tillë është domosdoshmëri-darure, e domosdoshmëritë i lejojnë gjërat e ndaluara. Shejh Atije Sakër mbështetet në argumentin se trupi i njeriut në brendi përmban gjërat të papastra, si: gjak, urinë, etj. dhe Allahu i pranon adhurimet tona, edhe pse në brendinë e trupit tonë i kemi këto gjëra të papastra. Po ashtu, ai mbështetet edhe në argumentin se njeriu i le-

johet të hajë mish derri nëse nuk ka asgjë tjetër për ushqim. Mirëpo, kusht për këtë është që, përpos pjesëve të derrit, mos të ketë gjëra të tjera të lejuara, përmes të cilave mund të bëhet shërimi i njeriut. Shejh Atije Sakër pohon se në rast se ka alternativa të tjera, të cilat e zënë vendin e pjesëve dhe të organeve të derrit, nuk lejohet në asnjë mënyrë që të përdoren për shërim organe të kafshëve të papastra.

Këshilli i Akademisë së Fikhut Islam ka marrë vendim se lejohet të merret një organ nga një kafshë së cilës i hahet mishi dhe e cila është therur në çdo rast, si dhe nga kafshë të tjera të cilave nuk u hahet mishi dhe nuk janë therur, në raste të domosdoshme-darure dhe të trasplantohet në trupin e njeriut, që është i detyruar domosdoshmërisht t'i bëhet një transplant i këtyllë.

Është pyetur shejh Muhamed ibn Salih el-Uthejmin për këtë çështje dhe është përgjigjur se kjo nuk paraqet problem dhe nuk është e ndaluar, që njeriu të përdor për shërimin e zemrës organe të kafshëve të tjera, ngase kjo nuk është ngrënie. Allahu e ka ndaluar ngrënien e mishit të derrit, e përdorimi i organeve dhe pjesëve të derrit për shërim, nuk është ngrënie e mishit të tij. Kur e kemi parasysh se ai nuk mund të gjejë mënyrë tjetër shërimi përpos të trasplantit të organeve të derrit, atëherë kjo merr tretmanin e domosdoshmërisë-darure. Allahu i madhërishtëm ka thënë: **“...e Ai (Allahu) ju sqaroi juve se çka është e ndaluar për ju, përveç kur jeni të detyruar...”**[el-En'am: 119]. (Likau-l-babi-l-meftuh, 106, pyetja nr.2)

Dr. Muhamed Sejjid Tantavi, ish-Shejhu-l-Az'har, pohon se kjo çështje u kthehet mjekëve dhe ekspertëve të fushave përkatëse. Nëse mjekët kompetentë kon-

statojnë se nuk ka zgjidhje tjetër pos përdorimit të valvulave të derrit për njeriun, dhe se nuk ka alternativë tjetër pos kësaj, atëherë fetarisht lejohet përdorimi i këtyre valvulave. Ai për argument e merr ajetin: **“(Allahu) Ua ndaloi juve vetëm të ngrodhtën, gjakun, mishin e derrit dhe atë që theret (ngritet zëri me te) jo në emër të Allahut. E, kush shtrëngohet (të hajë nga këto), duke mos pasur për qëllim shijen dhe duke mos tepruar, për të nuk është mëkat. Vërtet, Allahu fal, është mëshirues.”** [el-Bekare: 173]

Shejh Xhemal Kutub, sekretar i Fetvave në Az'har, pohon se studiuesit duhet ta kenë parasysh se njeriu është kalif i Allahut në tokë dhe më i dalluari i gjallesave të tjera. Për atë, në trupin e tij duhet të depërtojë vetëm ajo që është e pastër. Ekspertët duhet të vazhdojnë me studime, që të gjejnë alternativa të tjera dhe të bëjnë eksperimente të vazhdueshme me gjallesa të tjera nga bota e kafshëve, që të gjejnë kafshë tjetër më të mirë se derri.

Dr. Kemal abu-l-Mexhd, mendimtar i madh islam, pohon se kur është në pyetje derri, është i ndaluar të hahet mishi i tij dhe të përdoret si ushqim, ndërkaq trasplantimi i një pjese dhe organi të derrit te njeriu, nuk ka qenë objekt shqyrtimi te juristët islam më herët. Dr. Ebu-l-Mexhd thotë se ka një rregull tjetër juridik islam, që e plotëson këtë çështje, përkatësisht rregulli juridik islam është: Gjërat e domosdoshme i lejojnë gjërat e ndaluara. Së këndejmi, nëse një mjek i besueshëm konstaton se jeta e pacientit varet nga përdorimi i një organi të këtyllë, është e sigurt se ajo që është e domosdoshme, e lejon atë që është e ndaluar. (14.01.2022)

**Përktheu prej arabishtes: Bashkim Aliu/bashkëpunim me HeR**



Kajro

element jetësor, por kufizohet në pjesën e ndërjegjshme të saj.

Po kështu, kujtojmë disa modele kurane ku na sqarohet se zemra kryen funksione të mendjes dhe të shqisave.

Allahu i Madhërishtëm thotë:

1. **“A nuk udhëtuan ata nëpër tokë e të kenë zemra me të cilat do të kuptojnë, dhe veshë me të cilët do të dëgjojnë?..”** (El-Haxh: 46)

2. **“A nuk e studiojnë me vëmendje Kuranin? Por jo, ata janë zemra që kanë drynat e vet!”** (Muhamed: 24)

3. **“...Allahu ua ka vulosur atyre zemrat, por ata nuk dinë.”** (Et-Teube: 93)

4. **“...nëse dëshirojmë, Ne i godasim (i dënojmë) për mëkatet e tyre, ua mbyllim zemrat e tyre dhe ata nuk dëgjojnë (këshillat).”** (El-Araf: 100)

5. **“...Në të vërtetë, atyre nuk u janë verbuar sytë (në këto gjëra), por u janë verbuar zemrat e veta në kraharor.”** (El-Haxh: 46)

Duke medituar në këta shembuj, zbulojmë se funksioni i zemrës në radhë të parë është funksion kuptues dhe njohës. Në shembullin një, zemra mendon 2). Në këto ajete, zemrës i kërkohet që të vështrijë fenomenin e gjithësisë, që d.m.th të kalojë nga e pjesërishtë tek e përgjithshme, që në radhë të parë është punë mendore.

Ndërsa në shembullin dy, zemra duhet të përsiat në Kuranin e shenjtë. Në Kuran ka tregime për popujt e mëparshëm. Aty ka ligjshmëri dhe monoteizëm.

#### “MBRETËRESHË E NJOHJES”

Nga sa u përmend më sipër, konkludojmë se zemra si mbretëreshë e njohjes kryen detyra të mendjes në vështrim, përsiatje, shkencë; gjithashtu kryen edhe detyra të shqisave në lidhje me kuptimin 3).

Po ashtu, detyra më e rëndësishme kuptimore e zemrës është fikhu - e drejta islame ose fikhu i zemrës. Ajetet që e bëjnë të qartë një gjë të tillë janë: Allahu i Madhërishtëm ka thënë: **“...Ata kanë zemra, me të cilat nuk kuptojnë...”** (El-A'rafë: 179) dhe **“...zemrat e tyre janë mbyllur, andaj ata nuk kuptojnë”**. (Et-Taube: 87) dhe **“...Allahu i shmang zemrat e tyre, sepse ata janë njerëz që nuk kuptojnë!”** (Et-Teube: 127) dhe **“Ne kemi vënë perde në zemrat e tyre, që të mos e kuptojnë atë (Kuranin)”**. (El-Kehf: 57) Po ashtu: **“...zemrat e tyre u vulosën dhe si pasojë ata nuk kuptojnë më”**. (El-Munafikun: 3)

Fjala *fikh* në Kuranin e shenjtë përmendet njëzet herë në forma të ndry-

shme, nga të cilat fjala e të Madhërishtëm: **“Ai është që ju krijoi (filloi) prej një njeriu, aty (mbi tokë) jetoni (qëndroni) dhe nën të do të pushoni. Ne i sqaruam argumentet një populli që di të kuptojë.”** (El-En'am: 98), si dhe thënia e të Madhërishtëm: **“O Shuajb, ne nuk po e kuptojmë shumicën nga ajo që thua dhe ne të konsiderojmë ty të dobët në mesin tonë...”** (Hud: 91)

Cilësive të përmendura më sipër të zemrës u shtohet edhe ajo që ajo është e vetmja që ka një funksion të rëndësishëm, që është se: asaj i zbret frymëzimi hyjnor 4). I Madhërishtëm thotë: **“Thuaj: Kush është armik i Xhibrililit (është armik i Allahut), e ai me urdhrin a Allahut e zbriti Kuranin në zemrën tënde, që është vërtetuesi i asaj që ishte më parë dhe udhërrëfyes e përgjësues për besimtarët.”** (El-Bekare: 97)

I Madhërishtëm thotë: **“Nuk ka dyshim se ky (Kuran) është Shpallja prej Zotit të botëve. Atë e zbriti Shpirti i besueshëm (Xhibrili). (E soll) Në zemrën tënde, për të qenë ti prej atyre që tërheqin vërejtjen (pejgamber).”** (Esh-Shua'raë: 192-194)

Zemra ka edhe një funksion tjetër, plus atyre që thamë më lart. “Atë Kurani i shenjtë e konsideron si një etapë më të lartë nga besimi. Me këtë kam parasysh që zemra qëndron sipër, thjesht, besimit të zakonshëm, që është gjendja e sigurisë” 5).

I Madhërishtëm thotë: **“Kur Ibrahim tha: O Zoti im! Tregomë si i ngjall të vdekurit!” - Zoti i tha: “A nuk beson?” - “Besoj”- iu përgjigj Ibrahim, “por dëshiroj të më qetësohet zemra.”** (El-Bekare: 260)

I Madhërishtëm thotë gjithashtu: **“Allahu e bëri këtë fitore si lajm të mirë që të qetësohen zemrat tuaja me të...”** (El-Enfal: 10)

Ai thotë: **“Ata që besojnë dhe zemrat e të cilëve kur përmendet Allahu (xh. sh.) qetësohen. Vërtet zemrat qetësohen me përmendjen e Allahut.”** (Er-Rra'd: 28)

Nga gjithçka që paraqitëm, mund të kuptojmë atë që ka thënë Ibn Mendhuri: *Zemra është mendja*, si dhe thënie e El-Faraut: *Zemra është të kuptuarit dhe përsiatja*. Si dhe thënie e Ibn Sejjida: *Zemra është mendja*.

Ndoshta më e rëndësishme që vihet re me këtë rast është fakti që zemra vihet në një vend më të lartë se mendja, sepse ajo kryen detyrat e saj njohëse dhe kuptuese dhe ia kalon mendjes me fikhun (të kuptuarit) dhe me funksione të tjera që nuk mund të kuptohen 6).

#### ZEMRA NË ASPEKTIN GJUHËSOR

Zemra në gjuhë është pjesa më e pastër e çdo gjëje dhe qëndron më lart prej tyre. Autori i “Fjalorit të përmasave të gjuhës” ka thënë: “(Shkronjat) Kāfun, Lāmūn dhe Ba’un (Kalbun) janë dy rrënjë integrale, ku njëra prej tyre tregon për pastërtinë dhe ndershmërinë e një sendi. Tjetra tregon zemrën e njeriut etj. Ajo u quajt kështu, sepse përfaqëson gjënë më të pastër të një sendi dhe më të lartë. Pjesa më e pastër dhe më e ndershme e çdo sendi është zemra e tij.” 7).

Zemra ka rëndësi të madhe për njeriun. “Zemra është ajo që po ta njohë njeriu, ka njohur vetveten dhe nëse njeh vetveten, ka njohur edhe Zotin e tij. Zemra është ajo që po qe se njeriu nuk e njeh, nuk e njeh as vetveten. Dhe, nëse nuk e njeh vetveten, nuk e njeh as Zotin e tij. Ai që nuk e njeh zemrën e vet, ai është injorant në krahasim me të tjerët. Shumica e njerëzve janë injorantë në lidhje me zemrat dhe vetet e tyre” 8).

#### REFERENCA

Abdulkerim Othman, “Studime shpirtërore të myslimanët dhe tek El-Gazali në veçanti”, faqe 56, botues: Biblioteka “Vehba”, botimi i dytë, viti 1981.

Ibni Mandhur, Lisanu El-Arab, vëllimi 1, faqe 685, që thotë: “Me zemër mund të shprehet mendja. Në thënie e të Madhërishtëm theksohet: ‘Në to është kujtesa për ata që kanë zemër’, që do të thotë: Zemër.” El-Farrau me një thënie të një grupi: Ku është zemra jote? Që do të thotë: “Ku është mendja jote?” Të tjerët thonë: *Për atë që ka zemër - që do të thotë për atë që kupton dhe që përsiat*.

Profesori ynë dr. Muhammed Abdulah Esh-Sharkauj, Es-Sufije ve El-Aklu, *Sufizmi dhe mendja*, faqe 73.

I njëjti burim, faqe 77.

I njëjti burim, faqe 77.

Burimi i mësipërm, faqe 81.

Abu El-Husejn Ahmed Bin Feris Bin Zekerija, “Muaxhhemu Makajisi El-Lugati” (Fjalor i përmasave të gjuhës), vëllimi i pestë, faqe 17; nën kujdesin e dr. Abduselam Harun, Dar El-Fikër, viti 1399 i hixhrit.

El-Gazali, Ihja’u Ulumi Ed-diini (Ringjallja e shkencave të fesë), vëllimi i tretë, faqe 3.

(Autori është Profesor në Medresenë Isa Beu në Shkup)



# DIJETARËT: MARTESA SJELL SHPËRBLIMIN



**Pjesa dërrmuese e dietarëve dhe e mendimtarëve myslimanë mbajnë qëndrimin se mosmartesa ka pasojë të dëmshme psikologjike, sociologjike dhe emocionale te njerëzit, duke i larguar ata nga zbatimi i parimeve fetare islame. Njeriu si krijesë e krijuar nga ana e Allahut (xh. sh.) si synim kryesor dhe përfundimtar të krijimit e ka adhurimin. Por, gjithçka që e pengon në rrugën e adhurimit të Allahut (xh. sh.) është e ndaluar dhe gjithçka që i ndihmon në këtë rrugë, është e lejuar.**



**Shkruan: Shefije Mamuti**

Mendimtarët dhe dietarët e ndryshëm nga e kaluara, por edhe të tanishëm, përmendin shumë konsekuenca ose pasojë të mosmartesës. Ata nisen nga ideja e nevojave seksuale të njeriut, të cilat nëse realizohen përmes rrugëve të ndaluara, nuk ka dyshim se ka mëkat, ndërsa nëse realizohen përmes rrugëve të lejuara, siç është martesë, nuk ka asnjë dyshim se për to do të ketë shpërblim. Pjesa dërrmuese e dietarëve

dhe e mendimtarëve myslimanë mbajnë qëndrimin se mosmartesa ka pasojë të dëmshme psikologjike, sociologjike dhe emocionale te njerëzit, duke i larguar ata nga zbatimi i parimeve fetare islame. Njeriu si krijesë e krijuar nga ana e Allahut (xh. sh.) si synim kryesor dhe përfundimtar të krijimit e ka adhurimin. Por, gjithçka që e pengon në rrugën e adhurimit të Allahut (xh. sh.) është e ndaluar dhe gjithçka që i ndihmon në këtë rrugë, është e lejuar. Kontrolli mbi veten dhe emocionet nuk mund të realizohet për-

mes konceptit të mosmartesës. Edhe pse ka përjashtime, siç ka përjashtime në çdo rregull. Me përjashtime nuk ndërtohen hipotezat dhe nuk ngrihen argumentet.

Dijetari i madh Ibn Haxheri, Allahu e mëshiroftë, në mënyrë të detajuar e ka komentuar urtësinë e ndalimit të tredhjes në Islam. Në këtë mënyrë ka folur edhe për mosmartesën. Edhe pse ka pasur mendime të ndryshme në lidhje me tredhjen, të cilat e lejojnë, por me atë parim nuk punohet, pasi që kjo gjë është zëven-

dësuar me adhurimin e agjërimin. Ibn Haxheri (rahimehullah), është kategorik se tredhja është e ndaluar në Islam. Në këtë mënyrë, ai na bën me dije se edhe mosmartesa është një kategori e cila bie në kundërshtim me Sunnetin e Pejgamberit Muhamed (alejhi-s-elam).

### TREDHJA, NË KUNDËRSHTIM ME VULLNETIN E KRIJUESIT

Ibn Haxheri (rahimehullah), në veprën e tij të famshme *Fat'hul al Baari* 9/119 ka thënë: “Urtësia e ndalimit të tredhjes qëndron aty se bie në kundërshtim me vullnetin e Krijuesit, i cili kërkon vazhdimësinë e riprodhimit, me qëllim që të vazhdohet xihadi kundër jobesimtarëve. Përndryshe, nëse tredhja do të lejohej, atëherë shumë njerëz do ta kishin praktikuar dhe riprodhimi do të ndalohej; në këtë mënyrë numri i myslimanëve do të zvogëlohej, ndërsa numri i mosbesimtarëve do të ishte rritur. Kjo gjë do të binte në kundërshtim me atë me të cilën është dërguar Pejgamberi (sal-lallahu alejhi vese-l-em).

Tredhja, njashu ka edhe një numër të madh pasojash negative, si për shembull: vetëdëmtimin, deformimin deri në shkaktimin e dëmeve që mund të çojnë në vdekje. Njashtu, përmes tredhjes eliminohen cilësitë e burrërisë, të cilën Allahu (xh. sh.) ka krijuar te njeriu, pra ndërhyhet në krijimin e Allahut (xh. sh.) te njeriu, që është një lloj mosmirënjohjeje për bekimet e shumta. Për më tepër, është një imitim i grave dhe zgjedhje e asaj që është e papërsosur mbi atë që është e përsosur.<sup>1</sup>

Shoqëria jonë sheh shumë rrugë të devijimit përmes shtyrjes së martesës deri në nivelin e ftohjes prej saj. Ajo nuk mund të përballojë vrullin seksual të pavendosur në korniza legale.

Ibn Kudameh, Allahu e mëshiroftë, ka komentuar në gjerësi kategoritë e personave në lidhje me martesën. Në të gjitha variantet thuajse ka përjashtuar kategorinë e mosmartesës, ndërsa ka preferuar martesën. Ibn Kudameh, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: “Ekzistojnë tre lloje njerëzish në lidhje me martesën:

- Lloji i parë janë ata që frikësohen se do të bëjnë gjëra të këqija nëse nuk martohen. Sipas shumicës së dijetarëve të shariatit, për këtë kategori është vaxhib martesa dhe janë të obliguar që ta ruajnë nderin e tyre, të ruhen nga harami dhe të martohen;

- Kategoritë e dytë janë ata për të cilët është e dëshirueshme që të martohen. Këto janë ata të cilët ndjejnë nevojë fi-



zike, për të cilat mund që të bëjnë haram. Për ta më mirë është që të martohen sesa të bëjnë adhurime vullnetare. Ky është mendimi i kompetentëve dhe ata këtë gjë kanë mundur ta konkludojnë përmes fjalëve dhe veprimeve të sahabëve (radijallahu anhum).

Ibn Mes`udi (radijallahu anhu) ka thënë: “Kur nga vdekja do të më ndanin dhjetë ditë dhe kur do ta dija në ditët e fundit se do të vdes, ndërsa në anën tjetër do të më afrohej mundësia për t`u martuar, do të isha martuar nga frika prej fitnes.”

Sei`d ibn Xhubejr (radijallahu anhu) ka thënë se Ibn Abbasi (radijallahu anhu) e ka pyetur: “A je martuar?” “Jo”, jam përgjigjur, ndërsa ai më ka thënë: “Martohu, se më të mirë në këtë ummet janë ata që kanë më shumë gra.”

- Kategoritë e tretë janë ata që nuk kanë nevojë (ndjenja), ose janë impo-

tentë, ose kanë pasur nevojë, por i ka arritur pleqëria, sëmundja ose gjëra të ngjashme. Në lidhje me ta ekzistojnë dy mendime:

*E para:* Është e pëlqyeshme që të martohet për shkak të arsyeve dhe gjërave që i përmendëm më lart;

*E dyta:* Më mirë për ta është vetmia (të mos martohen), përderisa nuk do të kenë mundësi që ta arrijnë kënaqësinë e martesës, përderisa gratë e tyre mund t`i pengojnë me gjëra të tjera që kjo gjë të realizohet, ndërsa edhe veten do ta vënë përballë obligimeve dhe detyrimeve të cilat nuk mund të kryhen dhe, si rezultat i kësaj, do të lihet anash shkenca dhe adhurimi, ku nuk do të ketë asnjë dobi.<sup>ii</sup>

Bekir Topaloglu është një dijetar bashkëkohor mysliman turk, i cili është mjaft i drejtpërdrejtë në lidhje me këto tema, e sidomos për konsekuencat e mosmartesës: “Të ikurit nga martesa është

rrugaçëri dhe shkas që energjia me të cilën posedon njeriu të bëhet shumë e rrezikshme. Secili njeri ndjen nevojën për kënaqësi seksuale. Kjo po nuk u realizua në mënyrë legale, do të kalojë në punë jolegale: onanizëm, homoseksualitet, marrëdhënie me fëmijë e me kafshë... Dhe, shkak për të gjitha këto anomalitë çoroditura është mosmartesa. Kjo dhe mosplotësimi i nevojave seksuale për organizimin dhe shpirtin e njeriut, janë jo vetëm të dëmshme, por edhe të rrezikshme. Ikja nga martesa bazohet në shtimin e pronësisë, largimi nga obligimet dhe frika nga krijimi i familjes, e cila shoqërisë do t`i sillte dobi. Po ua ktheu kurvizin virtyeteve shpirtërore duke e trajtuar materien si një gjë të shenjtë, do të teprohej, e shoqërisë do t`i merrej liria e pavarësia dhe do të bëhej rob i epsheve dhe shfrenimeve të tepërta.<sup>iii</sup> Në anën tjetër të medaljes përmenden pasojat shoqërore

dhe fetare të mosmartesës. Pasoja këto të cilat ia pamundësojnë njeriut që të përfitojë prej dobive të shumta fetare që krijon raporti martesor.

### NGA MOSMARTESA HUMBEN PËRFITIMET E SHUMTA TË MARTESËS

Një pjesë e konsiderueshme e dijetarëve dhe mendimtarëve myslimanë vlerësojnë se nëse njeriu merr rrugën e mosmartesës, kjo gjë nuk nënkupton se ai ka dalë prej feje e as se është më pak mysliman se të tjerët. Porse, nuk ka mundësi që të përfitojë prej dobive të shumta, të cilat realizohen vetëm me institucionin e martesës.

Dijetari i madh islam Xhezeri, i cili ka sqaruar detajisht çështjen e mosmartesës, në veprën e tij “En Nihaje” thotë: Fjala “Et Tebetul”, d.t.th. dorëheqje në

mënyrë të ndërprerë prej grave, si dhe braktisje të aktit të kurorës. Ndërkaq, gruas që i ka ndërprerë kontaktet me burrat dhe nuk ka ndjenja epshore për ta i thuhet ‘murgeshë’. Kështu janë emërtuar Merjemja, nëna e Isait (a. s.) dhe Fatimja, vajza e Muhamedit (sal-lallahu alejhi vese-l-em), e cila ishte e ndarë dhe e daluar nga gratë e kohës së vet si në aspektin e vlerave, të fesë dhe të prejardhjes - aq më tepër, thuhet se ishte e ndarë nga të gjitha mirësitë e kësaj bote dhe tërë qenien e saj ia kishte përkushtuar Allahut të madhërishtëm.<sup>iv</sup>

Imam Neveviu për çështjen e tredhjes thotë: “Sipas mendimit të shokëve tanë, ky refuzim konkretisht ka të bëjë me ata të cilët ndjejnë nevojë për martesë dhe dëfrim epshor, që për një gjë tillë kanë pasuri dhe mundësi fizike.”<sup>v</sup>

Et Tibi në lidhje me hadithin e Othman ibn Mezunit dhe ndalesën e tredhjes thotë: “Et Tibi, pohimin e Sa`d B. Vekasit e shpjegon duke thënë se ai realisht ka dashur të thotë: ‘Sikur Osmanit t`ia kishte lejuar (ndërprerjen e martesës), ne të gjithë do ta kishim ndërprerë martesën’, por ai nga ky realitet ka ikur, andaj ka thënë: ‘Ne të gjithë do të ishim tredhur’. Ai me këtë ka dashur të shprehet se sikur kjo të kishte ndodhur, atëherë tredhja në mes nesh do të mbi-sundonte në mënyrë të tepruar. Megjithatë, me këtë ai nuk ka dashur të thotë se me të vërtetë ata do të ishin tredhur, për shkak se një veprim i tillë ka qenë i ndaluar (haram). Megjithatë, ka mendim që thotë se pohimi i tij nuk ka qenë formalitet, sepse kjo është thënë para ndalimit të tredhjes, mendim të cilin e përkrahin rrëfimet që tregojnë se një grup i as`habëve, siç janë Ebu Hurejre, Ibni Mes`udi, si dhe shumë të tjerë, prej Pejgamberit (sal-lallahu alejhi vese-l-em) vazhdimisht kanë kërkuar leje për tredhje.”<sup>vi</sup>

Adil Salahi është njëri prej mendimtarëve bashkëkohorë saudit që ndan këto mendime dhe vlerësime në mënyrë të përgjithësuar. Adil Salahi ka komentuar disavantazhet e mosmartesës: “Disa njerëz e çojnë jetën e tyre pa u martuar asnjëherë. A janë më pak myslimanë? Sigurisht që jo. Mirëpo, ata janë të disavantazh, pasi që ata nuk e kanë ndihmën që ofron një grua e mirë. Ata nuk kanë mundësi që përmes martesës të përfitojnë më shumë bekim nga Zoti. Për shembull, ju kur kujdeseni mirë për gruan dhe për fëmijët tuaj, punoni fuqishëm si t`u siguronit atyre jetë dhe edukim të mirë; me këtë ju shpërbleheni nga Zoti. Nëse jeni të pamartuar, e humbisni këtë

mundësi. Nëse gruaja ose burri juaj është i sëmurë dhe ju kujdeseni për ta deri në shërim, ju keni shpërblim. Nëse ju kujdeseni që fëmijët tuaj të bëhen myslimanë të mirë, duke mbjellë në mendjet e tyre vlerat e Islamit, duke u bërë të dobi-shëm për shoqërinë islame, ju jeni duke e kryer detyrën për të cilën Zoti shpërblen.”<sup>vii</sup>

Dijetari bashkëkohor egjiptian Jusuf el Kardavi është kategorik me mendimin se ndalohet ideja e mosmartesës, me arsyetimin e përkushtimit ndaj Zotit dhe asketizmit. Sipas tij, koncepti i mosmartesës është devijim i parimeve islame dhe refuzim i Sunnetit të Pejgamberit (alejhi-s-elam). Mendimet për mosmartesë janë koncepte të krishtera, të mbjella në ambientin islam, konkludon Kardavi. Kardavi e ka bërë të qartë se në Islam ndalohet asketizmi: “Islami nuk lejon lidhje gjinore të pakufizuara dhe për këtë ndalon kurvërinë dhe çdo gjë që shpie në të. Mirëpo, në anën tjetër, e lejon të kundërtën, përkatësisht thërret në martesë, ndalon heqjen dorë prej saj, si dhe treshjen. Nuk i lejohet myslimanit të aftë për martesë ta refuzojë aktin e tillë, me pretekst se i përkushtohet vetëm Zotit, adhurimit të Tij dhe asketizmit e largimit nga kjo botë. Pejgamberi (alejhi-s-elam) e kuptoi që disa nga shokët e tij kishin prirje drejt asketizmit, prandaj ai u tha se ky është devijim prej parimeve islame dhe refuzim i Sunnetit të Pejgamberit (sal-lallahu alejhi vese-l-em). Në këtë mënyrë ai i eliminoi mendimet e tilla të krishtera prej ambientit islam.”<sup>viii</sup>

#### DUVNJAK: “MOSMARTESA ËSHTË MËKAT”

Shkrimtari dhe mendimtari bashkëkohor boshnjak Muamer Duvnjak përmend dy arsye se pse njeriut i ndalohet që të heqë dorë prej martesës, si dhe pse ndalohet kastrimi ose treshja. Arsyeja e parë të cilën e përmend Duvnjak është koncepti i dëmit. Është e dëmshme për njeriun që të heqë dorë nga martesë, edhe nga aspekti biologjik dhe sociologjik nëse e trajtojmë këtë temë. Arsyeja e dytë ka të bëjë me fenë. Allahu (xh. sh.) njeriut ia ka dhënë dëshirën dhe vullnetin për martesë, për gjininë e kundërt, nëse njeriu që ka mundësi për t’u martuar nuk e bën këtë, është duke bërë mëkat, konkludon Duvnjak. Duvnjak thotë: “Islami na ka ndaluar dhe na ka penguar që të heqim dorë nga martesë. Kjo në Islam quhet *te-bettul*-celibat, që d.m.th. që njeriu të vendos që të mos martohet dhe vajza të mos shkojë nuse. Njeriut i ndalohet që të

kryejë kastrimin ose treshjen, me qëllim që të largohet nga martesë. Arsyeja e ndalesës lidhet me atë se është e dëmshme për njeriun, ndërsa tjetra se është në kundërshtim me fenë tonë. Përderisa Allahu (xh. sh.), që na ka krijuar neve, e di më mirë për ne dhe dëshirat tona, dhe na ka krijuar ashtu si jemi, pse të ndryshojmë. Pastaj, Allahu (xh. sh.) njeriut ia ka dhënë dëshirën dhe vullnetin për martesë, për gjininë e kundërt dhe nëse njeriu ka mundësi që të martohet dhe këtë gjë nuk e bën, është duke bërë mëkat, ndërsa nëse e ndryshon natyrën të cilën veçse e ka si njeri i shëndoshë përmes kastrimit, ajo është ende më e rëndë.”<sup>ix</sup>

Dijetari i madh i shekujve të arta të Islamit, Ebu Hamid el Gazali, e trajton gjerësisht problematikën e martesës dhe të mosmartesës në Islam. Ai këtë problem e sheh nga të gjitha anët dhe lirisht mund të konkludojmë se është njëri ndër dijetarët e paktë myslimanë që këtë temë e ka trajtuar aq thellësisht. Kur flet për dobitë e martesës, nënkupton ikjen prej idesë së mosmartesës.

Ne kemi nënvizuar vetëm dobinë e parë të martesës, ku sipas Gazalit hyjnë pasardhësit. Gazali pasardhësit i përmend si themelin e idesë dhe të logjikës për t’u martuar. Nuk shtohet njerëzimi e as myslimanët duke e zbatuar parimin e mosmartesës. Por, vetëm përmes logjikës së martesës dhe institucionalizimit të saj njeriu ka mundësi që të shtohet dhe të sigurojë vazhdimësinë e ekzistencës, si dhe të thirrjes në të vërtetën. Ebu Hamid el Gazali gjerësisht i ka trajtuar dobitë e martesës, si dhe ka qortuar për mosmartesë, duke përmendur burime të ndryshme dhe arsyetimet e tyre për mosmartesë: “Dobia e parë janë pasardhësit dhe ky është themeli. Kjo është arsyeja pse është themeluar martesë, e qëllimi është vazhdimësia e brezave të rinj, që toka të mos mbetet pa llojin njerëzor. Epshi është krijuar për ta siguruar këtë. Ky epsh, me qëllim që të sigurohen pasardhës, është si kujdestar i atij që nxjerr farën dhe asaj që e pranon, ose si gjuetari i cili përhap drithërat që i pëlqejnë zogut përreth kurthit, për ta zënë atë. Fuqia që nuk ka fillim mund të krijojë pa martesë dhe pa shkak, por Ai ka lidhur gjithçka për ndonjë sebeb (shkak) për të shfaqur Urtësinë Hyjnore, për të treguar mrekullitë dhe për të realizuar arsyet e jetesës.”<sup>x</sup>

#### PËRFUNDIM

Gjatë vendosjes së parimeve të këtij hulumtimi e kemi pasur parasysh se të

gjitha gjërat nuk janë thënë në të kaluarën, por as në këtë punim nuk kemi pasur mundësi që t’i themi. Martesa dhe mosmartesa, si dy binome të ndryshme nga njëra-tjetra, kanë një esencë të përbashkët e që është rehatia. Rehatia është pika ku martesë dhe mosmartesa gjejnë prehjen dhe qetësinë. Forma se si ne iu qasëm këtij punimi, ka të bëjë me segmentimin e këtyre problemeve në aspektin e interpretimeve shkencore, fetare dhe shoqërore. Të gjitha elementet bazë të martesës kanë ndikuar në krijimin e ideve dhe mendimeve përmes të cilave ne u jemi qasur këtyre problematikave.

Nga literatura e pasur, e konsultuar për nevojat e këtij hulumtimi, kemi kuptuar për rëndësinë që i jep feja konceptit të martesës. Gjenden ajete të shumta në Kuran, si dhe hadithe të panumërta që flasin për rëndësinë e martesës. Martesa është institucioni i cili kërkohet me ngulm për t’u zbatuar nga të rinjtë dhe të rejat myslimane. Në të kaluarën, por edhe sot ky institucion është keqpërdorur dhe po keqpërdoret nga interpretime të caktuara që lidhen me doket dhe traditat jashtëfetare.

Sa i përket martesës të të tjerët, jemi munduar që qasjen ta kemi në mënyrë objektive, duke mos anuar aspak nga segmente dhe tendenca të cilat flasin për nxitje për devijime të shumta. Për shembull, e kemi parasysh se murgjësia është pjesë e rëndësishme të të krishterët, por ne nuk kemi dashur që të përfshihemi aspak në atë temë.

Gjatë hulumtimit dhe shtjellimit të literaturës së pasur islame kemi kuptuar se dijetarët myslimanë edhe pse kanë mendime të ndryshme rreth konceptit të martesës, ata i bashkon njëzëri mendimi për mosmartesën. Përjashtimet janë të logjikshme, duke pasur parasysh natyrën e fesë islame, që është gjithëpërfshirëse, e cila në vetvete ngërthen edhe tema të tilla sikur treshja.

Gjatë shtjellimit të këtij punimi kemi pasur disa dilema personale në lidhje me temën e treshjes, dilema këto të cilat janë qartësuar nga ana e konsultimit tonë me mendimtarë dhe hoxhallarë të caktuar. Edhe pse ekziston si koncept treshja, ajo në literaturën islame trajtohet si përjashtim, ose si rast i veçantë. Me të nuk ndërtohen parime dhe baza, dhe mbi atë argument nuk mund të themi se Islami si fe e ka liru identitetin e mosmartesës për t’u favorizuar në plleshmërinë e shoqërisë.

Është e vërtetë se në të kaluarën ka pasur dijetarë dhe mendimtarë myslimanë të cilët gjatë jetës së tyre nuk

kanë pasur mundësi të martohen. Ky fakt nuk i mohon hadithet e shumta dhe argumentet fetare të nxjerra edhe nga Kurani për rëndësinë e martesës. Edhe pse, për shembull, Shejhul Islam Ibn Tejmije asnjëherë nuk ka qenë i martuar, ai gjatë veprimtarisë së tij shkencore ka nxitur të rinjtë dhe të rejat në martesë. Ai ka qenë kundër që të rinjtë dhe të rejat të mos martohen me arsyetimin se do t’i përkushtohen më mirë Zotit dhe duke e marrë shembull atë.

Shembuj të këtillë gjatë historisë islame kemi shumë. Por, shembulli më i mirë për të gjithë myslimanët e të gjitha kohërave deri në Ditën e Llogarisë është i Dashuri i Zotit, Muhamed Mustafaja (alejhi-s-elam).

Gjatë ndërtimit të këtij punimi kemi parë dhe nënvizuar mesazhe të Muhamedit (alejhi-s-elam) drejtuar të rinjve dhe të rejave që të martohen. Ata që nuk martohen, nuk e ndjekin rrugën e pejgamberit Muhamed (alejhi-s-elam). Ata vetë përjashtohen prej një identiteti fisnik, i cili mban gjallë shpirtin dhe mendjen e myslimanit. Tema e mosmartesës duhet trajtuar edhe më shumë në studimet e ardhshme, sepse vlerësoj se në literaturën islame në gjuhën shqipe është shkruar pak në lidhje me këtë temë.

#### LITERATURA E KONSULTUAR:

- Ahmeti**, Sherif, *Kur’ani*, përktheu dhe komentoi në gjuhën shqipe, Medine.
- Asad**, Muhamed, *Mesazhi i Kur’anit*, Logos-A, Shkup, 2016.
- Bajiq**, Esad, **Basarik**, Ertan, *Bračni zivot*, Fondacija “Lijepa riječ”, Konjic, 2013.
- Buti**, Ramadan, *Fetva bashkëkohore dhe konsultime*, ASR, Tetovë, 2008.
- Buchholz**, O., “*Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*” (*Wörterbuch der albanischen Gegenwartssprache*), Tiranë, 1980. *Sprachtypologie und Universalienforschung*, 34(6), 1981. pp.756-758.
- Duvnjak**, Muamer, *Allahove zabrane*, Zenica, 2004.
- DaDon**, Kotel, *Role of the Wife in the Jewish Marriage in Old Testament Scripture, in Jewish Law, and in Rabbinic Literature*, *Evangelical Journal of Theology*, 12(2), Kairos 2018, pp.129-158.
- Ebibi**, Faredin, **Bislimi**, Taxhedin, **Zimeri**, Jusuf, **Abazi**, Irfan, *E drejta familjare në Islam*, Shkup, 2004.
- Ebibi**, Faradin, *Terminologjia e shkencës së hadithit*, Fakulteti i Shkencave Islame, Shkup, 2015.

*Enciklopedija hadisa 5*, Sarajevë, 2012.

**Fantetti**, F., *Diritto di famiglia e diritti dei familiari*, 8 ed., Maggioli, Rimini, 2011.

**Gormez**, Mehmet, *Metodologjia hermeneutike e hadithit dhe sunnetit*, Logos-A, Shkup, 2014.

**El Gazali**, Muhamed, *Komenti tematik i Kur’anit famëllartë*, Logos-A, Shkup, 2007.

**Imam Zekijud-din**, El-Mundhiri, *Sahihul Muslim vëllimi II version i shkurtuar*, Sira, Prishtinë, 2009.

**Imam Neveviu**, *Rijadus-Salihin*, vëllimi I, Libraria Nun, Shkup, 2018.

**Imam Gazali**, *Rregullat e jetës martesore*, Prishtinë, 2015.

**Ibn Kajjim el Xhevi**, *Fetvatë e të dërguarit të Allahut*, Dëshmia, Shkup, 2006.

**Kardavi**, Jusuf, *Fetva bashkëkohore*, vëllimi I, Furkan Ism, Shkup, 2003.

**Kardavi**, Jusuf, *Hallalli dhe Harami në Islam*, Furkan ISM, Shkup, 2002.

**E.W.G., Masterman**, *Jewish Customs of Birth, Marriage, and Death*, *The Biblical World*, 22(4),1903, pp.248-257.

**W.**, Rordorf, *Marriage in the New Testament and in the Early Church*, *The Journal of Ecclesiastical History*, 20(2), 1969, pp.193-210.

**Sabik**, Sejdi, *Fikhus-sunneh*, vëllimi II, Instituti Shqiptar i Mendimit dhe Qytetërimit Islam, Tiranë, 2007.

**Imam Tirmidhi**, *Sunneni i Tirmidhiut*, vëllimi IV, Alma, Shkup, 2008.

**Ibni Maxheh**, *Sunneni i Ibni Maxheh, përkthim dhe komentim në gjuhën shqipe*, vëllimi IV, botim privat, Shkup, 2020.

**S. I.**, Sham, *Some Aspects of Marriage and Divorce in Muslim Family Law*, 2011.

**Ibn Kethiri**, *Tefsiri i Ibn Kethirit*, vëllimi VI, Fondacioni i Rinisë Islame, Zurich, 2010.

**Topaloglu**, Bekir, *Gruaja në Islam*, libri mund të shkarkohet në: <http://www.qiksh.no/shkarko/>

**Es-Sibai**, Mustafa, Dar al Warrak, libri mund të shkarkohet në: <https://www.ilimkapi.com/urun/es-sunne-ve-mekanetuha-fit-tesriil-islami-1cilt-lsn-wmknth-fy-ltshry-Islmy-1>

#### BURIME NGA INTERNETI:

*What happens at a Muslim Wedding: A Muslim Perspective*, Aliya Khan ([https://oakvillnews.org/opinion/what-happens-at-a-muslim-wedding-a-](https://oakvillnews.org/opinion/what-happens-at-a-muslim-wedding-a-muslim-perspective/)

[muslim-perspective/](https://oakvillnews.org/opinion/what-happens-at-a-muslim-wedding-a-muslim-perspective/), më datë: 10.06.2013.)

*Martesa, fejesa, paja, miqësia, gruaja, burri, të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga “Kanuni i Lekë Dukagjinit”* (publikuar në <https://zanimalsise.com/martesa-fejesa-paja-miqesia-gruaja-burri-te-drejtat-dhe-detyrimet-qe-rrjedhin-nga-kanuni-i-leke-dukagjinit/>, më datë: 16.06.2017)

<http://njohligjin.al/familja/bashkejetesa/>

*Staying Single*, Adil Salahi (publikuar më datë: 9.10.2009 në : <https://www.arabnews.com/node/328796>

*The ruling on castration*, *General Supervisor Shaikh Muhammad Saalih al Munajjid* (publikuar më datë: 13.02.2015. në : <https://islamqa.info/en/answers/126987/the-ruling-on-castration>)

, *General Supervisor Shaikh Muhammad Saalih al Munajjid* (publikuar më datë: 1.05.2006 në : [https://islamqa.info/amp/ar/answers/82968?fbclid=IwAR3wB2-eb7Pw5\\_srOi-puUY4nQI3HVRvhNi\\_TmbfLcTM9BnZfpGRZIWMClxk](https://islamqa.info/amp/ar/answers/82968?fbclid=IwAR3wB2-eb7Pw5_srOi-puUY4nQI3HVRvhNi_TmbfLcTM9BnZfpGRZIWMClxk))

#### TË TJERA: PËRGJIGJE E DËRGUAR NGA DOC. DR. AJNI SINANI, NË FORMË ELEKTRONIKE, MË DATË 20.04.2021.

<sup>i</sup> *The ruling on castration*, *General Supervisor Shaikh Muhammad Saalih al Munajjid* (publikuar më datë: 13.02. 2015 në: <https://islamqa.info/en/answers/126987/the-ruling-on-castration>) .

<sup>ii</sup> *General Supervisor Shaikh Muhammad Saalih al Munajjid* (publikuar më datë: 1. 05. 2006 në: [https://islamqa.info/amp/ar/answers/82968?fbclid=IwAR3wB2-eb7Pw5\\_srOi-puUY4nQI3HVRvhNi\\_TmbfLcTM9BnZfpGRZIWMClxk](https://islamqa.info/amp/ar/answers/82968?fbclid=IwAR3wB2-eb7Pw5_srOi-puUY4nQI3HVRvhNi_TmbfLcTM9BnZfpGRZIWMClxk)).

<sup>iii</sup> Bekir Topaloglu, *Gruaja në Islam*, fq.37 (libri mund të shkarkohet në <http://www.qiksh.no/shkarko/>).

<sup>iv</sup> Tirmidhiu, *Suneni i Tirmidhiut me përkthim dhe koment në gjuhën shqipe*, vëllimi IV, Alma, Shkup, 2008, fq. 23.

<sup>v</sup> Po aty, fq. 25.

<sup>vi</sup> Tirmidhiu, *Suneni i Tirmidhiut me përkthim dhe koment në gjuhën shqipe*, vëllimi IV, Alma, Shkup, 2008, fq. 25-26.

<sup>vii</sup> *Staying Single*, Adil Salahi (publikuar më datë: 9.10.2009. në : <https://www.arabnews.com/node/328796>).

<sup>viii</sup> Jusuf Kardavi, *Hallalli dhe Harami në Islam*, Furkan ISM, Shkup, 2002, fq. 153.

<sup>ix</sup> Duvnjak Muamer, *Allahove zabrane*, Zenica, 2004, fq. 85-86.

<sup>x</sup> Imam Gazali, *Rregullat e jetës martesore*, Prishtinë, 2015, fq. 19.



# ZEJDI, DITURIA SI ESENCË



**Po të mos ishte Zoti, nuk do të ishte as njohja për gjendjen. Kuptohet, njohja e gjendjes njihet së bashku me esencën. Forma e thjeshtuar e këtij argumenti do të ishte si vijon: kur themi se Zoti është i Dijshëm, në vetë nocionin i Dijshëm vërejmë subjektin ose Zotin, të cilin e dallojmë nga dija; ose po të mos ishte ky subjekt që përshkruhet, ne nuk do të kishim as përshkrimin ose gjendjen. Këtu dituria është rezultat i përshkrimit tonë të Zotit, për të Cilin në Shpallje thuhet se është i Dijshëm.**

**Shkruan: Hasan Xhillo  
(Enkas për Her)**

Duke zhvilluar këtë mësim për cilësitë dhe moduset, për të cilat duhet të sillen argumente të vlef-

shme, Ali ibn Xhubai përcakton kategorinë “diçka” (gjë/shej’un), si ajo që mbulon të gjitha entitetet: për çdo gjë mund të thuhet se është diçka (Esh’ariu 1929: 518). Madje edhe Ebu Hanifeja konsideron se “Zoti është një gjë/entitet, por jo si

gjërat e tjera”. Prandaj, kategoria “gjësend” është koncepti më universal, sepse për çdo gjë mund të thuhet se është “diçka”, madje edhe për atë që nuk ekziston, dhe në këtë mënyrë, për shembull, zbatohet edhe në entitet që ekziston vet-



vetiu, ka të bëjë edhe me atë që ekziston për ndonjë arsye, thuhet edhe për atë që ndodhet në realitetin mendor, përmendet edhe në lidhje me atë që është në realitetin e jashtëm; me këtë karakterizohet edhe ajo që është e përkohshme, që i përket edhe asaj potenciales, të njohurës, të panjohurës etj. Gjëja ose entiteti (shej’un), thjesht, përfaqëson të gjithë atë për të cilin mund të thuhet se është; ose, qenie dhe gjësend janë një dhe e njëjta gjë, sepse për këtë, thjesht, flet (al-muhaber anhu), ajo që përshkruhet (mevsuf) dhe për atë asgjë tjetër nuk mund të thuhet vetvetiu (po aty: 161). Nga kjo qartë rrjedh konstatimi vijues: Xhubai është i mendimit se vetëm “emrat shënojnë entitete - ose më saktë thënë - emrat janë ato që mund të jenë lëndë propozimi” (po aty). Analiza subtile e disa nocioneve që ndërmer Xhubai - e ka të bëjë me cilësitë e Zotit - tregon se kjo ka të bëjë me nxjerrjen e këtyre emrave në bazë të veprimeve ose krijesave që i perceptojmë në realitetin e jashtëm dhe nëse ato emrat e njëjtë i analizojmë në kontekstin e fjalëve të cilat, mes tjerash, kanë të bëjnë me esencën e Zotit. Xhubai nuk e pranon teorinë e Muamerit në lidhje me moduset, ose teorinë e të birit të tij, Ebu Hashimit, për gjendjet (ahval), që janë zëvendësime të nocioneve të cilësive.

Xhubai cilësitë e Zotit nuk i quan moduse, por i klasifikon ato në emra (esma), emra dhe mbiemra - i karakterizon ato sipas kategorive të mendimit një-rëzor (Franku 1982: 261). Duke iu përgjigjur kësaj sfide, Xhubai ripërcakton, thotë Franku, pothuajse të gjithë mësimin mbi cilësitë hyjnore të ithtarëve të tjerë të shkollës mu’tezilite. Kjo nuk mund të bëhet nëse së pari nuk fillojmë nga përcaktimi i formulimit fillestar “vetvetiu” (li nefsihi), që ka të bëjë me esencën. Formulimi “vetvetiu” nënkupton kur diçka kuptohet ashtu siç është ajo, kurse për këtë tregojnë karakteristikat e saj, që do të thotë se për të asgjë tjetër nuk mund të thuhet se është nga ajo që, në fakt, është. Kur themi “vetvetiu”, kjo nënkupton se mohojmë të gjithë atë që ka të bëjë me esencën, e me këtë, në mënyrë adekuate, mohojmë edhe cilësitë ose moduset e Zotit; në realitet, cilësitë e Zotit në i sjellim në lidhje me esencën e Zotit “në drejtim të esencës së Tij” - thuhet në formulimin i cili te disa mu’tezilitë vazhdimisht konfirmohet. Pra, formulimi “vetvetiu” ka kuptim të dyfishtë: afirmimin i esencës së gjërave të përcaktuara dhe negacionin e çdo gjëje që nuk ndodh vetvetiu, dhe i përket vetë asaj gjëje që përcaktohet, e cila shtohet

si cilësi ose si karakteristikë (po aty).

## EKZISTENCA E ZOTIT ËSHTË VETVETIU

Xhubai, kur flet për qeniet, ka parasysh polarizimin vijues: Zoti si Qenie e përjetshme dhe ajo që është kontingjente (qoftë në mendje ose në realitet). Ekzistenca e Zotit është vetvetiu, e ajo kontingjente është jo-qenie; mund të jetë dhe të mos jetë, të jetë objekt i fuqisë së Zotit dhe, si e tillë, është reale përderisa është objekt i kësaj fuqie (ma’dum makdurun alejhi). Kontingjentiteti e përcjellë atë në botën reale, kur është qenie e ndarë, dhe ajo që nuk mund të lirohet nga kontingjentiteti i vet. Kontingjent mund të jetë edhe gjëja reale, e cila ka arsye që të bëhet reale, pavarësisht se arsye e kësaj është Zoti, ose arsye e kësaj është njeriu (po aty). Megjithatë, duhet të sillim një nocion i cili në mënyrë më të drejtpërdrejtë do të shprehte përsosurinë e Zotit, e kjo bëhet nëse në lidhje me të zbatojmë cilësinë “i përjetshëm” (kadim). Xhubai nuk pajtohet me Muamerin se ky emër tregon diçka nga bota e eksperiencës, por pretendon se me këtë emër në mënyrë më të përshtatshme shënojmë esencën e Zotit, sepse kur themi përjetësi, atëherë menjëherë na vjen në mendje se kjo është diçka që nuk ka as fillim as mbarim, kështu që me asnjë kategori tjetër nuk mund ta karakterizojmë esencën e Zotit, siç mund atë ta bëjmë me këtë kategori, ndërsa asnjë prej emrave tjerë të Zotit nuk e ka atë kuptim që mund t’i përshkruhet Zoti (po aty: 516). Analiza gramatikore dhe gjuhësore e këtij nocioni tregon se karakteristikat e tjera të Zotit, siç janë: jeta, fuqia dhe dituria, për të cilat më së shumti flitet, nuk e kanë atë fuqi për të shprehur përsosurinë e Zotit. Kur themi përjetësi (kidem), argumenton Xhubai, sjellim një përshkrim të vetëm (specifik) të Krijuesit. Ajo që është e përjetshme, thotë Xhubai, nuk u nënshtrohet ndryshimeve ose kalimit nga një gjendje në tjetrën (po aty: 517). Vullneti i Zotit, sipas mendimit të Xhubait dhe të disa teologëve të tjerë, u krijua, nuk është i përjetshëm në kuptimin që të jetë subsistente e esencës së Zotit, sepse në këtë rast vullneti do të prezantonte “substratin e gjërave kalimtare”, të ketë diçka që bën nuk e di. Nëse themi se “esenca e Zotit është dituria”, ose “dituria është esenca e Zotit”, ose se “esenca e Zejdut është dituria”, sipas analizave gramatikore të Xhubait, atëherë kjo do të thotë se asgjë nuk tre-

gojmë, sepse përsosuria ose cilësia e ekzistimit të diturisë, e iniciuar me nocionin alim (dijetar), nuk është entitet dhe në këtë mënyrë nuk mund të jetë lëndë parashtrimi, sepse në mënyrë implicite tregon diçka, diturinë dhe atë që di (Franku 1982: 261-261).

Prandaj, ai thotë se struktura gramatikore konsiderohet e vlefshme me konfirmimin e nocionit të diturisë, se ajo me të vërtetë tregon esencën e Zotit, dhe do të themi, për shembull, All-llahu ennehu alimun (Zoti është me të vërtetë i dijshtëm), gjë që tregon kuptimin e esencës së Zotit, duke i shtuar fjalët ennehu (me të vërtetë Ai). Të kesh dituri - në rastin kur bëhet fjalë për Zotin dhe Zejdin - tregon njëkuptimësi dhe në këtë mënyrë nuk mund të vëmë vijnë e ndarjes dhe diferencimit mes këtyre dy entiteteve. Mund të flitet vetëm për gjëra konkrete (eshjaun) dhe esencat e tyre, reale dhe të mundshme, për “esencat” në Zot dhe për esencat e trupave ose atomeve të kombinuara. Madje, nëse cilësinë e zbatojmë ndaj Zejdut, atëherë ajo cilësi nuk është vetë Zejdi - pra dituria si esencë - por nënkuptojmë se dituria është akt i cili gjendet te Zejdi dhe kështu arrijmë në propozimin (hukm) se dituria është diçka tjetër nga entiteti: kemi edhe diturinë, edhe Zejdin. Për gjykimin e përkryer mund të flasim për diçka që është fillikat vetëm. Prandaj, vjen në përfundim Riçard Franku, se vetëm gjësendet/entitetet mund të jenë objekt atribuimi, pavarësisht se bëhet fjalë për ekzistentët ose joekzistentët (e mundshëm), ekzistues, të krijuar ose temporalë (po aty). Për këtë arsye, Xhubai nuk flet për ekzistimin ose ekzistencën, por për konfirmimin (thubut) e ekzistimit real të diçkaje. Të thuhet ennehu, do të thotë të konstatohet kjo ekzistencë. Më vonë filozofët islamë atë enne e substancuan në ennijja (qenie ose qenësi), në fakt, në atë “është”. Të themi edhe këtë: Të konfirmohet diçka, do të thotë, sipas logjikës së tij, të tregohet realiteti i tij, po edhe nëse bëhet fjalë për analizën e vetë termave ose emrave të Zotit që burojnë nga faktet e krijesave të Tij në realitetin objektiv. Për asgjë nuk mund të themi se është e vërtetë nëse nuk e konfirmojmë se është e vërtetë në kuptimin e esencës së saj. Megjithatë, “të vërtetat në botën e eksperiencës dallojnë nga të vërtetat në botën transcendentale”, ose me metodën e “analogjisë flasim për botën e fshehtësisë bazuar në botën e dukshmërisë” (bi kijas al-gaibi ala ash-shahida), ku flasim jo vetëm për Zotin, por edhe për



botën. Shembulli që e sollëm për Zotin dhe **Zejdin**, sa i përket diturisë, nuk flet për njëkuptimësi, duke pasur parasysh se një entitet i përket botës eksperimentale, e tjetri botës mbi-eksperimentale. Meqenëse **Zejdi** është qenie trupore ose eksperimentale, dituria është cilësi e **Zejdin**, ajo që i takon atij, ndërsa dituria në Zotin - pasi që Zoti nuk është qenie ose entitet trupor - nuk mund të konfirmohet se i përket Zotit, por ajo nënkuptohet si esencë e Tij. Në rastin e parë, i bën rezyme Richard Franku, dituria është modus, kurse në rastin e dytë, dituria është vetëm cilësi. Për këtë shkak Xhubai i kthehet mendimit të Allafit se njohuria është identike me esencën e

Zotit, nëse sjellim deklaratën, potencon argumentin, se dituria është modus i Zotit, atëherë duhet të shtojmë edhe deklaratën vijuese: dituria është akt i cili i përket Zotit si diçka e shtuar esencës së Tij, e jo se edhe ajo është esenca e Tij. Numri i pakufizuar i moduseve ose gjendjeve të shpie në mënyrë të domosdoshme në regresion ose pafundësi (*ad infinitum*). Prandaj, cilësitë e Zotit, sipas Xhubait, janë ndodhi, nuk kanë ekzistencë dhe substrat të përjetshëm, ato si të tilla, janë esenciale, në Zot. Deklarata se substancat nuk kanë substrat është pikëpamje e afërt me mendimin e filozofëve të cilët flasin për intelektin si substancë e cila nuk ka vend ose sub-

strat, siç janë, për shembull, shpirti universal, inteligjibilitet e ndara etj.” (Shehrestani 1994: 57)

#### NJË REALITET PËR ABSOLUTIN

Abu Hashim Xhubai vazhdon edhe më tej të sjellë argumente në funksion të përmirësimit të argumentimit të cilin e filloi babai i tij me disa dallime, përkatësisht, me analizimin e termave dhe nocioneve. Duhet të ekzistojë vetëm një realitet kur është fjala për Zotin. Ajo që i përshkruhet nga jashtë, nuk mund të ketë unitet thelbësor me atë që përshkruhet. Fuqia e arsyes është e atillë që mund

ta vërejtë këtë. Në mbarim të argumentimit të tyre, ithtarët e Ebu Hashimit përfundojnë me mendimin mbi esencën e Zotit e cila nuk ka cilësi ose moduse të brendshme dhe të jashtme të këtyre cilësive, në kundërshtim me mendimin e teologëve të krishterë dhe përfaqësuesve të cilësive të Zotit ose atributistëve në Islam. Megjithatë, për të veçuar qëndrimin e tyre nga qëndrimi i teologëve të krishterë, atributistët në Islam pretendonin se “cilësitë edhe janë diçka ndryshe nga Zoti, edhe nuk janë diçka ndryshe nga Zoti”. Këtu, megjithatë, bëhet fjalë për një antonimi të cilën duhet ndriçuar dhe në këtë mënyrë duhet zgjidhur enigmën. Prandaj, për të thelluar mësimin mbi cilësitë e Zotit, Ebu Hashimi nuk flet për cilësitë dhe moduset, por për gjendjet (*ahval*). Cilësinë e substancës e karakterizon me gjendjen dhe duke analizuar këtë nocion, ai vjen në përfundim se cilësia të cilën e quan gjendje ka status ontologjik, e nuk është vetëm një çështje e analizës gramatikore siç e mendon këtë babai i tij Xhubai; as që është kjo esenca e Zotit, siç pretendonin Allafi dhe disa të tjerë. Ky status ontologjik mund të shihet në definicionin e tij se “gjendja në mënyrën në të cilën përshkruhet objekti është një gjendje e kualifikuar në mënyrë specifike, dhe kështu dikush mund të thotë *ala sifatin* (në bazë të cilësisë), duke nënkuptuar atë që sipas së cilës, në fakt, dallohet nga diçka tjetër”. (Shih: Dgheimi 1998: 40–41) Ai konsideron se gjendja nuk është entitet ose gjësend. Gjendja realizohet ose e fiton aktualitetin e saj, ose statusin ontologjik, si rezultat ose si shprehje e asaj që është objekti i atij përshkrimi. Në këtë rast, në bazë të esencës së Zotit, ne arrijmë të njohim gjendjet. Statusi ontologjik i gjendjeve, që është i realtë, konsiston në supozimin se kjo botë, sipas Ebu Hashimit, është përplot me gjendje të cilat vazhdimisht ndryshojnë, por esencat janë statike, pushojnë në vetvete dhe për këtë shkak janë të panjohura. Ne mund të fitojmë njohuri për to vetëm në bazë të relacionit të tyre me substancën. Vetë relacioni ose komunikimi supozon pandashmërinë e tyre nga substanca, sepse në të kundërtën arrijmë në përfundimin se gjendjet ekzistojnë në mënyrë të pavarur nga objekti i tyre me të cilin janë të lidhur.

Duke zbatuar për Zotin nocionet esencë dhe gjendje, Ebu Hashimi thotë se “Zoti është i dijshtë sipas esencës së Tij në kuptimin që Ai posedon gjendje, e kjo është një cilësi thelbësore e njohur, e cila ekziston krahas qenies së Tij” (Shehrestani 1994: 58). Gjendja nuk mund të njihet në bazë të vetë gjendjes, por në bazë të esencës. As esenca nuk mund të njihet në bazë të gjendjes. “Esenca njihet”, thotë Ebu Hashimi, “si diçka individuale, e gjendja nuk mund të njihet në mënyrë të pavarur nga esenca” (Tusi 1985: 11, 252). Intelekti posedon fuqi specifike për të daluar atë që është absolute dhe atë që nuk është absolute. Prandaj, kemi njohuri për esencën dhe njohuri për njohësin si esencë. Koncepti për esencën dhe njohja e gjendjes dallojnë. Intelekti percepton në vetvete se ajo çka merr pjesë ose kombinohet është e pabarabartë me atë sipas së cilës ajo dallon. Nga kjo rrjedh konkluzioni vijues: po të mos ishte Zoti, nuk do të ishte as njohja për gjendjen. Kuptohet, njohja e gjendjes njihet së bashku me esencën. Forma e thjeshtuar e këtij argumenti do të ishte si vijon: kur themi se Zoti është i Dijshtëm, në vetë nocionin i *Dijshtëm* vërejmë subjektin ose Zotin, të cilin e dallojmë nga dija; ose po të mos ishte ky subjekt që përshkruhet, ne nuk do të kishim as përshkrimin ose gjendjen. Këtu dituria është rezultat i përshkrimit tonë të Zotit, për të Cilin në Shpallje thuhet se është i Dijshtëm. Është e qartë se bëhet fjalë për dëshminë ontologjike kur lëviz nga Zoti drejt gjësë së krijuar, e jo anasjelltas. Këtë qëndrim më vonë e përkrahu edhe Fahrudin Raziu, i cili e shpjegoi dëshminë që e mbështetnin edhe disa filozofë islamë, siç ishte Ibn Sina, se “Zoti është dëshmitar i çdo gjëje që ekziston”, gjë që paraqet edhe formulën kuranore.

#### “SKANDAL I PËRJETSHËM NË FILOZOFI”

Për këtë arsye, gjendjet, sipas këtij teologu, nuk hyjnë në sferën e qenësisë dhe të joqenësisë në realitetin e jashtëm (Bagdadi b.d.: 195). Gjendjet nuk janë diçka e njohur ose e panjohur në realitetin mendor, e megjithatë, as që janë diçka e përhershme dhe e krijuar, por, Madkuri thotë se ato përfaqësojnë diçka e cila, megjithatë, në një farë mënyre, është e lidhur me esencën. Bëhet fjalë për abstraksionet në mendje që janë në lidhje me esencën dhe në bazë të përshkrimit të vetë esencës. Njeriu është në gjendje që ato t’i arrijë me mendje dhe për këtë arsye Ebu Hashimi flet për gjendjet (cilësitë) që nuk kanë ekzistencë të përjashtme (jashtë mendjes). Përderisa ato njihen me anë të mendjes, atëherë ato janë terma ose nocione të përgjithshme (universale). Njeriu ka mundësi të mendojë rreth këtyre universaleve si të tilla. Këtë e përfaqësonin edhe filozofët peri-

patetikë El-Farabiu dhe Ibn Sina, si dhe platonisti i madh në Andaluzi, Ibn Baxhe. Këto mësimë i përkrahu edhe teologu esh’arit Bakilaniu. Në filozofinë evropiane, argumentet e tij i paraqiti edhe Berkli, duke thënë se çdo gjë që ne perceptojmë, atë e bëjmë në frymën tonë dhe nuk mund të argumentojmë qenësinë e gjërave në kuptimin ontologjik, të pavarur nga perceptimet tona. Ky argument është një skandal i përjetshëm në filozofi, thotë Kanti, dhe askush nuk arriti ta kundërshtojë atë (Muhiq 1997: 135). Sipas tij, nuk ekzistonte asnjë mënyrë tjetër, sipas së cilës do të mohohet koncepti materialist ose natyralist.

Ebu Hashimi nuk flet për unitetin e brendshëm të gjendjes në Zotin dhe për simplicitetin e Qenies së Zotit, siç pretendonin paraardhësit e tij. Ai kalon në argumentimin e katër gjendjeve (cilësive) që dominojnë në diskursin teologjik (dituria, fuqia, jeta dhe ekzistenca), të cilat shkakun e qenësisë së tyre e kanë në gjendjen e pestë, e me këtë supozohet se ato janë të shkaktuara, se nuk janë të përjetshme Ky shkak është ai me çka Zoti dallon nga gjendjet e Tij. Disa këtë gjendje të pestë e quajnë hyjnore (*ulu-hijja*) (Wolfsoni 1974: 174). Sjellja e konceptit “gjendja e pestë”, e cila gjeneron gjendjet e tjera, paraqet risi të cilën e sjell Ebu Hashimi në teorinë mbi cilësitë e Zotit. Ai ishte teologu i parë që konsideronte se gjendjet (ose cilësitë) nuk janë subsistent të Zotit (*lavazim*), as diçka jashtë Zotit të pavarur prej Tij, qoftë si realitete mendore apo jashtëmendore, por Zoti është parimi i qenësisë së tyre (po aty).

E vërteta, sipas këtij konceptimi, në anën tjetër të kësaj bote, është e përjetshme dhe e pandryshueshme, mbi të cilën themelohet kjo botë, e cila është në ndodhje të shfaqjes dhe të zhdukjes (*kevn ve al-fesad*).

Prandaj, disa mu’tezilitë flasin për gjendjet dhe moduset e Zotit, imanenca të esencës së Tij, disa i vështrojnë ato si të nxjerra nga Zoti, jashtë Qenies së Tij, e disa, megjithatë, i konsiderojnë ato si projeksione të mendjes ose të emrave. Përmes këtyre moduseve, cilësive dhe gjendjeve, Zoti e mban botën dhe ndryshimet në të në mënyrë të tërthortë. Pra, argumentet e të gjitha këtyre qasjeve mund të na bindin në këtë. Disa gjëra do t’i kemi më të qarta nëse marrim parasysh mësimin e disa përfaqësuesve të kësaj shkolle mbi aktin e krijimit të botës dhe dukurive në të.

(Autori është profesor në Fakultetin e Shkencave Islame në Shkup)

# NË KËRKIM TË NJË ELITE SHOQËRORE

**Në jetën praktike kemi: prind-fëmijë, mjeshtër-nxënës (usta-çirak), profesor-asistent dhe në momentin kur fëmija ia tregon prindit rrugën, nxënësi mjeshtër, apo asistenti profesorit, atëherë paraqiten çrregullimet, sepse ndryshojnë pozicionet me pa të drejtë. Fatkeqësisht, ky fenomen është prezent në mesin e shoqërisë sonë: mjeshtër e jetës sonë nuk përfillen, zhvlerësohen, ofendohen, deri në atë shkallë duke ua harruar kontributin, mundin dhe sakrificën që kanë dhënë për arritjet tona të deritanishme.**

**Shkruan: Mr. Beqir Memeti  
(Enkas për HeR)**

Në hapësirën ku jetojmë ka njerëz të ditur, të aftë e të talentuar, por fatkeqësisht ka edhe nëpërkëmbje vlerash. Si duket, vlerat janë bërë antivlera, kurse antivlerat janë bërë vlera (në botëkuptimin shoqëror). Kemi ardhur në atë situatë, saqë e kemi shumë të vështirë të identifikojmë të mirën, vlerën, moralen, nga ajo që është e pamoralshme, e pavlerë dhe jo e mirë.

Të gjithë jemi dëshmitarë se hapësira ku jetojmë është ngufatur nga antivlerat,

nga parregullsitë dhe kaosi, kurse shoqëria kërkon elitën shoqërore brenda këtij kaosi. Edhe ato pak vlera që i kemi trashëguar nuk merren në konsideratë, sepse e pavlera quhet aftësi e mjeshtër, kurse vlera prapambeturi e dobësi.

Me shprehjen *elitë* kuptojmë njerëz të dalluar, të zgjedhur, por jo të zgjedhur nga të tjerët, por thënë më mirë, njerëz të zgjuar, të aftë, të dalluar prej të tjerëve me cilësi më të mira, më të bukura ose me vlera më të dobishme se të tjerët. Personat e tillë kanë influencë në shoqëri, e tërheqin vëmendjen e opinionit me sjelljen, me moralin dhe me virtutet e larta

që i kanë. Gjithmonë prezenca e tyre reflekton në mjediset apo rrethin ku veprojnë dhe jetojnë.

Historikisht është vërtetuar se tek ta gjejmë aspiratën, dëshirën, kurse ideali dhe pritjet e tyre gjithmonë na duken si me qenë tonat. Gjithashtu tek ata i kemi sytë kur kemi nevojë; por, edhe kur s'kemi nevojë, shpresat janë tek ata, pasi që ata imponohen vetë për të të ndihmuar, ata gjithmonë janë pranë shoqërisë me mendjet dhe me shpirtin e tyre, me ndjenjat e tyre na prijnë, na qetësojnë, na ngrohin, na tregojnë rrugëdaljen, pa e ditur dhe pa e ndjerë ne.

Njerëzit e tillë nuk përfaqësojnë pjesën më të vlefshme të një shoqërie, por është udhëheqës i shoqërisë për gjykim, ide, estetikë, për jetë kolektive, për besim dhe për një të ardhme më të mirë të shoqërisë.

## A KEMI NE NJË ELITË?!

Nëse bëjmë pyetje "a kemi ne një elitë", do më pëlqente përgjigjja pohuese, sepse ashtu ia do njeriut shpirti; por, duke e përtypur këtë them: duhet të kemi, sepse pa një elitë të mirëfilltë, nuk do të kemi të ardhme të sigurt - as institucionale e as shoqërore, pasi që është një prej kushteve kryesore të jetës. Atëherë, duhet të mendojmë se si do ta formojmë atë.

Kur mendojmë për formimin e kësaj kategorie shoqërore, na shkon në mend se ata njerëz nuk i formojmë ne atëherë kur duam, as që e kemi në dorë lindjen e tyre, po as që mund t'i krijojmë ne. Ata njerëz lindin me dhuntinë e Zotit, dhe ata njerëz duhet t'i meritojë rrethi (shoqëria), të cilët e shfrytëzojnë dhuntinë e Zotit. Një shoqëri e cila punon drejt, pa dredhi, një që punon drejt dhe i shfrytëzon kohën dhe rrethanat në maksimum për të shërbyer me dinjitet dhe me nder, atëherë mund të shpresojmë se Allahu i gjithëdijshëm ka mundësi t'ia ofrojë këtë kategori shoqërore.

Po në qoftë se e kemi ne si njerëz në dorë këtë dhuratë të përzgjedhjes së kësaj kategorie shoqërore, atëherë na ngelet që ta shfrytëzojmë intelegjencën (për të menduar mirë, drejt, sinqerisht dhe me përgatitje profesionale) dhe karakterin tonë, por gjithsesi se intelegjenca duhet të jetë në shërbim të karakterit.

Karakterit i njeriut vlerësohet prej rrethit ku ai vepron, ngase me sjelljet personale, me aktivitetet fizike e mendore të tij e tregon karakterin e tij njerëzor.

Për atë lirisht mund të themi: nëse edukimi i personalitetit dhe i karakterit nuk e plotësojnë njëra-tjetrën, është shumë vështirë të përparohet qoftë në jetën personale, ose në jetën familjare e shoqërore.

Sjelljet, apo veprat që i realizon një njeri kur nuk ekziston rreziku i shikimit nga të tjerët, është një pasqyrë reale e karakterit të tij. Allahu (xh. sh.) në Kur'anin famëlartë thotë: "S'ka dyshim se Allahu është me ata që janë të devotshëm (që ruhen prej të këqijave) dhe me ata që janë bamirës." (Nahl: 128) Gjithashtu edhe Xhibrili (a. s.) kur e pyeti Pejgamberin (a. s.) për Islamin - nënshtrimin, Imanin - besimin dhe Ihsanin - mirëbërjen, ai (Muhamedi a. s.) për Ihsanin iu përgjigj: Ihsan (bërja e më të mirës) është adhurimi i Allahut sikur me e pa Atë; megjithëse nuk e sheh Atë, Ai të sheh ty." (S. Muslim trans. ang, v.1, fq.1, nr.1)

Vepimet që njeriu i bën në mënyrë të përsëritur dhe gjen prehje tek ato, pasqyrojnë karakterin e tij. Nëse njeriu nuk arin ta edukojë karakterin e tij, nuk ka vlerë as dija e as aftësia e tij, sepse atëherë kjo ka edhe një anë më të rrezikshme. Të dish të drejtën, të mirën dhe të bukurën, ka një dallim të madh ndërmjet veprimit të së drejtës, të mirës dhe të bukurës. E rëndësishme, nuk është të dish se çfarë është e drejtë, e mirë dhe e bukur, por të kesh prirje dhe vullnet për të vepruar të drejtën, të mirën dhe të bukurën.

Dallimi mes karakterit dhe personalitetit është se karakteri është formim i cilësive që vijnë prej lindjes, por gjithsesi me mundësi edukimi, ndërsa personaliteti është një veshje ku njeriu ia përshtat klimës dhe ambientit ku ai jeton dhe edukohet.

Për të edukuar karakterin pa dyshim se duhet të kemi vullnet, dëshirë dhe durim.

Për këtë do të potencoj këshillat e autorit turk, Ali Fuad Bashgil, në librin e tij "Kokë më kokë me të rinjtë", i cili i pottencon tre armiqtë të rrugës së suksesit dhe të lumturisë: përtacillëkun, shokun e keq dhe shembullin e keq.

**Përtacia**, varësisht nga njeriu dhe koha në të cilën paraqitet, hyn në të gjitha format e mundshme. Ajo e fiton karakterin varësisht nga karakteri dhe sjelljet e njeriut që gjendet përballë. Sinonimet e ndryshme të përtacisë i tregojnë qartë format e saj. Një sinonim i përtacisë është edhe përtimi. Sinonimet tjera janë: indiferenca, mospërfillja, snobizmi, indolencia, denbelizmi, qejfkënaqësia, hutia...!

Përtacia nuk shfaqet para çdokujt në të njëjtën formë. Ajo gjithnjë e ndërton rolin si artisti pa punë. Herë merr formën e mikut të sinqertë dhe mirëdashës, herë formën e arsytimit, si sëmundje, si lodhje, si dhembje e herë duket se bën punë, por në të vërtetë nuk punon asgjë, ndërsa herën tjetër flet ëmbël dhe të mashtron. (Ali Fuad Bashgil, Kokë më kokë me të rinjtë, fq. 20)

## ZGJEDHJA E SHOKUT TË MIRË ËSHTË EDHE OBLIGIM FETAR

Nuk ka dyshim se jeta pa shoqëri është sikur të ecësh në errësirë, por të zgjedhësh shokun e mirë e ke edhe obligim fetar. Për këtë në një hadith thuhet:

Armiku i dytë i rrezikshëm në rrugën tënde të suksesit është shoku i keq. Ai është fatkeqësia më e madhe që mund ta godet të riun. Dhe, si çdo e keqe, edhe kjo është dinake dhe e maskuar. Maskën e ka të venduar me shkathtësi të madhe. Përdor fjalorin e shokut. Tregohet se të ndihmon dhe të mbron. Bën çdo gjë që t'ia kesh lakminë atij. Përtacia është në brendinë tënde dhe të flet me gjuhën tënde, kurse shoku i keq flet me gjuhën e vet dhe më shpejt të tërheq kah vetja. Në të shumtën e rasteve përtacia paraqitet me pretendimet e shokut të keq dhe kohë pas kohe bëhet shprehi dhe vendoset në brendinë tonë. Shoku i keq ka një filozofi flagrante. Në çdo moment - qoftë nëpërmjet fjalëve, qoftë nëpërmjet sjelljeve, ta tërheq vëmendjen. Vëllaçko, jetoje rininë; kjo rini nuk vjen edhe një herë.

Shoku i keq shqetësohet prej punëtoreve dhe fshehurazi ua ka zilinë; fillon të tallet me ta dhe t'i nënçmojë e në këtë mënyrë hakmerret ndaj tyre. Mundohet të gjejë mënyrë që me çdo kusht të tërheqë në greminën në të cilën ka rëshqitur vetë. Me fjalët dhe sjelljet e veta ta shkatërron energjinë shpirtërore dhe të lë përballë me një lodhje shpirtërore. Thënë shkurt, shoku i keq është fatkeqësia më e madhe që mund ta godet të riun. Po qe se bashkohen përtacia dhe shoku i keq, atëherë shumë vështirë mund të shpëtohet nga kthetrat e këtyre dy armiqtëve keqbërës.

Dëgjo mirë çfarë të them: Kushtet të cilat do t'i kërkosh te shoku yt duhet të jenë: puna, sinqeriteti dhe mirësia. Njeriu i cili i ka këto cilësi, është i stolisur edhe me të gjitha cilësitë tjera të mira. Këtë mos e harro dhe me njerëzit të cilët nuk i plotësojnë këto kushte mos u shoqëro kurrë. (Ali Fuad Bashgil, Kokë më kokë me të rinjtë, fq. 21, 22)

Sikurse dy faktorët e lartpërmendur, në jetën tonë praktike ballafaqohemi edhe me faktorin e tretë. Armiku tjetër i suksesit është shembulli i keq. Në rrugën e suksesit do të hasësh edhe një armik, e ai është shembulli i keq. Shembujt e këqij janë parazitë në formë të njeriut, të cilët vazhdimisht mundohen t'i pengojnë, t'ua mbyllin sytë njerëzve që kanë arritur pozitë, që kanë famë ose pasuri. Në realitet, këto shembuj nuk i kemi vetëm sot; ato kanë ekzistuar në të gjitha epokat. Në çdo kohë ekzistonin njerëz të cilët duke e shfrytëzuar qëllimimisht dhe zemërgjerësinë e të tjerëve, i kanë mbushur qeset e veta. Por, sot ata disi u shtuan tepër. Sytë tu të papërvojë në çdo kënd i shohin vetëm këta njerëz. Fatkeqësisht, jetës tënde të përkryer, të stolisur me





# PËRTEJ ISLAMIT KONSERVATIV



**Organizimi i mirëfilltë e ruan fenë, trupin, nderin, pasurinë, imazhin e myslimanëve dhe reputacionin e Islamit. Organizimi lokal dhe grupor e bën individin që të tjerët, shkaku ynë, Muhamedin (alejhi-selam) ta përshkruajnë me një imazh shumë të shtrembëruar dhe deficitar. Organizimi i myslimanëve nuk mund të jetë objekt për tallje nga vetë përcaktimet tona politike.**

**Shkruan: Taxhudin Hamidi**

**P**a dyshim që niveli i naivitetit justifikon gjëra që nuk kanë ndodhur. Mosrespektimi i autenticitetit të fesë shkakton që myslimanët të organizohen në aspektin lokal dhe grupor.

Organizimi i myslimanëve në forma tribale dhe fisnore është një kategori e Islamit konservativ.

Prandaj, në kontinuitet duhet të ndjekim ide dhe prova nga e gjithë bota për të kuptuar organizimin multidimensional dhe shumëpopullor.

Forma e organizimit në aspektin tribal, fisnor dhe lokal na demonstroi një model të organizimit politik që është i arritshëm vetëm te njeriu, apo deri tek individ, dhe jo në institucione. Organizimi i qenies njerëzore vetëm nga aspekti individual jo se nuk i ndihmon individit, por në fakt, nuk e largon nga problemet dhe pasojat e akumuluar edhe nga gjerat e kaluara.

Në këtë mënyrë, organizimi i myslimanëve në aspektin e krijimit politik është pothuajse i pamundur; në të gjitha nivelet e menaxhimit.

Është një gjedhe që nuk mund të fshihet dhe të mos analizohet thellësisht. Myslimanët vaxhdimisht tentojnë të arrijnë te vlerat islame si individë dhe në grupe, dhe assesi si kolektivitet dhe përmes in-

pozita në të njëjtën kohë. Ata nuk janë të dhënë pas anës materiale, e jo më të shfrytëzojnë çdo gjë që është shoqërore për interesa personale.

Njerëzit elitare për qëllim të parë e kanë përmirësimin e vetvetes, fitimin e virtyteve, edukimin e karakterit dhe pajisjen e tyre me dituri të dobishme. Studimi dhe meditimi i njerëzve elitare gjithmonë ka qenë çelësi i virtytit dhe i një karakteri të edukuar mirë.

Forca e njerëzve elitare krejt është morale, me një besim shumë të thellë, që në opinion reflekton vlera të larta morale. Jo fjalët, por sjelljet, veprat, karakteri e integriteti i tyre i bën ata superioritet të padukshëm.

Njerëzit elitare, veprojnë drejt. Të veprosh drejt, do të thotë të luash një rol të mirë (të bukur), të interesohesh për njerëzit tjerë dhe ndjenjat e tyre, të besosh tek partnerët, të mbash marrëdhënie të mira, të jesh besnik dhe të jesh i motivuar të ndjekësh rregullat dhe pritjet. Dhënia e besimit, të qenit besnik, në të njëjtën kohë duke treguar respekt dhe mirënjohje, këtë synon.

Njerëzit elitare janë të vetëdijshëm për ndjenjat e të tjerëve, për marrëveshjet dhe pritjet e përbashkëta që kanë përparesi mbi interesat individuale. Me anë të "rregullit konkret të artë" (atë që nuk doni t'ju bëjë dikush, mos ia bëni askujt tjetër), sjell pikëpamje të ndryshme në lidhje me njëri-tjetrin, duke e vendosur veten në pozicionin e tjetrit.

Dhe si përfundim, jo çdokush që pretendon të jetë elitare është prej tyre, jo çdokush që pretendon të jetë i parë, meriton të jetë i parë dhe mu për këtë jemi në këtë situatë shoqërore.

**(Autori është magjistër dhe doktorant në shkencat islame)**

punë të përhershme permanente dhe me durim të madh, shijen ia humbin këta parazitë. Si çdo e keqe, edhe shembujt e këqij kanë filozofinë e vet, e cila shkakton vetëm të liga. Epiqendra e kësaj filozofie është "egocentrizmi", vendosja e vetes në qendër të të gjitha gjallesave dhe të menduarit vetëm për veten. Ndërsa parimi i suksesit është (pa marrë parasysh në çfarë mënyre) të arrihet absolutja. Në të vërtetë, këta janë parazitët më të ligë të botës njerëzore. Dobësitë morale të cilat i theksova më lart, si p.sh. egocentrizmi, këta njerëz i konsiderojnë si fryte të intelektit dhe në mënyrë jo të ndershme tallen me to, ndërsa arrijnë e suksesit nëpërmjet mashtrimit e konsiderojnë sukses më të madh. Ki kujdes, këta njerëz kurrën e kurrës mos i merr për udhërrëfyes të jetës. Mos lakmo jetën luksoze e të pavlerë të harllatanllëkut dhe të parazitllëkut e assesi mos dysho në rezultatin e sigurt të punës së ndershme; mos e shkatërro fuqinë shpirtërore dhe mos ua lësho ardhmërinë tënde tekeve të një rastësie të errët. Mos lakmo sarajin prej kartuçi të intelektit plot intriga dhe dredhi. Gjithsesi, dije që njeriut i cili vërtet është njeri i ka hije rruga e ndershmërisë dhe e drejtësisë.

Ndershmëria do të thotë që njeriu kur të gjendet kokë më kokë me ndërgegjen e vet, të mos ketë llogari turpëruese se çka do t'i japë asaj. Të jesh i sigurt se ky është kushti parësor i të qenit i lumtur dhe i qetë. Nëse dëshiron të jetosh si njeri i qetë, atëherë këtë qetësi do ta arrish vetëm me drejtësi.

Mos harro se thelbi i suksesit është aritja në cak në sajë të hapërimit rrugës së drejtësisë dhe të ndershmërisë, e assesi nuk do të thotë aritje në pasuri, famë ose pozitë me çfarëdo mjete apo në çfarëdo mënyre.

Sikur të mos ishte kështu, atëherë vjedhësve, vrasësve, shtypësve të cilët nuk arrin t'i kapë policia, do të duhej t'u thuhet se janë njerëzit më të suksesshëm. (Ali Fuad Bashgil, Kokë më kokë me të rinjtë, fq. 24)

## INTELIJENCA NUK KA MUNDËSI TA KALOJË EKSPERIENCËN

Me këtë kuptojmë se inteligjenca nuk ka mundësi ta kalojë eksperiencën. Inteligjenca mund të dijë shumë vetëm për ato fenomene që gjenden vetëm brenda kohës dhe vendit, dhe asnjëherë inteligjenca nuk mund të dijë realitetin që gjendet përtej kufijve të kohës dhe të vendit. Për atë në jetën praktike kemi: prind-fëmijë, mjeshtrë-nxënësi (usta-çirak), profesor-asistent dhe në momentin kur fëmija ia tregon prindit rrugën, nxënësi mjeshtrit, apo asistenti profesorit, atëherë paraqiten çrregullimet, sepse ndryshojnë pozicionet me pa të drejtë. Fatkeqësisht, ky fenomen është prezent në mesin e shoqërisë sonë: mjeshtrit e jetës sonë nuk përfillen, zhvlerësohen, ofendohen, deri në atë shkallë duke ua harruar kontributin, mundin dhe sakrificën që kanë dhënë për arrijtjet tona të deritanishme.

Për atë gjithmonë njerëzit elitare veprojnë për të qenë e jo për t'u dukur. Vetëm me këtë besim, me këtë konvекsim, njeriu vepron me seriozitet - të njohë detyrën dhe përgjegjësinë e tij. Kështu ai e kupton se ka një barrë mbi supet e tij. Dhe, me këtë vlerë të vërtetë njeriu bëhet modest dhe gjithmonë qëndron larg demagogjisë.

Njerëzit elitare s'kanë të bëjnë me pozitë zyrtare, as që e kërkojnë atë, po edhe kur iu ofrohet ndonjë pozitë, e refuzojnë, sepse gjithmonë e kanë parasysh përgjegjësinë e detyrës, e jo më të kenë disa



stitucioneve demokratike të zgjedhura nga populli. Akoma nuk mund ta kuptojmë se termi institucion aspak nuk do të thotë: diktaturë, anarki, majorizim, bajraktarllëk, burokraci, diskriminim, mombing etj.

#### DUHEN PROGRAME TË SINQERTA

Institucioni ka për synim të instalojë rendin, barazinë, drejtësinë dhe ngritjen e ligjeve pozitive për të gjithë njerëzit. Institucioni nuk mbron grupin dhe individin, por grupet dhe individet i mbron përbrenda përfshirjeve kolektive dhe në shoqëri. Nëse i kërkojmë të drejtat në mënyrë grupore dhe individuale, kjo tregon për dy segmente shumë shqetësuese, që do të thotë: ose institucionet janë shndërruar në byro private, ose shtresa e popullit është zhytur në pakujdesi dhe mosnjohje politike të organizimit.

Organizimi i mirëfilltë e ruan fenë, trupin, nderin, pasurinë, imazhin e myslimanëve dhe reputacionin e Islamit. Organizimi lokal dhe grupor e bën individin që të tjerët, shkaku ynë, Muhamedin (alejhi-selam) ta përshkruajnë me një imazh shumë të shtrembëruar dhe deficiar.

Organizimi i myslimanëve nuk mund të jetë objekt për tallje nga vetë përcaktimet tona politike.

Pa programe të sinqerta, të hartuara nga nevojat e popullit tonë dhe të gjeneratave të reja, ne vihem në pozicione që dikush (Olivier Roy) të deklarojë në panele dhe studime islamistike se revolucionin i myslimanëve, i shtetit islam, është vetëm një mit.

Gabimi i kohës sonë është se shumica mendojnë se të gjithë njerëzit e shkolluar kanë aftësi të udhëheqin me normat e fesë dhe të religjionit. Kohëve të fundit nëse pyetemi kush më shumë e ofendon pejgamberin islam - ata që braktisin librin e Zotit, apo ata që nuk e komentojnë drejt, ata që gabimisht e interpretojnë Librin e Zotit, Kurandin, pa dyshim që ata që e komentojnë dhe e interpretojnë gabimisht janë promotorë të drejtpërdrejtë të ofendimeve që i bëjnë të tjerët.

Sepse, të tjerët e ofendojnë dhe e prozhmojnë (ofendojnë) Muhamedin (a. s.) duke pasur për bazë interpretimin dhe sjelljen tonë.

Dakord, ka edhe qarqe të tilla të cilat edhe pa "ndihmën" e myslimanëve trillojnë gënjeshtër për Islamin. Mirëpo, ekziston një plejadë dhe një lob i fuqishëm në botë të cilët regjistrojnë çdo gabim tonin që del nga afekti dhe mosdashja e ithtarit të Islamit.

Besimi se Muhamedit i ka bërë magji një çifut i rëndomtë, a nuk është një ofendim për pejgamberin islam?! Shumë dijetarë të shkolluar, duke mos u thelluar në kategorinë e imunitetit dhe të sigurisë profetike, kanë rrëshqitur në kurthet e pabesimtarëve. Ta përshkruash Muhamedin të magjepsur, nuk kam mundur ta besoj edhe në kohën e rinisë sime. Pejgamberi islam të magjepsset nga një çifut i traditave lokale të asaj kohe, është vetëm një trillim dhe rivajet -transmetim apokrif. E gjithë kjo është bërë dhe vazhdon të bëhet me një qëllim: që të zhvlerësohet dhe të lëndohet muxhiza-mrekullia e Muhamedit a. s. (Ebu Beker Razi, AhkamulKuran).

Edhe sot, në panele dhe studime orientale në Perëndim, citohen këto tekste të trilluara, me qëllim që të tregojnë se myslimanët janë popull që merren dhe besojnë në besëtytni. E gjithë kjo me intensitet konspirativ, të përgatitur mirë nga qarqe të ndryshme, që ta paraqesin gjendjen e myslimanëve të keqe dhe të paorganizuar në nivele institucionale, të mbetur në nivelin tribal, grupor e lokal.

#### "PLANI I HUAJ"

Organizimi i myslimanëve në rrafshin grupor dhe tribal është një plan i huaj. Ne fillimisht duhet të bazohemi tek Libri i Allahut - Kurani dhe në konventat e popujve, të dala nga përpjekja e madhe historike. Ky është plan hyjnor që kërkohet nga myslimanët dhe njerëzit e paqes!

Në ditët e sotme, mjerisht, më shumë dëgjojmë lajme për humbjen e njerëzve sesa për etablimin e të drejtave të tyre në shoqëri. Ajo që shohim dhe dëgjojmë në media është një realitet që shpesh nuk është real. Lajmet që dëgjojmë zakonisht më së shumti po trishtojnë sesa që e rehabilitojnë gjendjen nga aspekti informativ. Sot civilizimi sikur po merret me numrat sesa me zgjidhjen e të njëjtave.

Ku është sukcesi në metodologjinë e holizmit (se: sistemi është një tërësi dhe jo një grumbull elementesh)? Trupi i njeriut ka katër dimensione: atë të shtatit (të trupit), të emocionit, të shpirtit dhe të mendjes. Të gjitha këto janë të lidhura njëra me tjetrën dhe funksionojnë në mënyrë të përsosur. Nuk është e mundur - apo e pamundur është - të ndahet funksioni i tyre.

Njeriu realitetin objektiv e sheh me "tre sy" - dy janë mashtrues dhe një i sinqertë.

Por, ec e gjeje se cili është ai sy! Syri i parë është syri i dashurisë (pasionit), i

cili të keqen e sheh si të mirë. Syri i dytë është syri i urrejtjes dhe ai të mirën e sheh si të keqe. Syri i tretë është syri i drejtësisë, i cili gjërat i sheh në mënyrë më objektive. Pra, të mirën e sheh si të mirë, ndërsa të keqen e sheh ashtu siç është, si të keqe (Ibn Mukkafa).

Për shembull, shumë analistë dhe studiues mundohen ta ndajnë Islamin nga ekonomia, nga historia apo shkenca dhe kjo është treguar e pamundur. Dakord, krizat e mëdha ekonomike vranë shumë njerëz, dëbuan shumë nga shtëpitë e tyre dhe instaluan shumë struktura në varfëri të pariparuar. Kjo nuk do të thotë se ne duhet të ikim nga ekonomia dhe standardet industriale të kohës moderne. Problemi është evident: kompanitë e mëdha ndërkombëtare monopolizojnë ekonominë e vogla. Dhe, kjo shkakton që shumë njerëz të vihen nën kufirin e varfërisë. Ekonominë e mëdha shfrytëzojnë burimet natyrore që janë të përbashkëta për njerëzimin si: ajrin, ujin dhe mineralet e ndryshme. Përndimi jeton me mbipeshë, ndërsa miliona të tjerë vdesin nga uria.

#### AHLAK PËR TËRË BOTËN

Në shumë revolucione mund të dëgjoni: "duam bukë dhe ujë!" Aspak nuk e kemi menduar se në shekullin XXI dikush do të mendojë për bukë dhe do të frikësohet nga krizat ekonomike. Të gjitha revolucionet janë përdorur! Ka mbetur pa mos u përdorur deviza e revolucionit të Muhamedit (a. s.), i cili me shumë entuziazëm dhe me shumë sinqeritet ka deklaruar: "Jam dërguar për të plotësuar moralin." Në konferencat ndërkombëtare shumë pak bisedohet për moralin ndërkombëtar. Sot ekonomia vuan nga mungesa etike dhe morale. Këtë të keqe nuk mund ta ndalë askush, përveç se influenca sakrale e moralit dhe udhëzimet etike shkollore me përmasa religjioze. Pejgamberi islam - Muhamedi (a. s.) - ishte i dërguar thjesht për moral të përsosur-ahlak. Ligji islam ka për synim arritjen e dy objektivave: mëshirën dhe drejtësinë.

Mëshira arrihet përmes virtyteve me aplikacione fetare e shpirtërore, ndërsa drejtësia, pa dyshim, përmes strukturave të organeve gjyqësore të drejtësisë. Nëse njeriu pa dyshim e karakterizon jetën në këtë botë me këta dy komponentë, sigurisht që sukcesi do të jetë evident si në ekonomi, në shëndetësi dhe në siguri.

(Autori është Referent i Vakëfit në Myftininë e Tetovës)

# PËRGJEGJËSITË, PËR TË CILAT DO TË JAPIM LLOGARI

**Ndjenja e përgjegjësise e nxit besimtarin për vepra të mira dhe e çon në garim me vepra të mira, me të cilat arrihet sukcesi, udhëzimi dhe begatia. Sa më shumë që njeriu ka besim, ai e ndjen veten me përgjegjësi para Zotit dhe para njerëzve.**

#### Shkruan: Zejnulla Sadiku

Allahu i madhërishtëm thotë: **"Ne u ofruam amanetin (përgjegjësinë) qiejve, tokës dhe maleve, e ato nuk deshën ta marrin përsipër atë dhe u frikësuan prej tij, ndërsa njeriu atë e mori mbi vete; dhe ai i bëri padrejtësi vetes, dhe ishte i padijshëm."** (Ahzab: 72)

Nga ky ajet kuranor na bëhet e qartë se vetë qenia jonë në këtë botë është një lloj përgjegjësie; çdonjëri që është i moshërritur dhe me mendje të shendoshë, është i obliguar dhe duhet të bart përgjegjësi.

Ndërkaq, në Islam përgjegjësia është e karakterit universal, gjithëpërfshirës. Ndjenja e përgjegjësise në Islam është e përgjithshme dhe i përfshin të gjithë myslimanët, sepse të gjithë përfshihen te fjala e Pejgamberit (a. s.), që thotë: "Çdonjëri prej jush është bari dhe çdonjëri prej jush është përgjegjës për kopenë e vet. Imami (prijësi) është bari dhe është përgjegjës për kopenë e vet. Burri është bari në familjen e vet dhe përgjegjës për kopenë e vet. Gruaja në shtëpinë e bashkëshortit të vet është bareshë dhe përgjegjëse për kopenë e vet. Shërbëtori është bari në kapitalin e zotërisë së vet dhe është përgjegjës për kopenë e vet. Ndaj, të gjithë jeni barinj dhe të gjithë jeni përgjegjës për kopetë tuaj." (Transmetuan Buhariu, Muslimi e të tjerë)

#### NJË NGA VLERAT MË TË RËNDËSISHME

Një nga vlerat më të rëndësishme që duhet të ketë njeriu është, pa dyshim, edhe bartja e përgjegjësise, ose të qenët i përgjegjshëm.

Përgjegjësia do të thotë *t'ia japësh hakun asaj për të cilën je i obliguar* - qoftë në raport me Zotin, qoftë në raport me krijesat. Humbja e ndjenjës së përgjegjësise në jetën tonë, i sjell dukuritë negative - qoftë në familje, në shkollë, në rrugë, në

punë etj. dhe këto dukuri, fatkeqësisht, janë edhe me pasoja fatale.

Çdokujt që i është besuar një detyrë, një post, një mision dhe nuk e kryen në mënyrë dinjitoze, ai është treguar i papërgjegjshëm, andaj si mungesë e kësaj ndjenje edhe ekzistojnë prijës të papërgjegjshëm, prindër të papërgjegjshëm, mësues të papërgjegjshëm, mjekë...etj.

Njerëzit e përgjegjshëm i përmushin detyrimet në shtëpi, në shkollë, në lagje, në rrugë, në spital - si prijës, por edhe si një punëtor i thjeshtë. Ata e pranojnë se janë përgjegjës për veprimet. Prandaj, edhe kur gabojnë, e pranojnë, kërkojnë falje dhe përpiqen ta rregullojnë gabimin.

Të jesh i përgjegjshëm për veprimet që bën, me këtë ndihmon jo vetëm të tjerët, por edhe veten. Kjo është një mënyrë e mirë për të shmangur të gjitha tensionet dhe pasojat që mund të vijnë.

Individë të caktuar kanë tendencë të marrin përgjegjësi, por i harrojnë përgjegjësitë që duhet t'i bartin! Shpesh ndodh që njeriu të bëjë lajthitjen dhe të largohet nga përgjegjësitë që i ka. Kjo mund të ndodh për shkaqe të shumta. Prej atyre shkaqeve mund që të jetë: dobësia e personalitetit të atij personi, paaftësia për të kryer ndonjë obligim të caktuar, injoranca, neglizhimi i obligimeve, të cilat i ka marrë mbi supet e veta ai person e kështu me radhë.

Ndjenja e përgjegjësise është shumë e rëndësishme në jetën e myslimanit, i cili dëshiron që të jetë i suksesshëm në dynja dhe në ahiret, pasi që ndjenja e përgjegjësise është forcë nxitëse, e cila e nxit njeriun që të punojë dhe të jetë i dobishëm, fillimisht për veten e tij dhe pastaj edhe për të tjerët.

#### ME VENDOSMËRI DHE ME IMAN NË JETË

Kur njeriu është i përgjegjshëm, do të punojë aq sa ka mundësi për të realizuar obligimin që e ka mbi supet dhe ky person



nuk ik nga përgjegjësia që i është dhënë. Ky person i përgjegjshëm hyn në betejën e jetës me vendosmëri dhe me iman dhe nuk gjen arsye për t'u larguar nga obligimi. Ky person me ndjenjë përgjegjësie e ka kalitur veten e tij që të bart përgjegjësi mbi veten e tij dhe është i gatshëm që të ballafaqohet me obligimet pa kurrfarë hamendje dhe dyshimi.

Ndjenja e përgjegjësise e nxit besimtarin për vepra të mira dhe e çon në garim me vepra të mira, me të cilat arrihet sukcesi, udhëzimi dhe begatia.

Sa më shumë që njeriu ka besim, ai e ndjen veten me përgjegjësi para Zotit dhe para njerëzve.

Omer ibnu-l-Hattabi (kënaqësia e Allahut qoftë mbi të), i cili tregonte respekt dhe gjallëri, e ndjente veten me përgjegjësi. Ai ka thënë: "Sikur edhe deveja të has në pengesë në Irakun e largët, Omer ibnu-l-Hattabi do të ishte përgjegjës për të."

Mungesa e frikës ndaj Zotit, njeriun e bën që të jetë i pandërgjegjshëm dhe i papërgjegjshëm, sepse ai ka harruar se do të dalë para Allahut dhe do të japë llogari për atë që e kishte në përgjegjësi.

Prandaj, lirisht mund të themi se kaosi, situata e rëndë dhe e vështirë, të cilat po na rëndojnë si shoqëri në këtë vend dhe si myslimanë anekënd botës, është pikërisht si shkak i mungesës së ndjenjës së përgjegjshmërisë.

Allahu na bëftë më të përgjegjshëm dhe më të ndërgjegjshëm! Amin!

(Autori është Imam-Mualim në Xhaminë Uhud të lagjes Dizhon në Shkup)

# ISLAMI, FUQIA MË E MADHE SHTYTËSE

**Përkatësia jonë e vërtetë ndaj Islamit është e diskutueshme nëse myslimanët tjerë nuk janë të sigurt nga gjuha jonë, nga duart tona - edhe në kuptimin fizik, por edhe në aspektin e arritjes së sundimit mbi të tjerët në mënyrë të paligjshme.**

Shkruan: Imer Jusufi  
(Enkas për HeR)



Nga gjuha dhe duart e një myslimani të vërtetë myslimanët e tjerë janë të sigurt. Allahu (xh. sh.) në Kuran thotë: وَالْبَصِيرَ السَّمِيعَ إِنَّ عَلَّمَ بِهِ لَكَ لَيْسَ مَا تَقْتَفُ وَلَا مَسْتَوْلَا عَنْهُ كَانَ أَوْلَيْكَ كُلِّ وَالْفَوَازِ

“Mos iu qas asaj për të cilën nuk ke njohuri, pse të dëgjuarit, të parit dhe zemra, për të gjitha këto, ka përgjegjësi.” (El-Isra`ë: 36)

Muhamedi (a. s.) në një nga hadithet e tij të shumta të vërteta, e që transmetohet nga Abdullah ibn Amr, ka thënë:

الله رسول أن عمرو بن عبد قال سلم من المسلم: قال وسلم عليه الله صلى نهي ما هجر من المهاجر ويديه، لسانيه من المسلمون عنه الله

“Myslman (i mirëfilltë) është ai nga gjuha dhe dora e të cilit janë të qetë myslimanët. Kurse muhaxhir (i mirëfilltë) është ai që i braktis plotësisht ndalimet e Allahut.” (Buhariu dhe Muslimi)

**BEKIM NGA ZOTI I BOTËVE**  
Islami është besim që na është dhënë si bekim nga Zoti i botëve. Ne nuk e

meritonim atë në asnjë mënyrë; paraardhësit tanë të mirë na i përcollën vlerat e besimit dhe ne në çdo frymë tonën duhet të jemi të vetëdijshëm për përgjegjësitë e ndryshme që e përshkrijnë jetën e një myslimani të përgjegjshëm. Islami është akoma, pavarësisht nga të gjitha pengesat e shkaktuara nga gabimet e myslimanëve, fuqia më e madhe shtytëse që njerëzimi ka njohur ndonjëherë.

Islami është përkushtim ndaj zemrës, ndaj gjuhës dhe organeve tona të tjera, ndaj parimeve që na kërkon

Allahu i madhërishëm dhe përkushtimi më i mirë është me zemër, që quhet bindje e zemrës, sepse nënkupton të gjitha përkushtimet tjera.

Hadithi i mësipërm është i qartë: ai na paralajmëron se përkatësia jonë e vërtetë ndaj Islamit është e diskutueshme nëse myslimanët tjerë nuk janë të sigurt nga gjuha jonë, nga duart tona - edhe në kuptimin fizik, por edhe në aspektin e arritjes së sundimit mbi të tjerët në mënyrë të paligjshme.

Një person mund të fal namaz (dhe kjo është një dukuri e shpeshtë!), të agjërojë dhe të kryejë adhurime të tjera si shprehje ose si motive hipokrite, por në marrëdhënie me familjen, me fqinjët dhe me mjedisin ku jeton ai e vërteton Islamit e vet, e vërteton përkushtimin e tij ndaj Allahut (xh. sh.).

Në garën e jetës shumë nuk zgjedhin mjetet për të kënaqur interesat e tyre. Për më tepër, ata nuk hezitojnë t'i shkatërrojnë të tjerët nëse kjo është mënyra që ata të kenë sukses. Islami ka një pikëpamje krejtësisht të ndryshme për botën: ai e zhvillon ndërgjegjen kolektive, d.m.th. nëse është mirë për një njeri - atëherë është mirë për tërë shoqërinë në të cilën jetojmë.

Ne jetojmë në një kohë të mbushur me frikë dhe me pasiguri në shkallë globale. Gjithashtu, në nivel lokal ne jemi dëshmitarë të premtimeve, të intrigave dhe të provokimeve të ndryshme, me të cilat jemi mësuar si pjesë përbërëse të fushatës zgjedhore. Është e kuptueshme dhe normale që ne të kemi qëndrimin dhe opinionin tonë për këto fenomene, të cilat duhet të bazohen në fakte dhe njohuri. Sidoqoftë, në një kohë kur është veçanërisht e rëndësishme të ruani forcën shpirtërore dhe psikologjike të njerëzve tanë, të jepni një fjalë të bukur dhe të jeni një mbështetje për ata në nevojë, është e dukshme investimi i asaj që mbjell trazira, intolerancë reciproke dhe grindje midis nesh.

Nderi i njerëzve të tjerë është nën sulm dhe i lehtë për t'u njoollur, ndoshta si asnjëherë më parë. Sigurisht, një nga arsytet për këtë është kudo gjendja jonë në platformat sociale dhe gatishmëria jonë për të shkruar, për të komentuar dhe për të mbështetur shumë gjëra për të cilat nuk jemi të ftuar, as nuk kemi njohuri të mjaftueshme për to.

Si besimtarë ne duhet të jemi të vetëdijshëm për peshën e secilës prej fjalëve tona - të folura dhe të shkruara. Ju kujtoj se çdo fjalë e jona është e regjistruar me kujdes nga engjëjt e shkruesve, që nuk na lënë kurrë, dhe se ne do të pyetemi dhe do të përgjigjemi

për atë që e shprehim, si dhe për pasojat e asaj që shprehim, sepse Pejgamberi (salallahu alejhi ue selem) na mëson se mëkati do të shtohet sipas veprave të njerëzve - aq sa njerëzit do të jenë të udhëhequr pas asaj keqbërjeje, e cila sigurisht që vlen edhe për fjalët e folura ose të shkruara në mënyrë të pandërgjegjshme.

## KUSH JANË ATA QË DO TË SHPËTOHEN NGA FRIKA DHE PIKËLLIMI?

Kurani përmend njëmbëdhjetë grupe (kategori) njerëzish që do të shpëtohen nga frika dhe pikëllimi. A mund ta gjejmë veten tonë në mesin e tyre?

...فَمَنْ تَبِعَ هُدَايَ فَلَا خَوْفٌ عَلَيْهِمْ وَلَا هُمْ يَحْزَنُونَ {38}

1 -“E, kush e pranon udhëzimin Tim, për ata nuk ka as frikë, as që do të brengosen!” (El-Bekare: 38)

...مَنْ آمَنَ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ وَعَمِلَ صَالِحًا فَلَهُمْ أَجْرُهُمْ عِنْدَ رَبِّهِمْ وَلَا خَوْفٌ عَلَيْهِمْ وَلَا هُمْ يَحْزَنُونَ {62}

2 -“Kush besoi prej tyre (sinqerisht) Allahun dhe botën tjetër, dhe bëri vepra të mira, ata e kanë shpërblimin te Zoti i tyre. Për ta nuk ka frikë, as nuk kanë përse të pikëllohen!” (El-Bekare: 62)

بَلَىٰ مَنْ أَسْلَمَ وَجْهَهُ لِلَّهِ وَهُوَ مُحْسِنٌ فَلَهُ أَجْرُهُ عِنْدَ رَبِّهِ وَلَا خَوْفٌ عَلَيْهِمْ وَلَا هُمْ يَحْزَنُونَ {112}

3 -“Nuk është ashtu (si thonë ata), po ai që i është dorëzuar Allahut dhe është bamirës, ai e ka shpërblimin e vet te Zoti i tij; për ta nuk ka frikë, as nuk kanë pse të mërzhiten.” (El-Bekare: 112)

الَّذِينَ يُنْفِقُونَ أَمْوَالَهُمْ فِي سَبِيلِ اللَّهِ ثُمَّ لَا يُتَّبَعُونَ مَا أَنْفَقُوا مَنًّا وَلَا أَدَىٰ ۖ لَهُمْ أَجْرُهُمْ عِنْدَ رَبِّهِمْ وَلَا خَوْفٌ عَلَيْهِمْ وَلَا هُمْ يَحْزَنُونَ {262}

4 -“Ata që për hir të Allahut e japin pasurinë e tyre, e pastaj atë që e dhanë nuk e përcjellin me të përmendur e me mburrje, ata e kanë shpërblimin e vet të Zoti i tyre; për ta nuk ka frikë; ata as që do të brengosen.” (El-Bekare: 262)

الَّذِينَ يُنْفِقُونَ أَمْوَالَهُمْ بِاللَّيْلِ وَالنَّهَارِ سِرًّا وَعَلَانِيَةً فَلَهُمْ أَجْرُهُمْ عِنْدَ رَبِّهِمْ وَلَا خَوْفٌ عَلَيْهِمْ وَلَا هُمْ يَحْزَنُونَ.

5 -“Ata të cilët pasurinë e tyre e shpërndajnë (në rrugë të Zotit) natën e ditën, fshehurazi ose haptazi, ata shpërblimin e vet e kanë te Zoti i tyre dhe për ta nuk ka as frikë, as pikëllim.” (El-Bekare: 274)

إِنَّ الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ وَأَقَامُوا الصَّلَاةَ وَآتَوُا الزَّكَاةَ لَهُمْ أَجْرُهُمْ عِنْدَ رَبِّهِمْ وَلَا خَوْفٌ عَلَيْهِمْ وَلَا هُمْ يَحْزَنُونَ {277}

6 -“S’ka dyshim se ata që besuan dhe bënë vepra të mira, që falën namaz dhe që dhanë zeqatin i pret shpërblim i madh te Zoti i tyre; ata nuk do të kenë kurrfarë frike as brengosje.” (El-Bekare: 277)

وَلَا تُحْسِنُ الَّذِينَ قُتِلُوا فِي سَبِيلِ اللَّهِ أَمْوَالًا ۖ بَلْ أَعْيَابُهُمْ عِنْدَ رَبِّهِمْ يُرْزَقُونَ {169} فَرِحِينَ بِمَا آتَاهُمُ اللَّهُ مِنْ فَضْلِهِ وَيَسْتَبْشِرُونَ بِالَّذِينَ لَمْ يَلْحَقُوا بِهِمْ مِنْ خَلْفِهِمْ أَلَّا خَوْفٌ عَلَيْهِمْ وَلَا هُمْ يَحْزَنُونَ {170}

7 -“Kurrësi të mos mendoni se janë të vdekur ata që ranë dëshmorë në rrugën e Allahut. Përkundrazi, ata janë të gjallë, duke u ushqyer te Zoti i tyre. Janë të gëzuar me atë që u dha Allahu nga të mirat e Tij dhe atyre që kanë mbetur ende pa iu bashkuar radhëve të tyre u marrin myzhdë se për ta nuk ka as frikë dhe as që kanë pse të brengosen.” (Ali Imran: 169-170)

وَمَا نُزِيلُ الْمُرْسَلِينَ إِلَّا مُبَشِّرِينَ وَمُنذِرِينَ ۚ فَمَنْ آمَنَ وَأَصْلَحَ فَلَا خَوْفٌ عَلَيْهِمْ وَلَا هُمْ يَحْزَنُونَ {48}

8 -“Ne të dërguarit nuk i dërgojmë ndryshe veçse si përgëzues dhe qortues. E, kush besoi dhe u përmirësua, ata nuk kanë as frikë, as brengë.” (El-En'am: 48)

يَا بَنِي آدَمَ إِذَا بَاتَ بِئِنَّكُمْ رُسُلٌ مِنْكُمْ بِفُصُوفٍ عَلَيْكُمْ آيَاتِي ۖ فَمَنْ آتَقَىٰ وَأَصْلَحَ فَلَا خَوْفٌ عَلَيْهِمْ وَلَا هُمْ يَحْزَنُونَ {35}

9 -“O bijtë e Ademit, juve ju vijmë të dërguar nga mesi juaj, ju përkujtojnë faktet e Mia (shkoni pas tyre). E kush ruhet dhe përmirësohet, për ta s’ka as frikë, as s’kanë përse të pikëllohen.” (El-A'raf: 35)

أَلَا إِنَّ أَوْلِيَاءَ اللَّهِ لَا خَوْفٌ عَلَيْهِمْ وَلَا هُمْ يَحْزَنُونَ {62} الَّذِينَ آمَنُوا وَكَانُوا يَتَّقُونَ {63}

10 -“A nuk janë vërtet Evliatë (të dashurit) e Allahut pa frikë e brengosje? Ata që besuan dhe që ishin (prej atyre) që frikësohen.” (Junus: 62-63)

إِنَّ الَّذِينَ قَالُوا رَبُّنَا اللَّهُ ثُمَّ اسْتَقَامُوا فَلَا خَوْفٌ عَلَيْهِمْ وَلَا هُمْ يَحْزَنُونَ {13}

11 -“Ata që thanë: ‘Allahu është Zoti ynë’ dhe qëndruan besnikërisht, për ta nuk ka frikë dhe ata nuk do të pikëllohen!” (El-Ahkaf: 13)

E lusim Allahun e madhërishëm që të na forcojë në dinin e Islamit, ndërsa gjuhët dhe duart tona ta ruajnë nderin e myslimanëve të tjerë.

# LIBRI I ZOTIT, MREKULLI HYJNORE

**Studimi i funksionalizimit pozitiv të shkencës së ajeteve mekase dhe medinase, si dhe dobia prej tyre, është me rëndësi të madhe.**

**Shkruan: prof. dr. Hajredin Hoxha**

Falënderimi i takon Zotit të botëve, salavatet dhe selami mbi peygamberin e peygamberëve dhe të dërguarve, mbi peygamberin tonë, Muhamedin (a. s.), mbi familjen e tij, mbi sahabët e tij dhe mbi ata që ecën rrugës së tyre deri në Ditën e Gjykimit.

Kurani famëlartë është gjëja më e madhëruar që meriton t'i caktohet shumë kohë dhe që t'i kushtohet studim jetësor. Zoti i madhërishtëm e nderoi ummetin islam me dërgimin e peygamberit prej mesit të tyre që ua lexoi ajetet e Tij, i pastroi dhe u mësoi Kurantin dhe urtësinë. Zoti i madhërishtëm thotë:

“Është e vërtetë se Allahu u dha dhuratat të madhe besimtarëve, kur ndër ta nga mesi i tyre dërgoi të dërguar që atyre t'u lexojë shpalljen e Tij, t'i pastrojë ata, t'ua mësojë Kurantin dhe sheriatin, edhe pse më parë ata ishin krejtësisht të humbur.” (Ali Imran, 164)

Allahu (xh. sh.) po ashtu ka bërë njerëz më të mirë, sepse urdhërojnë në të mirë dhe ndalojnë nga e keqja:

“Ju jeni populli më i dobishëm, i ardhur për të mirën e njerëzve, të urdhëroni për mirë, të ndaloni nga veprat e keqja...” (Ali Imran, 110)

Zoti i madhërishtëm po ashtu e ka bërë Kurantin si udhërrëfyes në atë që është më e fuqishme:

“Është e vërtetë se ky Kuran udhëzon për atë rrugë që është më se e vërteta, e besimtarët që bëjnë vepra të mira i përgëzojnë se ata pa dyshim do të kenë shpërblyer të madh.” (El-Isra, 9)

Ai e bëri atë dritë dhe argument për botët:

“O ju njerëz, juve ju erdhni nga Zoti juaj argument dhe Ne ju zbritëm dritë të qartë.” (Nisa, 174)

Zoti i madhërishtëm u premtoi besimtarëve fitoren, përkrahjen, fuqinë dhe mundësinë, me kusht që ta përcjellin Kurantin, t'i ndihmojnë fesë islame, t'i për-

kulen Zotit të madhërishtëm, t'i nënshtrohen Peygamberit (a. s.), t'i respektojnë urdhrat dhe të largohen nga të ndaluarat e Tij, të bëjnë aplikim e parimeve, të lejojnë atë që Ai e ka bërë hallall dhe të ndalojnë atë që Ai e ka bërë haram:

“O besimtarë, nëse ju ndihmoni (fenë) Allahun, Ai ju ndihmon juve dhe u forcon këmbët tuaja.” (Muhamed, 7)

“Atyre nga mesi juaj të cilët besuan dhe bënë vepra të mira, Allahu u premtoi se do t'i bëjë zotërues në atë tokë ashtu si i pati bërë zotërues ata që ishin para tyre dhe fenë të cilën Ai e pëlqeu për ta, do ta forcojë, e në vend të frikës Ai do t'ju dhurojë siguri. Ata më adhurojnë Mua e nuk më shoqërojnë asgjë. E kush edhe pas kësaj mohon, të tillët janë ata më të prishurit.” (Nur, 55)

Synimi primar i zbritjes së Kuranit famëlartë është udhëzimi i njerëzve dhe udhërrëfimi i tyre në rrugën e drejtë e të vërtetë:

“Udhëzimi dhe përgëzimi për besimtarët.” (Neml, 2)

“Ky është libri që nuk ka dyshim në të (sepse është prej Allahut), është udhëzues për ata që janë të devotshëm.” (Bekare, 2)

“Zbritja e Kuranit është pa dyshim nga Zoti i botëve.” (Sexhde, 2)

Synimi i tillë i lartë dhe primar nuk kundërshton me Kurantin famëlartë në sferën e tregimeve, përgjërimeve dhe çelësive të disa shkencave humane e sociale. Në shumë ajete të Kuranit famëlartë theksohen të dhëna nga astronomia, kimia, fizika, matematika, inxhinieria, gjeologjia, shkencat detare, embriologjia, medicina, ekonomia dhe shkenca e arte të tjera, të cilat ishin të dobishme për disa dijetarë të famshëm e që thoshin se Kurani famëlartë i përmban shkencat e të parëve dhe të mëvonshmeve.

Ndër mënyrat e mbrojtjes së Kuranit famëlartë nga Zoti i madhërishtëm është ajo e mësimin përmendsh të çdo rreshti, leximi i shpeshtë, komentimi nëpër libra, mbrojtja nëpër librari, shkolla e universi-

tete, si dhe shënimi i të gjitha shkencave dhe arteve me shembuj konkretë. Po ashtu, ekzistojnë shumë hulumtime e studime, si p.sh., shkenca e ajeteve mekase e medinase, i përgjithshëm dhe i përvëçëm, absolut dhe konkret, shkenca e leximeve dhe e shtatë shkronjave, ndarja dhe shembuj, rrëfimet kuranore, stilistika, mrekullia, leximi reprezentues i Kuranit, abrogimi dhe brogimi, të qartë e të paqartë etj. I pastër është nga të metat Ai që e ka mbjellë në zemrat e robërve të Tij të sinqertë dashurinë ndaj Kuranit famëlartë, sepse si libër i fundit, konsiderohet mrekulli hyjnore për të gjitha gjeneratat në çdo kohë dhe në çdo vend. Ky libër është po ashtu për të gjitha kohërat dhe për të gjithë njerëzit deri në Ditën e Gjykimit.

Dijetarët klasikë dhe bashkëkohorë janë unanimë se shkencat më të respektuara janë ato që kanë të bëjnë me librin e Zotit të madhërishtëm dhe që janë në shërbim të tij. Ata po ashtu janë unanimë se forma, shkrimi, ajetet, suret, fjalët e fjalitë, si dhe përmbajtja e Kuranit famëlartë, përfshi ligjet, parimet e rregullat, janë mrekulli hyjnore që vlejnë për të gjitha kohërat dhe për të gjitha vendet, si dhe janë të paarritura për të gjithë njerëzit e as që mund të sjellin diçka të tillë. Në bazë të kësaj që u theksua, dëshiroj të theksoj një çështje shumë të rëndësishme, përkatësisht faktin se çdo shkencë i shërben Kuranit famëlartë dhe kjo, në një farë mënyre, gjithashtu konsiderohet mrekulli, sepse ka të bëjë me Librin që është mrekulli. Format e mrekullisë së shkencës së tillë dalin në pah kur zërthehen në suaza të shkencave që kanë të bëjnë me Kurantin famëlartë dhe gjërat e tilla janë të shumta në lëndën e shkencës së Kuranit.

Çështjet e tilla janë të ndërlydhura po ashtu edhe në ultësirat shkencore që mund të aplikohen e të realizohen.

Shkurt thënë, përmes këtij studimi ftoj në një metodologji të re për t'u ndërlydhur me shkencat e Kuranit, përkatësisht funksionalizimin pozitiv të shkencave të tilla që kanë të bëjnë me Kurantin famëlartë në



jetën tonë të përgjithshme dhe private, si individë, si shoqëri e si ummet, qoftë nga aspektet edukative, të da'vetit, akademike ose etike.

Ndoshta kjo orvatje personale është një hap i parë që do të pranohet e do të zhvillohen më pas gjatë studimeve të mëtejshme të Kuranit famëlartë nga hulumtuesit e studiuesit.

## QËLLIMI I PUNIMIT

Në këtë punim shkencor dëshiroj të arrij në dy çështje, përkatësisht në njërin prej tyre nëse ma mundëson punimi në fjalë, dhe këto dy çështje kanë të bëjnë me shkencat e bekuara të Kuranit, përkatësisht me shkencën e ajeteve mekase dhe medinase, si dhe shkenca e zbritjes suksesive të Kuranit, për të kuptuar mënyrën e funksionalizimit të këtyre dy shkencave dhe mënyrën e përfitimit të dobive prej tyre në sferat e sipërpërmendura. Besoj se me këtë metodologji të re në bashkëpunim me shkencat e Kuranit (ose me shkencat e tefsirit), madje edhe me shkencat e sunnetit, ose me rregullat usuliste ose juridike dhe funksionalizimi i tyre në realitetin tonë bashkëkohor, dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë do të dalim nga bota e teorive e ideve në botën e rezultateve dhe në aplikimet bashkëkohore të parimeve dhe rregullave islame. Ky është fryti i vërtetë i shkencave dhe i njohurive të sheriatit ose jo të sheriatit. Po ashtu do të mbështetemi në marrjen kualitative të

shkencave që janë në shërbim të Kuranit famëlartë si në të kaluarën, ashtu edhe në të tashmen, bile edhe në të ardhmen, ishallah!

## ARSYET E STUDIMIT

Një orvatje e tillë e përpunimit të shkencave të Kuranit, ose të shkencave të tefsirit është krejt personale dhe ekzistojnë dy arsye që patën ndikim të dukshëm t'i qasem kësaj çështje. Arsyja e parë ka të bëjë me jetën time, aktivitetin dhe direkt me punën time në profesionin e da'vetit, imamatit dhe ligjëratave në vendlindjen time, në Kosovë, e në disa shtete perëndimore dhe aziatike, si p. sh., në Gjermani, Zvicër e Malajzi, pastaj puna ime konkrete në da'vet dhe kontakti im i drejtpërdrejtë me ftuesit në fe (da'vetçinjtë), me dijetarët arabë dhe joarabë - shqiptarë, turq, boshnjakë, malajzianë, indonezianë, bruneianë, kinezë, indianë, palestinezë, saudianë, katarianë, irakianë, sirianë, jemenas, egjiptianë, sudanezë, algerianë, marokenë, mauritanas dhe disa dijetarë nga Afrika.

Arsyja e dytë ka të bëjë edhe me eksperiencën time akademike në ligjërimin e lëndës së shkencave të Kuranit, të tefsirit, të mrekullisë së Kuranit, të drejtimeve bashkëkohore në tefsir, hyrjen në Kuran e sunnet, metodat e komentuesve dhe të lëndëve të tjera për studentë e studente në gjuhën arabe e angleze në baçerol dhe studime të larta, si dhe në mentorim e

mbrojtje të disa disertacioneve shkencore në magjistratura. E kam ushtruar profesionin e arsimit, madje ende e ushtrroj të njëjtën punë afër dy dekada në universitete të ndryshme dhe për këtë e falënderoj Zotin e madhërishtëm!

## STUDIMET E MËHERSHME DHE STANDARDET E TYRE

Ligji i Zotit ka caktuar që në krijesat e Tij çdo çështje shkencore intelektuale të ketë punime, hulumtime e orvatje shkencore paraprake, por në asnjë mënyrë nuk do të thotë se të parët nuk kanë lënë gjë për më të vonshmit. Çështja nuk është ashtu siç mendojnë disa njerëz, sepse secili e ka mundësinë, sferën dhe aktivitetin të përkufizuar brenda diapazonit njerëzor dhe të pamëkatshëm. Sa shumë kanë bërë të parët për pasardhësit e tyre? Kjo gjë vërtet ka ndodhur dhe në bazë të kësaj të vërtete shkencore, e cila unanimisht është e pranuar, them se çështja e hulumtuesve ose e studiuesve të mëparshëm rreth shkencës së ajeteve mekase dhe medinase i takon kësaj kategorie.

Gjatë hulumtimit tim shkencor kam vërejtur dallime relative në potencialin e dijetarëve të tillë të nderuar gjatë zërthimit të tematikës mekase dhe medinase, sepse secili prej tyre e shqyrtonte çështjen nga aspekti i tij shkencor, edhe atë në bazë të orvatjes së tij të kufizuar individuale. Nëse i shikojmë me vëmendje studimet e tyre, plotësisht do të kuptojmë se

vetëm pak prej tyre e kanë shqyrtuar funksionalizimin e shkencës së ajeteve me-kase dhe medinase në da'vet apo në arsim. Studimet e shumicës së tyre, qofshin të mëhershëm apo të mëvonshëm, kanë qenë brenda kallëpeve dhe formave të ndryshme, pa ndonjë dallim rrënjësor tematik, ashtu siç do të vërejmë në vazhdimin kritik. Unë them se studimi im shkencor rreth ngritjes së funksionalizimit pozitiv të shkencave të Kuranit nuk është diçka e përsëritur, ose veç e parë, sepse gjatë hulumtimit tim dhe angazhimit tim në këtë tematikë (tematika me-kase dhe medinase), mund të vij në përfundim se studimet e mëparshme rreth kësaj tematike kanë pasur disa standarde të ndryshme. Studimet e tilla kanë pasur:

\* Standarde statistikore, duke i numëruar ajetet dhe suret me-kase dhe medinase dhe duke pasur qëndrime të ndryshme.

\* Standarde përkufizuese-specifike, duke i theksuar shenjat dhe karakteristikat e ajeteve e të sureve me-kase dhe medinase.

\* Standarde historike, duke i shënuar arsyet dhe shkaqet e zbritjes së ajeteve e të sureve me-kase dhe medinase.

\* Standarde edukative, duke i theksuar aspektet dhe mënyrat edukative të ajeteve me-kase dhe medinase.

Pra, kështu ishte pjesa dërrmuese e studimeve të mëparshme, madje mund të thuhet edhe të gjitha studimet në trajtimin e ajeteve me-kase dhe medinase.

Standarde të da'vetit, duke i shqyrtuar çështjet që kishin të bënin me da'vetin në disa ajete e sure me-kase dhe medinase.

Standarde intenciale, duke shqyrtuar fshehtësinë e përqendrimit të Kuranit në intencat e shariatit të ajeteve dhe sureve me-kase e medinase.

Edhe pse studimet me standarde të da'vetit e të edukatës janë të paktë, do të orvatem që të jap kontributin më të mirë të funksionalizimit të shkencës së ajeteve me-kase dhe medinase në jetën tonë, dhe nëse do të ekzistojnë studime të tilla edhe në të ardhmen, do të quasheshin studime me standarde funksionale.

Në hulumtimin tim nuk kam për qëllim që t'i shqyrtoj studimet e mëparshme brenda standardeve të kaluara, dhe përfitova shumë nga studimet e Akademisë së Mbretit Fehd për botimin e Kuranit në Medinë, duke shfletuar veprat që më ndihmuan dhe më begatuan tejmas:

\* “Nuzulul-Kuran”

\* Zbritja e Kuranit, Dahhak ibn Mezahim El-Hilalij (104 hixhri).

\* “Nuzulul-Kuran”, Ibn Ebi Abdullah Kureshij Berberij (105 hixhri).

\* “Nuzulul-Kuran”, Hasan ibn Ebi Hasan Basrij (110 hixhri).

\* “Et-tenzil fill-Kuran”, Ali ibn Hasan ibn Feddal El-Kufi (224 hixhri).

\* “Tenzilul-Kuran”, Muhamed ibn Muslim ibn Shihab Zuberij (124 hixhri).

\* “Fedailul-Kuran ve ma unzile

minel-Kuran bi Mekketi ve ma unzile bil-Medineti”, Ebu Abdullah Muhamed ibn Ejub ibn Durejn (294 hixhri).

\* “Bejani adedi suveril-Kuran ve ajatihi ve kelimatihij ve mekkijje ve medenijje”, dhe në këtë kopje është mbështetur komisioni që ka mbikëqyrur botimin e Mus'hafit të Medinës.

\* “Tenzilul-Kuran”, Ebu Zehra Abdurrahman ibn Zenxhele el-Mukrimi (403 H.).

\* “Et-tenzil ve tertibuhu”, Ebu Kasim Hasan ibn Muhamed Nisaburi (406 hixhri), dorëshkrim që është pjesë e librit të tij voluminoz: “Et-tenbih alal Fadli ulumul-Kuran”.

\* “Kitabul-mekkiy vel-medenij”, Mekkiy ibn Ebi Talib El-Kajsij (437 hixhri).

\* “El-Mekkiy vel-Medinij fil-Kuran ve ihtilaful-mekkiy vel-medenij fi ajetin”, Ebu Abdullah Muhamed ibn Shurejh Er-Re'inij (476 hixhri).

\* “Jetimetud-durer fin-nuzuli ve ajatus-suveri”, Ebu Abdullah Muhamed ibn Ahmed Hanbeli Mukri'ë (656 hixhri), dorëshkrim.

\* “Kitabul-Mekkiy vel-Medinij fil-Kuran”, Abdulaziz ibn Ahmed Dejremij (694 hixhri).

\* “El-Erxhuzetu el-mutedaruminetu ma'rifetil-mekkiy vel-medenij min suveril-Kuranil-Kerimi”, Bedruddin Muhamed ibn Ejub El-Hanefij (705 hixhri), dorëshkrim.

\* “Tekribul-me'mul fi tertipin-nuzul”, Burhaneddin Ibrahim ibn Umer Xhaberij Mukri'ë (732 hixhri), dorëshkrim.

\* “El-Kalem ala emakini minet-teuzili”, Ibn Ebi Sherif Burhaneddi Ebu Is'hak Ibrahim ibn Muhamed Shafi'ij (923 hixhri), dorëshkrim.

\* “Risaletul0uffij fil-mekkiy vel-medenij ven-nasih vel-mensuh ve adedul-ajati”, Muhamed ibn Ahmed Ufi (1050 hixhri), dorëshkrim.

\* “Erxhuze fil-Kuranil-mekkiy vel-medenij ve ma fi ta'dudihi minel-hilaf”, Muhamed ibn Ahmed Bazan Huzani (1216 hixhri), dorëshkrim.

### STUDIME BASHKËKOHORE QË KANË TË BËJNË ME AJETET MEKASE DHE MEDINASE

1. “Ehemmu hasaisis-suveri vel-ajatil-mekkijeti ve mekasiduha”, Dr. Ahmed Abbas Bedevi.

2. “Hasaisis-suveri vel-ajatilmdenejjeti, davabituha ve mekasiduha”, Dr. Adil Ebi El-Ul-la.

3. “El-Mekkiy vel-Medenij fil-Kuranil-Kerim”, studim i thellë kritik i sureve dhe ajeteve që nga fillimi i Kuranit deri në fund të sures El-Isra, temë magjistra-ture e hulumtuesit Abdurrezak Husein Ahmed.

4. “E-Mekkiy vel-Medenij fil-Kuranil-Kerim”, prof. dr. Muhamed ibn Abdurahman Esh-Shajj'u.

5. “Mukadime fi hasaisil-kitabil-Kuranij bejnel-ahdejni el-mekkiy velmedenij”, dr. Sejjid Abdulmaksud Xha'fer.

6. “El-Mekkiy vel-Medenij”, hulumtuesi Muhamed Shefa'at Rabbani.

“Ilmul-mekkiy vel-medenij fi ujunil-musteshriketi, prof. dr. Zejd Umer Abdullah El-Ajs.

8. “Mekkujul-Kurani ve medenijjuhu”, Muhamed Hadi Keridan.

9. “Et-tejjarul-ilmani el-hadith ve meukifuhu min tefsiril-Kuranil-Kerimi”, studim dhe kritikë, Muhamed Behijuddin Esh-Shafi'ij.

10. “El-Ilmanijjun vel-Kuranil-Kerim - tarikijjetun-nassij”, dr. Ahmed Idris Ta'an.

11. “El-It-tixhahul-ilmanij el-mu'asir fi ulumul-Kuranil-Kerim”, studim dhe kritikë, dr. Ahmed Muhamed Fadil.

12. “El-Ajatul-mekkiye” - “Studim nga aspekti edukativ peripatetik”, hulumtuesja Zuherijat bint Jusuf.

13. “Fikhul-Kuranil-Mekkiy”, hulumtuesi Abdulkadir Hudar.

14. “El-Mekkiy vel medenij ve ethe-ruha fid-da'veti”, dr. Ammar Muhamed Ammar.

15. “El-Medenij vel-mekkiy” - shqyrtime dhe komente, hulumtuesi Fevvez Ahmed Tukan.

16. “Nadhratun xhedidetun fi mekkijjis-suveri ve medenijijha”, hulumtuesi Abdulah Sa'idi.

17. “El-Keulush-shexhxhij fil-mekkiy vel-medenij”, hulumtuesi Husein Tal'at Hitab.

18. “El-Hitab ed-da'vij fis-suveril-mekkijeti”, hulumtuesi Mu'tesim Abdulkarim Mitrij..

19. “El-Mekkiy vel-Medenij fil-Kuranil-Kerim”, hulumtueseja Rena Ahmed Kudsij.

20. “El-Mekkiy vel-Medenij, ed-davabit vel-mitajat”, hulumtuesi Sejjid Selam Zejnul-abidin.

Si duket, pjesa dërrmuese e studimeve të theksuara janë përsëritje e asaj që e kanë theksuar të mëparshmit, por me një dallim të vogël në formë e radhitje, përpos studimeve të nënvizuara, sepse të tillat kanë të bëjnë drejtpërdrejt dhe pjesërisht me hulumtimin tim.

Studimi i funksionalizimit pozitiv të shkencës së ajeteve me-kase dhe medinase, si dhe dobia prej tyre, është me rëndësi të madhe.

(Vazhdon)

<sup>1</sup> Në disa shtete të Gjirit Arabik dhe në Saudi: Universiteti Tajba në Medinë - Fakulteti i Sociologjisë, i Da'vetit dhe Letërsisë; Në Universitetin e Katarit - Fakulteti i Shariatit dhe i Studimeve Islame, si dhe në disa shtete islame në juglindje të Azisë-Malajzi, Universiteti Ndërkombëtar Islamik - Fakulteti i Njohurive të Shpalljes dhe i Shkencave Humane në degën e studimeve kuranore dhe të hadithit, në Fakultetin e Usluddin në Universitetin Islamik të Sulltan Sherif Aliut në Sulltanatin e Brunejit.

# BIOGRAFI



Prof. dr. Hajredin Hoxha është i lindur më 1.10.1968 në Prizren, Kosovë dhe rrjedh prej një familje me kulturë të lartë fetare. Pas përfundimit të shkollës fillore në vendlindje, me inspirimin e prindërve, vazhdoi shkollimin e mesëm gjastëvjeçar në Damask të Sirisë 1983-1989, ku edhe diplomoi dhe u bë hafëz i Kuranit. Më vonë i regjistron studimet universitare dhe diplomon në Fakultetin e Kuranit dhe Studimeve Islame në Universitetin Islamik të Medinës, 1990-1994.

Studimet e magjistraturës në shkencën e tefsirit i mbaroi në Universitetin Islamik Ndërkombëtar, Kuala Lumpur - Malajzi, 1997-2000, ku edhe u bë Doktor i Filozofisë (PhD) në Tefsir 2000-2003.

Ligjëron shkencat kuranore dhe islame në të njëjtin universitet katër vite me radhë dhe zhvillon një aktivitet të gjerë pedagogjik, fetar, social dhe shkencor në Universitetin Ndërkombëtar në Malajzi, në Universitetin Taibah në Medinë, në Kosovë, në Bahrejn, në Kuvajt dhe në Katar. Ka një numër bukur të madh të diplomave dhe certifikatave në

sfera të ndryshme pedagogjike, fetare dhe shkencore, ku mes tjerash veçohet edhe me Diplomën për specializim në leximin e Kuranit sipas versionit të Al-Imam Hafsin nga Al-Imam Asim, me Senedin - Zinxhirin e Artë, që simbolizon vargun e lexuesve të besueshëm dhe profesional, të hafëzëve dhe kurrave, linja e të cilëve shkon deri te Pejgamberi (a. s.).

Ai gjithashtu merr pjesë aktive nëpër konferenca dhe seminare ndërkombëtare me kumtesa në fusha të ndryshme fetare, historike, kulturore dhe pedagogjike.

Po ashtu ka një eksperiencë administrative disavjeçare, ngase është anëtar i Komisionit për interpretimin dhe komentimin e Kuranit, në webfaqen: <http://www.tafsir.org>, dhe anëtar i Shoqatës Shkencore Saudite për interpretimin e Kuranit dhe të shkencave kuranore <http://www.alquran.org.sa>.

Lëndët që i ligjëron janë: Kulturë islame, Tefsir, Tefsir tematik, Sireh, Tilavet, Shkencat e Kuranit, Bazat islame, Studime kuranore etj.

Ka publikuar një sërë punimesh, përkthimesh dhe artikujsh në gjuhën arabe, angleze dhe shqipe në disa revista shken-

core të shtypit të përditshëm e periodik në Botën Arabe. Del para lexuesve me monografi mbi jetën dhe veprat e dijetarëve dhe teologëve më eminentë shqiptarë bashkëkohorë në fushën e interpretimit dhe komentimit të Kuranit, respektivisht Tefsirit.

Përpos specializimit dhe dedikimit të tij në fushën e Tefsirit dhe të shkencave kuranore, autori njihet edhe për aktivitetet e tij në fushën e islamizimit të shkencave humane dhe të historisë shqiptare, asaj antike dhe moderne, rreth çështjeve dhe problemeve kulturore, etike dhe morale të rinisë, si dhe në sferën e eliminimit dhe luftimit të mendimeve dhe qëndrimeve ekstreme religjioze e historike.

Aktualisht ligjëron në disa universitete në Katar në gjuhën arabe dhe angleze.

(Tema është paraqitur në Simpoziumin Ndërkombëtar për Zhvillimin e Studimeve Kuranore në Rijad, Arabia Saudite gjatë periudhës 16-20.02.2013. Për “Hënën e Re” e sjell prof. dr. Muhamed Mustafa)



**Agjencia për Hallall Standard**  
**Агенција за Халал Стандард**  
**Helal Standard Ajansı**  
**Agency for Halal Standard**  
مكتب شهادة للمنتجات الحلال



**Bashkësia Fetare Islame e R.M.V.**

Add: Cairska 52.1000 Skopje, North Macedonia.  
Tel: + +389(0)2 3117410; 3117 412.  
Fax: + +389 (0)23117 883

websait: [www.bfi.mk](http://www.bfi.mk)  
email: [halal.bfi@gmail.com](mailto:halal.bfi@gmail.com)